

BIBLIOTEKA

E

854-32

K 87

SHTETIT

GJIROKASTËR

A NASTAS KONDO

njerëz dhe gurë



TREGIME

8P1.983-32

5

K 87

ANASTAS KONDO

NJEREZ DHE GURE

— Tregime —

1498

~~53883~~

LIBRARIJA E SHTETIT
SHKURTARË

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

NJË NATË E SHKURTËR

Shiu ishte i papritur dhe na zgjoi po ashtu papritmas. Ishte gusht. Ditën kishte qenë kohë e mirë. Deti ishte i qetë dhe qielli i pastër. Asnjëri nuk mendonte se do të binte shi.

Ne ishim të gjithë banorë të steresë dhe asnjë nuk i njihte huçet e motit buzë detit. Se, po të ishim bregas, ajo qetësia misterioze e detit, ditën, kur vajtëm të laheshim mbas punës në det, (nuk dëgjohej as llapaçitja e tij, jo më zhurmërima), do të na kishte bërë të mendonim, që në mbrëmje apo natën do binte shi; dhe kështu do të qemë shtyrë të hapnim anës së çadrave kanale të vogla si ato ulluqet e ujit, për të mos lënë rrëketë të hynin në çadër, në tabanin e çadrës.

Sapo arritëm në Orikum, morëm vesh, që vetëm një mijë metra larg nesh ishte sektori i tretë i vullnetarëve të rinisë studenteske të Tiranës, që punonin për tarracimin e kodrave të Jonufrit. Ne, megjithëse ishim ekspeditë gjeologjike, që studjonte stratigrafinë e mesozoit të Shqipërisë jugore dhe perëndimore, shtresat më të vjetra në ato anë, ishim të rinj; më i vjetri nga ne, shefi ynë, vetëm katër vjet përpara kishte mbaruar universitetin,

ndërsa më i riu, Kostandini, sapo kishte mbaruar universitetin; ai vetëm dy muaj kishte që punonte me ne. Atë verë ishte diplomuar gjeolog.

Studentët kishin ardhur vullnetarë nga Tirana, kurse ne kishim zbritur nga malet. Dhe ne, ende pa ngritur mirë çadrat, bile mund të themi me ndërgjegje të qetë, me litarë të lidhur e të nderur sa për të shkuar radhën, morëm vrapin për në qytezën e studentëve, ku kaluam një mbrëmje të bukur me shokët tanë studentë e pedagogë. Kostandini e kaloi dhe më bukur, se ai takoi Shpresën. Shpresën ai nuk e kishte as të fejuar, as të martuar, por shpresonte të fejohej me të kur të mbaronte universitetin. Ajo ishte në vitin e tretë, kështu që Kostandinit i duheshin dhe dy vjet të priste Shpresën.

Atë natë u kthyem vonë në çadrat tona dhe, si pamë që çadrat e qytezës studenteske nuk ishin rregulluar hiç mirë, e ushqyem më shumë mendimin se çadrat ne i kishim «hata fare» dhe, meqë natën nuk rregullohen çadrat, fjetëm të qetë.

Kështu na ndodhi që nuk i hapëm kanalet anës së çadrave. Dhe shefi ynë, megjithëse fort i ngurtë, u mallëngjye si dhe ne nga takimi me studentët e fakultetit tonë dhe harroi të na kujtonte apo të na kritikonte që «shoqëria — shoqëri, por dhe rregulli — rregull».

Se sa kushtonte kjo puna e kanaleve, ne e kuptuam kur u zgjuam papritmas në mes të natës dhe ujërat filluan të çanin nëpër këmbët e krevateve tona portative. Unë dhe Irakli u zgjuam. Dëgjuam që dhe në çadrat e tjera po ashtu shokët filluan të ngriheshin. Çadra e vetme, që nuk jepte shenja jete, ishte ajo e kuzhinierit plak, xha

Argjirit, i cili ishte përjashtim në ligjin e madh të pleqërisë, sipas të cilit gjumi i plakut është i lehtë si i lepurit. Jo, xha Argjiri kishte një gjumë të rëndë. Sikur të mos kishte me vete sahatin me zile, që e vinte në rrëzë të veshit, ai me siguri do të zgjohej shumë vonë. Është ky sahat me zile, që na bënte neve ta linim të flinte vetëm kuzhinierin tonë, në çadër më vete, sepse ndryshe do të na duhej të zgjoheshim me të, domethënë një orë më parë se ç'zgjohej ekspedita. Ai zgjohej kështu herët, se pregatiste sillën e mëngjezit për ne.

Shiu filloi aty nga ora një e natës, kështu që xha Argjiri ishte në gjumin e parë dhe jo shiu që nuk e zgjoi, por, dhe breshër të binte, zor se do ta zgjonte.

Ne, të tjerët, gjeologët dhe shoferi u ngritëm të gjithë. Bile shoferi ynë nxitoi të shkonte te maqina për të parë se mos rreth saj bëhej baltë e madhe dhe nuk e nxirrte dot të nesërmen. Ai e çoi maqinën në trotuarin pranë klubit, që kishte rrufepritëse.

Ndërkohë ne ngritëm qeskat me kampione, që ishin përdhe, i vumë mbi njerin nga krevatet e i siguruam nga ujërat. I mbuluam pastaj mirë dhe me bataniet tona, me të gjitha bataniet tona, sepse nuk ishim të sigurt në brezentin e çadrave. Dinim që nëpër tegelet e qepjes së brezentit, me siguri do të fillonte të pikonte.

Dhe ashtu ndodhi, pikërisht nëpër tegel çadrat filluan të pikonin. Por ne i kishim siguruar mirë kampionet. Për këtë shoferi më tha:

— Sikur të ishte gjyshja ime, do të thoshte se i kemi mbuluar gurët si djemtë e vetëm, mos të ftohen orëzeztë.

Ne s'kishim si flinim më, dhe kështu filluam të prisnim mbarimin e shiut të natës.

Kostandini qe i pari që tha fjalët, të cilat më vonë u bënë shkas për një natë të shkurtër, të vështirë, por, do të thoshja, origjinale dhe, pse jo edhe të bukur.

— Ata djemtë e universitetit do jenë bërë qull.

Ai tha këto fjalë dhe ne kuptuam që donte të thoshte: ato vajzat e universitetit, apo, mbase më qartë akoma, ajo Shpresa ime. Ato çadrat e sajuara keq të vullnetarëve, vështirë t'i bënin ballë atij shiu të fortë, që sa vente e shtohet.

— Sikur t'u bënim zë të vinin tek ne sonte ata vullnetarët. Janë tri çadra dhe, sa për të mos u lagur, ashtu shtrënguar, mund të mbajnë pesëdhjetë-gjashtëdhjetë njerëz. Një kompani të tërë.

— Nuk dëgjojnë, sado të bërtasësh, s'të lë shiu — thashë unë.

— Sa për kompaninë, ti me siguri mendon atë të Shpresës. Por atë e ke buçko ti, o vëllaçko, s'ke pse të mërzitësh; mjerë të sëmuret, që ka sektori, ku do të futen sonte! — tha shoferi.

Ai foli për të sëmuret e sektorit. Dhe ne e ndjemë të gjithë, që kjo natë për ta ishte fort e vështirë dhe e prapët.

— A s'vemi, o shokë, me maqina deri tek ata? Ne të ndihmojmë vullnetarët në hallet e tyre, kurse maqina të bjerë të sëmuret këtu në çadrat tona. Ne t'u ndihmojmë vullnetarëve, kurse të sëmuret të flenë në krevatet tona. Ndërsa nesër bëjmë punë kamerale — tha shefi ynë.

Nata ishte e errët pus. Bile as vetëtima nuk kishte që të ndriçonin qoftë dhe për një çast vendin rreth e rrotull. Diku larg, në Adriatik, dëgjohe-

shin bubullimat, oshëtima e të cilave përplasej maleve të Llogarasë dhe të Qorres.

Shoferi me zor ndezi maqinën dhe ne u nisëm për atë rrugë, e cila në kondita normale nuk duhej të zgjatte më shumë se pesë minuta. Ne u nisëm dhe nuk kishim arritur as tek ura, domethënë as në gjysmën e rrugës, kur shiu u bë aq i rrebeshtë sa me gjithë dritën e fortë, që lëshonin fenerët e maqinës, rruga nuk dukej më. Ishte një shi i fortë që krijonte një perde të trashë uji. Shoferi e ndaloi maqinën, me siguri, duke pasur parasysh urën. Kishte rrezik që, po të vazhdonim rrugën në një shi të tillë, kur nuk duhesh asgjë, të gremiseshim nga ura.

— S'kemi ç'bëjmë, inxhinierë; ky shi ka ardhur si me porosi për fshatarët. Do të kemi misër sivjet. Por ç't'u bësh studentëve, që nuk u duhet ky shi me porosi — tha shoferi.

— Keq e kemi sonte me këtë shi ekuatori — thashë unë.

— Sidomos keq e kanë studentët — shtoi Kostandini.

— Mjerë Shpresa, që nuk shpreson se sonte ti, shoku Kostandin, do të çash «detin» ta shpëtosh — tha Irakliu, që, për çudi, në kondita të vësh-tira bënte shaka, kurse zakonisht ishte i turpshëm, andaj shakatë e tij në të tilla raste mund t'i merrje dhe për ironi, po mos ta njihje Irakliun.

Ai rrebesht i fortë shiu, që nuk lejonte të shihje asgjë, vazhdoi nja pesë minuta dhe pastaj, si gjithë rrebeshet, mbaroi papritmas.

— Do të kishim vajtur në qytezë e do të ishim kthyer tashti, sikur të mos kishte qenë ky ciklon — tha shefi ynë.

— Kam dëgjuar, inxhinier, që tajfuneve në botë u vënë emra femrash. Si thua ti (i drejtohej Kostandinit) a t'ja vëmë dhe ne emrin këtij cikloni që kaloi «Shpresa»? Cikloni «Shpresa»? — vazhdoi shoferi.

— Bukur — thashë unë, cikloni «Shpresa». Shpejtësia 80 km. në orë. Bie me vete 1200 mm. rreshje në 24 orë. Ky ciklon përsëritet çdo muaj gusht. E ka marrë emrin kështu, sepse paraqet interes të madh për bujqësinë. Fshatarët shpresojnë shumë te ky ciklon. Me origjinën dhe variacionet e tij, këto kohët e fundit, po merret ekspedita gjeologjike, me në krye Kostandin Flakën.

Ndërkohë arritëm në qytezën vullnetare. Qyteza dukej e braktisur, sikur nuk kish qenë e banuar ndonjëherë. Çadrat nuk dukeshin fare. Ishin rrëzuar.

Njerëzit, po ashtu, nuk dukeshin. Secili ishte futur ku kishte mundur. Shumica nën pemët. Ne i ramë disa herë borisë së maqinës, po s'po afrohej njeri. Atëhere, kur e humbëm durimin dhe bëheshim gati të dilnim t'i kërkonim, dikush na u afrua. Nuk dallohej se kush ishte, shok apo shoqe. Ne hapëm derën dhe i thamë njeriut që erdhi, të futej në maqinë, që të mos lagej në shi. Se, megjithë që rrebeshi, cikloni «Shpresa», kish mbaruar, shiu vazhdonte të binte përsëri.

— S'ka gjë. Kështu na lahen rrobat me ujë të distiluar.

Dhe ne dëgjuam zërin e tij prej djali. Se nga rrobat vullnetarët qenë gati njësoj si djemtë ashtu dhe vajzat.

— Futu, or, brenda dhe lëri teoritë. Apo mos ke frikë se mos të rrëmbejmë. Të gjeologjisë jemi,

shokë jemi — i tha të porsardhurit shoferi. Shefi i liroi vendin përpara dhe ne e pyetëm:

— Ku i keni të sëmurët? Për ta kemi ardhur. Na i trego që t'i marrim me makinë e t'i çojmë në çadrat tona, këtu afër. E di?

— E di, te klubi — tha vullnetari.

— Po, te klubi. Andaj kemi ardhur, se të tjerët nuk i marrim dot se janë shumë — tha shoferi ynë.

— Falemnderit, or byrazer, qenkeni djem të mirë. Mendokeni për shokët. Falemnderit, por ne i siguroam të sëmurët në makinën e Kinostudios. Mbrëmë kishim film dhe kishte ardhur autokinema. Gjashtë të sëmurë që kishim, i futëm atje. Në doni të merrni njeri, merrni ata djemtë e filmi që po lagen për borxh tonë. Sa për të sëmurët, më mirë janë në autokinema.

— Mirë, po ku janë ata djemtë e filmi? — pyeti shefi.

— Ja, t'i kërkojmë.

— Ku do t'i gjesh në këtë shi?!

— Ja, mor, le të bërtasim një herë: «O shokët e kinostudjos, hajdeni se ju kërkojnë». — Ai thirri një dy herë, thirrëm dhe ne me të, por asnjeri nuk u përgjegj.

— Kot lodhe, o shok, s'të dëgjon njeri në këtë shi. Po deshe hajde ti me ne. Paske fat. U nisëm për të sëmurët, por na dole ti përpara. Makina e bën rrugën, hajde të flesh sonte në çadër — tha Kostandini, i cili e kuptoi që ashtu si nuk po gjenim dot ata të kinostudios, nuk do të gjenim dot as Shpresën me shoqet e saj.

— Në fund të fundit, nuk është punë fati, por e ke dhe me hakë, e meriton të flesh me ne sonte — tha shoferi.

— Mirë, po vij. Po pritni sa t'u them dhe shokëve, që ishin me mua tek ajo pema atje. Ata më dërguan te maqina, shoku shofer, — bëri shaka ai.

— Po e gjete atje dhe Shpresën, merre me vete — tha Irakliu.

— Cilën Shpresë?

— Atë të gjeologjisë.

— Nuk e njoh!

— S'ka gjë, vëllaçko. Le të kalitet një çikëz Shpresa — tha shoferi.

Ai studenti, që na takoi, u kthye me shtatë shokë të tjerë, të cilët nuk ishin strehuar askund. Të gjithëve flokët u ishin bërë qull dhe u qenë shtruar si të kishin dalë mbas një banje të gjatë. Rrobat u rridhnin ujë dhe, atje tek u ulën, nën vete, u shkante një rrëke e vocërr.

— Ne jemi pesë veta dhe ata shtatë, kështu që «Gazi» u kthye në autobus — tha Sotiri.

U kthyem në bazën tonë. Xha Argjiri, kuzhinieri ynë, që tanimë ishte zgjuar, u dha vullnetarëve, që ishin bërë blëckë, raki nga e tija, raki personale, raki Përmeti, nga miqtë e Odriçanit. Shtatë vullnetarët ishin të një moshe, siç dukej, ishin të një klase. Mosha e njëjtë dhe rinia e tyre i bënte t'i ngjasonin njëri-tjetrit. Ata më ngjanin si shtatë vëllezërit e përrallave, veçse u mungonte motra. Sikur të kishim gjetur dhe Shpresën, do të ishte një përrallë stereotipe.

Ne hapëm çantat dhe u dhamë atyre ndërresat tona. Ata në fillim kundërshtuan, nuk deshën, por, duke parë këmbënguljen tonë, u zhveshën dhe u ndërruan. Në të gdhirë dhe shiu mbaroi. Shtatë studentët i zuri gjumi ulur mbi krevetet tona.

Megjithë që rrugët qenë me baltë, shkëmbinjtë të lagur dhe në përgjithësi edhe përrenjtë mund të mos kaloheshin, domethënë, ishte një ditë krejtësisht e papërshtatshme për vrojtime gjeologjike në mal, prapëseprapë ne nuk bëmë punë kamerale ato ditë, siç mendoi shefi natën.

— O shef, a nuk ikim ne tashti në marshrut?! — i thamë ne në të gdhirë. — Shiu mbaroi, studentët duan gjumë. Le t'i lëmë të flenë në krevatet tona, kurse ne të ikim në marshrut malit. Se, në mbeçim këtu për punë kamerale, ata nuk do të flenë fare, do t'u vijë turp nga ne, bile dhe në mos u ardh të turp nga ne, do të zgjohen nga zërat tanë.

Ne thamë kështu dhe nuk pritëm aprovimin e shefit. Shefi ynë ishte punëtor i mirë dhe dihej që nuk do të kundërshtonte.

Na dukej që marshruti, me gjithë terrenin e vështirë, ishte fort i bukur, ndoshta më i bukuri nga gjithë ata të atij behari, sepse e dinim që në çadrat kishim lënë shtatë djem që flinin, studentët vullnetarë të tarracave, që kishin kaluar një natë të keqe, një natë të lodhshme. Me këtë ndjenjë, ndoshta pak egoiste, që bëmë një të mirë dhe, më anë tjetër, me bindje, që studentët pas kësaj nate do të flinin me siguri gjithë ditën, ne punuam deri nga dreka, ngjitëm dhe zbritëm malin. Kuzinierit i thamë të pregatiste mëngjezin për vullnetarët, kurse për vete ne ikëm pa ngrënë, sepse drutë qenë lagur dhe, pa dalë mirë dielli që të thaheshin, nuk ndizeshin. Të prisnim, nuk na premtonte koha.

Kur u kthyem në çadër, ne erdhëm si hajdutët, qetë-qetë dhe pa zë, që të mos zgjonim të shtatë shokët e universitetit, të shtatë miqtë tanë.

Shoferi u çudit me ne. Ai ishte ngopur me gjumë.

— Ku veni kështu, pa zë fare, o trimat e naf-tës, në kishë? — pyeti shoferi.

— Pësht, se do të zgjosh studentët! — i tha më ne urtë fare.

— Ç'farë studentësh, ata ikën në mëngjez, pak më vonë se ju. Thanë se do të vijnë këtu mbas pune, në darkë.

— Pse i le të ikin, mor teveqel?! — i tha gjithë inat shefi.

— Mbaje gojën, shef! Po ata thanë se do të punonin, do hapnin tarraca sot — tha shoferi.

— Mos gënje kot! — i tha shefi, — ashtu baltë, siç është bërë toka sot, nuk hapen dot tarracat.

— Atë e dinë ata që e thanë. Unë di që ikën — foli shoferi. — Unë nuk gënjej.

— Pse ziheni, mor djema? — tha xha Argjiri, «kuzhinieri më i mirë».

— Ja, për studentët që ikën.

— Por do iknin dhe ata. Ju për vete vajtët në punë? Po! Dhe ata do venin në punë.

... Në mbrëmje ata të shtatë dhe shumë shokë të tjerë vullnetarë erdhën në klubin pranë nesh. Erdhi dhe Shpresa.

— Na e hodhët sot — na thanë ata. — Na latë në gjumë, kurse për vete u ngjitët malit për punë. Të na kishit zgjuar dhe ne.

— Ne ju lamë qëllimisht të flinit; na u dukët shumë të lodhur — tha shefi.

— Ju e bëtë sikur të ishit brigadë hileqare... ne të flinim, kurse ju të tejkalonit planin — tha me të qeshur ai djali që na takoi i pari atë mbrë-

mje që binte shi. Por lavdi Muços (një shok i tyre), që me gërhimën e tij na zgjoi dhe kështu vajtëm e realizuam normën tonë sot dhe çadrat i rregulluam. Ndryshe, ai qerrata shiu i mbrëmshëm do të na kishte turpëruar fare. Kurse juve ju falemnderit. Na bëtë nder mbrëmë.

— Lëre atë muzikë — tha Kostandini, — mos i bjerë asaj note.

— Rrofshin gjeologët, se janë shokë të vërtetë — thirri njëri nga ata të shtatë, që po pinte konjak.

Mua po më vinte turp për mendimin që kisha, kur më dukej sikur atë ditë, që u ngjitëm në mal, kishim bërë sakrificë të madhe. Studentët gjithë natën u lagën, nuk fjetën fare (me përjash-tim të atyre dy-tre orëve të shtatë shokëve), kurse punuan gjithë ditën dhe, për më tepër, tejkaluan dhe normën.

— Ishte një natë e shkurtër kjo që shkoi, por ne morëm vesh se gjeologët nuk kërkokan vetëm minerale, por në net të këqia, me shi, kërkojnë dhe të sëmurët, njerëzit — tha njëri nga studentët, sikur të ishte në mbledhje solemne.

— Rrofshin gjeologët — thirri përsëri njëri nga ata të shtatë. Dukej që ai studenti po dehej për ne.

TË NESËRMEN E NATËS PA GJUMË

Vazhdonte të binte shi me rrëmbim. Kush kishte çadër e bëri gati për ta hapur qysh në kabinën e «Gazit» dhe tek shkëputeshin me çadra të hapura nga «Gazi» dukeshin sikur hidheshin me kapapult. Ata të katër u shkëputën nga «Gazi» dhe vrapin e mbajtën në fjetoren e punëtorëve. Dhe këtu u ndodhi ajo, që ish e papritur për ta. Ata filluan të hapnin dyert e dhomave të gjumit dhe kudo gjenin njerëzit në gjumë, si në përrallë. Këtu kishte diçka të çuditshme, diçka fare të pakuptueshme dhe të papritur. Kjo nuk u kishte ndodhur asnjëherë.

Ishte ora njëmbëdhjetë e mëngjezit dhe nuk kishte se si të shpjegohej që të gjithë punëtorët ilinin. Kuptohet që ata dhjetë burrat e turnit të natës duhej të flinin, por ata dhjetë të turnit të dytë nuk kishte pse të ishin zgjuar. Mund të ndodhte që disa prej tyre ishin gjumashë. Por që të dhjetë të ishin gjumashë, kjo ishte e pabesueshme.

Ata i shëtitën dhomat me radhë. Dhe të gjithë flinin. Kaluan te zyrat! Ato ishin të mbyllura. Shkuan në kuzhinë dhe atje s'kishte njeri.

Ata të katër, që sapo zbritën nga «Gazi» dhe që i gjetën njerëzit e pusit në gjumë, ishin gjeologë. Njëri prej tyre, ai me pallto gub, ishte projektues i pusit. Dy të tjerët, Nikua dhe Shameti, ishin gjeologë nafte, që i kishin ardhur për përforsim institutit nga baza. Bile Nikua kishte punuar në këtë pus, kur sapo kishte filluar shpimi. (Pusi tashti shponte një mijë e dyqind metra thellësi). Kështu që ai i njihte më mirë nga shokët e tij punëtorët e pusit.

— Duhet vajtur te pusi — tha gjeologu me pallto gub. Ata te pusi duhet ta dinë ç'ka ndodhur këtu.

— Hajde shkojmë bashkë — i tha atij Aleksandri — Futu në ombrellën time!

Aleksandri ishte pasagjeri i katërt i «Gazit» po të mos futim në këtë numër shoferin, Miçon. Ai ishte mikropaleontolog, domethënë gjeolog, që merrej me studimin e moshës së shkëmbinjve, të shtresave me anë të mikrofosileve. Shkaktari i këtij udhëtimi në këtë kohë të keqe, kur rrugës së re me baltë të pusit mund të rrezikoheshë disa herë, kishte qenë ky, Aleksandri. Një muaj më parë atij i lindën disa dyshime, të cilat ja shfaqti gjeologut projektues, atij burrit me pallto gub. Gjeologu nuk i pranoi dyshimet e tij. Por kur pusi arriti një mijë e njëqind metra, vihej re që ai nuk shponte sipas projektit, por diçka ndryshe. Atëhere ata të drejtorisë u kujtuan për dyshimet e mikropaleontologut. Dhe ja, ky udhëtim, në mes të dimrit, në një ditë me shi të ftohtë, si ujët e Selitës, ishte për të kontrolluar disa gjëra në vend, që mund t'i kishin shpëtuar gjeologut projektues.

Në këto pozita ishin gjeologu me pallto gub

dhe mikropaleontologu. Andaj, kur ky i fundit i tha atij të shkronin bashkë te pusi, ai bëri sikur nuk dëgjoi.

— Po nisem unë — tha shoferi. — Më jep mua çadrën, inxhinier. — Dhe u nis për te pusi.

Ndërkohë Shameti, që i kishte lënë shokët te streha e depos së kampioneve të pusit (dhe ajo ishte mbyllur, domethënë duhej menduar që dhe teknik-gjeologu flinte), u kthye dhe tha:

— Pashë disa njerëz misteriozë te dhoma e zjarrit.

— Çfarë dhome zjarri? Këtu mensa ka qenë si dhomë zjarri. Por ajo ishte mbyllur — tha Nikua.

— Nuk di gjë. Në doni të thaheni, hajdeni të shkojmë atje.

Shiu vazhdonte të binte. Ai kishte filluar një ditë përpara. Kishte rënë gjithë natën dhe nuk kishte ndër mend të pushonte. Gjeologët e kishin lënë të takoheshin në orën tetë te maqina, pranë hotelit. Gjeologu me palto gub dhe Nikua fjetën në hotel. Aleksandri dhe Shameti kishin familjet atje, në atë qytet, pranë të cilit (dyzet kilometra larg) po shpohej pusi. Shoferi fjeti te një mik i tij. Aleksandri dhe Shameti ishin lagur keq nga këmbët. Nga shtëpia deri në hotel, atyre u ishin bërë qull këmbët deri te gjunjët. «Pantallonat prej teritali iu rrinë të ngrira, si të gagarelëve» kishte thënë shoferi. Shoferi kishte çizme. Ai ishte më praktik se djemtë e gjeologjisë; gjithmonë nën sedilje mbante çizmet.

Shkuan te dhoma e zjarrit që kishte zbuluar Shameti.

— Kjo ka qenë dhoma e dominos — tha Nikua. (Në fakt ajo kishte qenë dhoma e çlodhjes).

— Ç'rëndësi ka. Këtu ka zjarr që të than, apo jo, shokë? — tha Shameti, duke iu drejtuar atyre që po ngroheshin rreth zjarrit.

Njerëzit, që ishin brenda, u dhanë dorën dhe u liruan vend në stolet përreth sobës. Ishte një sobë e madhe, e sajuar nga ca tuba të gjerë, gati një metër diametër, që shpuesit e naftës i përdorin për grykën e pusit. Drutë nuk kurseheshin fare dhe pranë sobës thaheshe menjëherë. Ata që ishin brenda, qenë tre burra jo të rinj, të cilët kishin një gjë të përbashkët, qeleshet. Nga qeleshet mund të kuptoje lehtë, se ata ishin vendas, të fshatrave përreth.

— Vendali jeni, o shokë? — pyeti Nikua.

— Po, or vëllai ynë, vendali jena — tha njëri prej tyre.

— Ju zuri shiu rrugës, patë që këtu dilte tym dhe erdhët? — pyeti Shameti.

— Vallahi, jo tamam ashtu. Ne këtu punojmë. Ke rruga e re që ka hapë gjeologjia. Na zuri shiu në rrugë, ke po i hidhshim i çikë zhavorr. Asht tokë shumë e butë, baltë, dhe kur bie shi i madh si ky, e prish rrugën fare. Gjynaf. Na zuni shiu dhe këta shokët e pusit na kanë thanë: «Hyni pa teklif te soba», dhe ne erdhëm të presim sa të mbarojë shiu — tha ai i mesit, me një peshqir lidhur qafës si shall.

— Sa të mbarojë shiu dhe na do fillojmë prapë punën — tha tjetri më të djathtë të tij.

— Po punëtorët e pusit pse flenë të gjithë? — pyeti gjeologu me pallto gub.

— Nuk dijmë gja. Kur erdhëm ne, e gjetëm pusin që punonte dhe këta shokët këtu që flejshin.

Mos kanë pasë ndonjë ziafjet mbramë? — tha ai me peshqir në qafë.

— More, mirë e ka ky — tha Nikua. — Mos kanë pirë mbrëmë qerratejtë, janë bërë tapë, dhe ne na erdhi keq t'i zgjojmë?

— Nuk ka qenë ditë e rrogave dje — tha Shameti, me qetësi të tillë, që u duk se e ftohu keq Nikon.

Te dera u dukën shoferi me një punëtor. Ishte kryesondatori i turnit, që punonte tashti te pusi.

— Njatjeta, shokë! — tha ai.

— Tungjatjeta, Selfo! — tha Nikua me Aleksandrin

— Mirë dita! — thanë gjeologu projektues dhe Shameti.

— U lodhët ndonjë çikë? Shi i madh. Ju qofshi që keni marrë këtë rrugë sot — tha kryesondatori i turnit të dytë duke qarë hallin e gjeologëve.

— Jo dhe aqë — tha gjeologu me pallto gub.

— More Selfo, mos kanë pirë hashash këta shokët e tu mbrëmë, që i ka zënë gjumi dhe nuk i zgjon jo topi, por as bomba atomike? — tha Nikua, duke qeshur.

— Jo, inxhinier. As hashash as raki. Mbrëmë natën në turnin e tretë, aty nga mesi i natës, patëm avari të rëndë.

— Ç'avori? — pyeti me nervozizëm gjeologu me pallto gub, që u çudit si mund të ndodhte avari në pusin e tij.

— Avari të rëndë. Shokët bënë manevër lart dhe u doli pipa. Ata u përpoqën të gjithë qysh nga brigadieri deri te kuzhinieri, pa përjashtim. Vetëm ne që flinim, të turnit të ditës, nuk na zgjuan. Ata nuk deshën që të ndërpritej shpimi. U rropatën

gjatë. Shiu ka qenë i fortë dhe era ishte e keqe. Vendi këtu është i hapët, si në det. U munduan nja gjashtë orë të gjithë, deri sa e likuiduan avarinë. Në të gdhirë, kur erdhën në fjetore (atëhere kur u zgjuam ne), morëm vesh ç'avari kishin pasur. Janë lodhur shumë të shkretët. Por janë budallenj.

— Pse janë budallenj? — pyeti fshatari me peshqir në qafë.

— Si pse janë budallenj? — u çudit kryesondatori. Kuptohet pse janë. Duhet të na kishin zgjuar edhe ne, turnin tonë. Sikur ne ishim agallarë. Ne flinim, kurse ata punonin.

— E ke gabim, Selfo, — tha Nikua. — Bënë mirë që nuk ju zgjuan. Ndryshe dhe ju do të flinit tashti dhe, shpimi pezullohej për njëzet e katër orë.

— Kush tha që do të flinim, inxhinier? Ti thua ashtu. Pa pyet shokët ç'thonë. Do të punonim me orë të zgjatura. Nuk bëhej kiameti.

— Nuk besoj se do të kishit fuqi — tha gjeologu me pallto gub, që dhe këtu pranë sobës jakën e mbante ngritur.

Kryesondatori deshi t'i thoshte: «Mbase ti nuk do të kishe fuqi, inxhinier», por i erdhi turp, kur kujtoi që ai dhe këta gjeologët e tjerë ishin miq të tij, miq të pusit. Ai nuk e dinte që njeriu me pallto gub kishte projektuar pusin. Ai ishte pa ngrënë atë mëngjez, se kuzhinieri po flinte me shokët dhe, ndoshta, nga që nuk kishte ngrënë mëngjez, desh ja tha ato fjalë gjeologut me pallto gub.

Shiu binte. Aleksandri me Shametin kishin nxjerrë këpucët dhe po i thanin nën sobë.

— Ruajini mos t'ju digjen — tha shoferi.

— Po shkoj të zgjoj brigadierin. Sot nuk besoj të kemi më avari. Ka kohë të flejë mbas dite — tha kryesondatori dhe nuk priti ta kundërshtonte njeri mendimin e tij.

Çorapet e Aleksandrit dhe të Shametit u thënë. Këpucët s'po thaheshin akoma.

Brigadieri nuk erdhi vetëm me Selfon; bashkë me të erdhën dhe tekniku i pusit dhe dy punëtorë.

— Mirë se na erdhët, shokë, — tha brigadieri. Ai qe burrë i zymtë; më shumë se çdo gjë në jetë donte naftën. . .

— Jeni lodhur mbrëmë — tha Nikua.

— E po e ka zanati, o inxhinier, e do puna dhe lodhjen — tha ai. Sikur të thoshte: «E po duhet ngrënë buka».

— Ashtu është — ja ktheu Shameti.

— Ç'e mirë ju pruri, inxhinier? — pyeti tekniku i shpimit.

— Ku e keni teknikgjeologun, brigadier? Na duhen ca kampione të trungut të pusit — tha gjeologu projektues.

— S'është këtu. I lindi gruaja vajzë (donte djalë i shkreti), dhe e dërguam për nja pesë ditë në Durrës, tek e shoqja. Kemi vënë këtë çunin këtu (dhe tregoi teknikun e shpimit) të merret këto ditë me kampionet.

— Hëm, specialist për gjithshka — tha gjeologu me pallto gub i pakënaqur.

— Jo, mor i uruar, por nga halli, jo nga malli. I lindi gruaja tjetrit. Fëmija e parë. Shokët menduan (nuk tha se ai mendoi) që punën e bën dhe djali i shpimit. Mbase bëra dhe gabim. Por kishte mall i ziu djalë për gruan.

— Do mësohet dhe ai pa mallin e grave —
tha njëri nga punëtorët e pusit, ai më i vjetri, duke
qeshur.

— Na e hap depon — i tha gjeologu me pallto
gub teknikut të shpimit.

— Djalin e ke mirë me shëndet, brigadier. Dje
në seminarin e fundit ishte i përgatitur mirë — i
tha mikropaleontologu, që jepte leksion në filialin
e universitetit, në Qytetin Stalin.

— Falemnderit, inxhinier — tha ai.

— Gruaja s'të ka lindur akoma. Mbahet mirë.
E shoh në mëngjez kur vjen për qumësht — i tha
Nikua punëtorit tjetër që erdhi me brigadierin,
atij më të riut.

— Ç'të bëj? I kemi kalamajtë me radhë. Njeri
pas tjetrit.

— Ja edhe ca dhe të rritet djali — tha bri-
gadierin.

Fshatarët, që punonin në mirëmbajtjen e rru-
gës, dëgjonin dhe habiteshin se si këta njerëz e
nijnin kaq mirë njëri-tjetrin, si shokë të vjetër.

«Vallahi bilahi, çudi» mendonte fshatari me
peshqir në qafë. «Nga e folmja duken se janë nga
nahi të ndryshme. Nga muhabeti duken si vëlla-
zën. Çudi. More jahu! Çudi!»

Shiu binte. Anës së rrugës rrëketë po hapnin
brazdat e tyre. Gjeologët morën kampionet e trun-
gut të pusit. Shiu binte. Në një kohë të tillë pa
mushama, pa çizme, është zor të punosh me çekiq
në dorë përjashta. Punëtorët po zgjoheshin. Nga
depua e kampioneve dukeshin punëtorët me pesh-
qirë në qafë që shkonin të laheshin në mes të
shiut. Ca laheshin drejt e te ullukët e shiut. Ditë

tjetër, gjeologët nuk do të shkonin në të tillë kohë në marshrut, në mes të shiut. Nikua mori çekiqin, ngriti jakën dhe hapi çadrën i pari. Ai bashkë me Shametin dolën. Mikropaleontologu i tha gjeologut me pallto gub.

— Shkojmë? Kur të vijmë thahemi prapë te soba — shtoi, kur vuri re si u prish fytyra e shokut të tij, tek shihte shiun që binte.

Dhe ata u nisën të dy nën një çadër. Shiu binte. Shoferi u çudit që ata u nisën në këtë shi. Kjo s'kish ndodhur ndonjëherë me ta. Zakonisht, në ditë të tilla, ata shkruanin në ditarët e tyre: «Shiu na pengoi të bënim vrojtime gjeologjike». Gjeologët i priste një rrugë e gjatë, midis shiut dhe baltës, për të marrë kampione. Aleksandri u ul të mblidhte guralecë në zhavorrin, që i kishin hedhur rrugës fshatarët e mirëmbajtjes.

— Ç'i do? — pyeti gjeologu me pallto gub.

Dheu është qull. Etiketa (flet shoqëruesja) e kampionit grisit në dheun e qullët. Dhe lapsi nuk mban në të. Do të hedh aqë guralecë, sa është numri i kampionit në çdo qese, që të mos i ngatërrojmë.

— Mirë — tha gjeologu me pallto gub — dhe filloi të mbushte xhepet me guriçka, si atëhere kur ishin të vegjël e gjuanin me llastika për zogj.

Fshatarët e mirëmbajtjes së rrugës, tek panë që gjeologët e lanë «Gazin» në mes të rrugës dhe u nisën për punë, u ngritën dhe ata dhe morën lopatat.

— Merr një shishe raki në magazinë — i tha brigadieri magazinierit. — Ata do të vijnë të qullur dhe të ftohur. Do të kenë nevojë të fërkohen me

raki. — Atij i pëlqenin këta djem, që i kujtonin
djemtë e tij.

— Janë të rinj, e kalojnë — tha punëtori i
vjetër i pusit.

Gjeologët nuk dukeshin më. Ata i mbuloi shiu.

NJERËZ DHE GURË

Nata ishte e gjatë. Ishte natë dimri dhe dukej sikur nuk do të kishte fund kurrë. Natyrisht, kështu duket nata kur nuk të zë dot gjumi, se sado e gjatë të jetë, ajo prapë ka fund. Ai ishte i lodhur, shumë i lodhur. Kishte udhëtuar në mëngjez pesë orë më këmbë, faqes së Kulmakës, malit të zhveshur, deri sa kishte arritur në këtë fshat. Fshati i vogël, shumë i vogël. Vetëm njëzet shtëpi. Edhe pallati, ku ai banonte në qytet, kishte 36 hyrje, 36 familje. Fshati ishte i vogël, por kishte halle të mëdha, probleme të shumta.

Atij nuk i shkante në mendje se pas asaj udhe të lodhshme nëpër borën e pashkelur, (mirë që kishte me vete kaçatorin e fshatit, një djalosh të ri, dhe të plotfuqishmin e zonës), do të vinte në këtë fshat të vogël, me probleme aq të ngatërruara. Atij për problemet e fshatit diçka i kishin thënë edhe shokët e Komitetit të Partisë. Ata i thanë që punën e re, si sekretar partie i zonës malore, ta fillonte pikërisht në këtë fshat. Fshatrat e tjerë të zonës janë më të mëdhenj, por çështjet i kanë më pak të ngatërruara.

Në përgjithësi ai nuk e njihte fshatin e sotsnëm

shqiptar pothuajse fare. Jo, edhe ai kishte ndihmuar në fushatat e korrjeve të grurit, por, megjithëqë fshatarët kanë hallin e grurit në këtë kohë, prapëseprapë ti je mik i tyre, mik nga qyteti në fshat. Por mik u nuk mund të thotë se e njeh fshatin. Sido që të jetë puna, ti je bujtës, dhe, si e thotë vetë fjala, për ty fshati, në këtë rast është bujtinë dhe, sado e mirë të jetë bujtina, ose hoteli, siç i thonë shokët e tregëtisë, prapëseprapë mbetet hotel dhe jo shtëpia jote. Pak a shumë një bujtës kishte qenë vitet e fundit të punës, por fshatin nuk e njihte, ky sekretari i ri i partisë për zonën malore.

...Dikur, shumë vjet përpara, këtu e tridhjetë e ca vjet të shkuara, i ati e kish marrë nga fshati dhe e kish sjellë në qytet, në Kuçovë. Atë vit ai po mbushte dymbëdhjetë vjeç. I ati punonte mekanik në një oficinë nga ato oficinat e remontit të maqinerisë së shpimit të puseve. Kapua i oficinës, sinjor Papeti, nuk kishte dashur ta pranonte në punë, dhe në fakt nuk e pranoi. Por i ati e mbajti djalin pranë, në repart, që t'i mësonte zanatin, ashtu vjedhurazi, pa rrogë. Dy vjet punoi djali si çirak i të atit, por çiraku i punëtorit nuk merrte rrogë. Dhe jetonin me atë rrogën e vogël të babait të dy ata, babë dhe bir. I ati ishte për të birin dhe prind dhe usta. Si baba, i ati e donte, si usta, e rrihte shpesh, se zanatin po e mësonte me vësh-tirësi. Ai kishte vetëm disa javë, që nisi të mësojë këtë zanat, kurse të atit i dukeshin vite. Kur kaloi viti i parë, atij iu duk një shekull. I ati punonte dymbëdhjetë orë dhe diçka merrte për punën e tij. Djali punonte dhe lodhej shumë, se dymbëdhjetëorëshin e bënte si gjithë të tjerët dhe s'merrte asgjë, asnjë lek për punën e tij. Ai punonte

dymbëdhjetë orë, aq orë sa vjeç ishte. Dhe në fillim mendonte: «Kur të bëhem pesëmbëdhjetë vjeç do punoj pesëmbëdhjetë orë në ditë, kur të bëhem njëzet e katër vjeç, do punoj njëzet e katër orë, por kur do të ha bukë? (për gjumin nuk kujtohej). Po kur të bëhem dyzet vjeç? (më shumë nuk mendonte dot të jetonte, vetëm dyzet vjeç, sa i ati). Atëhere do të vdes». Por e ngushllonte veten se nuk do të arrinte të bëhej aq plak. Veçse kështu mendonte ditët e para, pastaj jo, pastaj u bind që dhe kur të bëhej sa barba Kiçua, gjashtëdhjetë e shtatë vjeç, prapë aqë do të punonte, dymbëdhjetë orë, e shumta katërmbëdhjetë. Hiç gjë! Djali punonte dymbëdhjetë orë dhe s'merrte asnjë grosh. Kurse te oborri i oficinës, djali i kafexhiut me të birin e kapos së oficinës, Papetin e vogël, luanin gjithë ditën me lekë. Dhe asnjë orë nuk punonin. Ai punonte dymbëdhjetë orë dhe e hante bukën kot. Kështu i thoshte i ati: «Mëso zanatin shpejt, more rrufjan, se e ha bukën kot». Ai e donte babanë shumë; dhe i ati e donte, por babai ishte punëtor, gjithë jetën punëtor dhe nuk kish kohë ta tregonte dashurinë, dhëmshurinë për të, ta përkëdhelte. Ai i thoshte ndonjë fjalë të mirë. Mbase kur të rritej dhe ai do të bëhej si babai serioz dhe i zyrtë. Mbase!

Ata flinin, babë e bir, në kapanonet e punëtorëve. Babai ishte punëtor, përderisa merrte rrogë. Tre lekë në ditë? Po, por rrogë ama, kurse ai nuk ishte punëtor. Ti do të thuash që ai punonte. Po, por rrogë nuk merrte. Atëhere ç'punëtor ishte ai pa rrogë? «As grua nuk do të gjesh kështu, pa lekë», i thoshte i ati, megjithëse dhe ai e kuptonte që për nuse të djalit ishte shumë shpejt të flisje.

Por ama që ai nuk ishte punëtor, kjo nuk diskutohet. Këtu kishte krejtësisht të drejtë i ati.

Babait shoqëria italiane i kishte dhënë një krevat prej hekuri, si ata të ushtarëve, dy batanie dhe të drejtën të hante në mensë. Shoqëria nuk donte që leku, të cilin u jepte ajo punëtorëve, të shpenzohej në vende të tjera, por vetëm në mensën e saj dhe te kafexhiu, që ishte mik i sinjor Papetit. Kurse ai, djali, s'kishte as krevat dhe as vend në mensë. Dhe ai flinte tok me të atin. Kur ishte dimër, ata ngrohnin njëri-tjetrin. Babanë e zinte gjumi shpejt, se, natyrisht, lodhej më shumë. Sepse, sado që t'i jepte punë të birit, atë më të rëndën, më të vështirën e bënte vetë. Babanë e zinte gjumi shpejt dhe gërhinte shumë. Në fakt, në atë kapanonin e tyre, gati të gjithë gërhinin. Djali nuk e dinte në gërhinte ai vetë apo jo. Atë e zinte gjumi të fundit dhe s'kish kush ta dëgjonte. Kurse ai e dinte kush gërhinte dhe bile edhe qysh gërhinte. Secili kish avazin e tij.

Kur vinte behari, babë e bir nuk flinin dot fare në krevatin e hekurt. Ata pëlcnin vape, më keq se cinxëri, dhe djali zbriste në tokë. Atje shtronte përdhe njerën batanie, pallton dhe ashtu, pa u zhveshur, e zinte gjumi, (si sonte) le që të grinin dhe tartabiqet...

... Ja edhe atë mbrëma ishin shtruar përtokë, pranë vatrës. Fshatari, ku e prunë të flerë, akoma nuk kishte blerë krevat. Kur pyeti në darkë i plotfuqishmi, pse s'kishin blerë ndonjë krevat, i zoti i shtëpisë tha që ishte larg rruga e maqinës e nuk e binte dot. «Me kafshë, mor i uruar, ta sillje...» nguli këmbë i plotfuqishmi i zonës. «Ashtu, or mik, por ja, deshi ta binte Xakia një ditë, por iu gremis

kali rrugës dhe iu thye dollapi me gjithë pasqyrë. Është punë me zarar ajo». Sekretari i partisë donte t'ja bënte vetë këtë pyetje, që i bëri i plotfuqishmi fshatarit, por kështu do të dukej sikur i pyeste: «Ku po i shtroni të flerë sekretarit të partisë për rajonin?» (se të tillë detyrë kishte, duke filluar nga ajo ditë do të ishte sekretar i partisë për zonën malore, kurse një ditë më parë, tamam një ditë më parë, ishte punëtor i uzinës). Megjithëqë edhe mund ta pyeste; pse mos ta pyeste?» Sikur të ishte koha e paraçlirimit, kur dhe toka dhe pylli dhe kafshët dhe rruga ishin të beut, s'kish si t'u kërkonte këtyre njerëzve të varfër krevat. Kurse sot, pas njëzet e katër vjetësh socializëm në Shqipëri, kur ja tek është pylli i kooperativës (se kishin dy vjet që ishin bërë kooperativë malore), ja kafshët e kooperativës (pak, thonë, kanë, por sa për të prurë qereste për krevatët e njëzet shtëpive kanë) dhe rruga është e tyre, mund të bënin disa krevat të drunjta, ku të flinin si njerëz. Por është puna që u duket e vështirë të bëhet ndryshe, sado e mirë qoftë, sa të mësohen. Atij i vinte inat që nuk ja tha të zotit të shtëpisë ato që mendonte për krevatin. Por e ngushulloi veten se do të kishte kohë t'ja thoshte. Oh, sa shumë gjëra duhen thënë këtu!

... I ati e donte djalin, por nuk ja shfaqte dot fëmijës dashurinë. I vinte rëndë ta mësonte me përkëdheli, se pastaj llastohej e bëhej jo punëtor, por «birko mamaje». Edhe djali e kuptonte këtë, të paktën e ndjente kur i ati i jepte copën më të madhe të bukës, kokrrat më të mëdha të ullinjve, e ndjente natën, kur i ati zgjohej të shihte se mos i kish tërhequr të birit batanien dhe se

mos e kishte zbuluar natën e dimrit; e ndjente kur në gjumë i ati kthehej në krahun tjetër, që të mos e mbyste me erën e gojës së tij. Atij po i prishe-shin dhëmbët dhe nuk i rregullonte dot. S'kishte as lekë, as kohë.

I ati e donte. Dhe djali e kuptoi mirë, fort mirë, se sa shumë e donte i ati, atë ditë, kur kapua i oficinës, sinjor Papeti, i theu brinjët me shqelme (dhe kishin ca rrrathë të hekurt ato këpucët e kapos). Atë ditë ai, tek po punonte, theu me trapano turjelën e saj. Dhe sinjor Papeti i theu brinjët. I ati i kishte dhënë të punonte nja dy detaje me trapanon. Ai kishte harruar të shihte a ishte shtrënguar mirë turjela dhe ajo, në punë e sipër, qe liruuar dhe qe thyer. Ai kishte qarë që i qe thyer turjela, kurse kapua i oficinës u mallëngjye shumë dhe i theu brinjët. Kapua kështu nxori me të mërinë për babanë dhe punëtorët, që nuk i rrihte dot. Punëtorët ja kishin hequr nga duart kapos djalin pa ndjenja. Kapua nxori dufin e tij kundër punëtorëve. Kohët e fundit ish egërsuar akoma më shumë me ta, se partizanët zbrisnin shpesh e më shpesh nga malet në qytet dhe e kuptonte që nuk do të ishte më kapo.

Babai i kishte besuar trapanon dhe diku kishte shkuar. Kur u kthye dhe e pa të birin ashtu pa ndjenja, ulëriti si i plagosur në zemër. Ata që e panë atë çast, thanë se fytyra e tij ndërroi ngjyrën shpejt e shpejt nga e kuqe në të bardhë, sikur dikush ndizte në fytyrën e tij shpejt e shpejt herë dritën e kuqe, herë dritën e bardhë. Kështu thanë më vonë punëtorët që e panë. Djali ishte pa ndjenja, kurse babai atë ditë kishte marrë letër nga e shoqja në të cilën i thoshte se kish vdekur vajza e vogël. Ai nuk i kishte thënë akoma të birit, se

nuk donte ta hidhëronte; kurse ja, ai pesë minuta më parë e kish lënë djalin mirë dhe tashti e gjeti të vdekur, të vrrarë. Ai kujtoi se i biri kishte vdekur. Djali ishte pa ndjenja.

— Kush qe ai i poshtër, kush ma bëri gjëmën? — rënkoï duke gulçuar babai.

— Kapua ishte, o Velo. Ai qen ishte. Po lëre, se do t'i vijë ora dhe atij — i thanë punëtorët.

Babai nuk foli. Fare nuk foli. Ai mori në dorë pallakinën, që zhvendosnin tubat e gjërë të naftës, një pallakinë të rëndë, të madhe. Ai ishte bërë si i çmendur. Asnjë nga punëtorët nuk guxoi t'i dilte përpara. Kur e pa me pallakinë në dorë, kapua u zverdh, u bë i verlhë, më keq se ato kininat që pinim ne për malarjen. Ai i tha babait vetëm këto fjalë:

— Mos u tall, sinjor Veledin, mos u tall... (dhe fjalët e tjera që kish dashur t'i thoshte kapua, nuk i mori vesh njeri).

Por babai nuk tallej. Ai e goditi kapon në kokë dhe, megjithëse ky duhej të kishte vdekur qysh në goditjen e parë, e goditi prapë e prapë, deri sa ndjeu që pallakina binte mbi një gjë të qullët si baltë. Kapua nuk njihej më. As e ëma nuk do ta njihte dot. Karabinierët e arrestuan babanë dhe e pushkatun pa gjyq.

... Unë mbeta jetim, pa baba, por më mbetën shokët e babait, krevati dhe bataniet e tij. Unë e ndjeva që isha burrë. Jeta ime atë ditë fillonte. Në fshat nuk kthehesha dot, se gjyshja dhe nëna mezi mbanin motrat dhe vëllezërit e mi të vegjël. Pas disa ditësh, nga ofiçina më përzunë. Isha biri i kriminelit. Në vend të kapos erdhi një italian tjetër, kurse në vend të babait nuk erdhi njeri. Ca

ditë u enda rrugëve. Ku më zinte dita nuk më gjente nata. Shokët e babait (që tashti ishin dhe shokët e mi) më jepnin nga buka e tyre.

Në Tomorr kishin dalë partizanët. Çorovoda ishte e çliruar. Unë mora rrugën për atje. Isha i vogël, por babai dhe shokët e tij më kishin mësuar që vetëm partizanët do të na shpëtonin nga vuajtjet dhe fillova të kërkoja partizanët.

I kërkoja gjatë partizanët. Ata ishin akoma pak dhe lëviznin shumë, sepse e godisnin armikun kudo. Gjatë kësaj kohe flija herë nëpër shtëpitë e fshatarëve e herë në çobenjtë, val më val e stan më stan. Kur u takova me partizanët, ata s'deshën të më merrnin. «Je i vogël» më thanë. Unë u tregova historinë time. Por ata nuk besonin. «Do të jetë zënë me të atin, qerratai, ndaj ka ardhur tek ne» — tha njëri prej tyre.

— I lini shakatë mënjanë! — tha një tjetër.

Kurse unë fillova të qaja. Këta ishin partizanët, që do të na shpëtonin nga vuajtjet gjyshen, nënën; vëllezërit, motrat, mua dhe nuk donin të më qasnin?! Atëhere kush do të më pranonte mua? Kush do të më donte mua? Por ai partizani që tha «I lini shakatë», më mori me të mirë dhe më tha: «Partizanët nuk qajnë» Unë mendoja: «Pse të qajnë ata, përderisa janë partizanë? Po unë, që s'jam partizan, ç'të bëj? Unë duhet të qaj e të ulërij me vaj!»

— Partizanët nuk qajnë, more bir — më tha ai, — partizanët luftojnë.

Dhe më dhanë një pushkë të gjatë. Dhe unë nuk qava më. Ai që më tha bir, ishte komisari dhe i ngjante babait.

«Kur ishte luftë, kur ishim partizanë, ne flinim në këto shtëpira të varfëra fshatare, ne flinim përreth vatrës përdhe. Por ahëre nuk i thoshe dot fshatarit pse nuk kishte krevat të drunjtë, ahëre nuk i thoshe dot, por sot i duhet thënë». Kështu mendonte gjatë, atë natë sekretari i partisë së zonës malore.

...Operativi gërhinte dhe i zoti i shtëpisë, fshatari, gërhinte. Fëmijët nuk gërhinin. Në këtë moshë që ishte edhe vetë ai, sekretari, gërhinte (nuk ishte më fëmijë). Në shtëpi, në qytet, çunat i thoshin të flinte në dhomë më vete. Bile, edhe gruaja kështu i thoshte ngandonjëherë. Por ai nuk kishte dhomë të tepër, kurse në kuzhinë nuk flinte dot, atje flinte e ëma.

Të gjithë përreth tij flinin; kurse ai, ashtu i zgjuar, kujtonte jetën e tij. Pse e kujtoi sonte? Ndoshta pse kjo ishte nata e parë, që pas kaq vjetësh, flinte përsëri në një shtëpi fshatarësh. Ndofta sepse mbas kaq shumë vjetësh, njëzet e katër vjetësh, kishte ngjitur përsëri Kulmaken? Apo ndoshta sepse, pas kaq shumë vjetësh, një jetë e tërë, nuk kishte drejtuar mbledhje të organizatës profesionale të uzinës, një mbledhje të punëtorëve, por një mbledhje të kooperativës më të re malore? Dy vjet kishte kooperativa që ishte formuar. As ai nuk e kuptonte pse nuk e zinte gjumi, mbas një dite aq të lodhëshme. Kur të gjithë flinin, vetëm ai rrinte zgjuar. Ndoshta në fshat atë natë ai vetëm rrinte zgjuar? Por ai kujtoi mbledhjen e asaj dite të fshatit dhe mendoi që me siguri edhe dy njerëz të tjerë nuk flinin atë natë në këtë fshat.

Ndoshta kishte dhe më shumë që nuk flinin, por të paktën ata të dy agronomi dhe ajo, ai dhe brigadierja nuk kish se si të flinin.

Sekretari kishte udhëhequr shumë mbledhje punëtore gjatë njëzet e katër vjetve. Bile kishte udhëhequr, si presidium i mbledhjes, dhe ato të lagjes për ndarjen e shtëpive të reja, apo dhe të atyre çifteve bashkëshortore që duan të ndahen. Këto mbledhjet e ndarjeve të shtëpive dhe të bashkimit të çifteve janë nga më të vështirat për t'i udhëhequr; shpesh të shkasin nga dora, nuk i komandon dot dhe bëhet një rrëmujë që nuk kupton asgjë. Kurse ato të prodhimit në uzinë, sidoqë të jenë, nuk kanë llafe shumë. Punëtorët nuk zbuturojnë, as i zmadhojnë gjërat. Por mbledhje si kjo e sotmja nuk kish udhëhequr asnjëherë. Bile as ato të lagjes nuk janë të tilla.

Në fakt këtë mbledhje duhej ta udhëhiqte kryetari i kooperativës. Por atij ajo po i ikte nga duart. Mbledhja desh u prish fare, sikur të mos kishte ndërhyrë ai.

... Sekretar i partisë së zonës malore. Atë e kishin zgjedhur shumë vjet radhazi sekretar të organizatës bazë të uzinës, bile e kishin zgjedhur dhe anëtar të plenumit të partisë të rrethit. Ai ishte komunist i vjetër dhe e dinte që roli i tij ishte i madh. Ai ishte punëtor dhe e dinte që partia kishte nevojë për të. Por asnjëherë nuk i kishte shkuar mendja që do ta çonin sekretar partie të zonës malore. Komisar i fshatit. Kur e kishte thirrur sekretari i partisë së rrethit, ai ishte çuditur me detyrën që po i ngarkonin. Ai kishte frikë se mos nuk e bënte dot, kishte frikë se mos turpëronte

veten dhe shokët para partisë. Ai edhe shkollën fillore arriti ta mbaronte vetëm pas çlirimit duke e ndjekur pa u shkëputur nga puna. Ç'është e vërteta, ai kështu vazhdoi edhe shtatëvjeçaren (unike i thoshin atëhere); bile pati filluar dhe teknikumin e natës, por nuk e vazhdoi dot. Gruan e kishte në punë me turne, me tri turne. Vetë po me tri turne. Djemtë rriteshin dhe e la teknikumin pa mbaruar. Shokët e kritikuan, shumë e kritikuan, por ai nuk e vazhdoi dot më. Më mjaftojnë ato klasa, kish thënë atëhere. Kurse kur e ngarkuan sekretar të partisë për zonën malore, e ndjeu që shkolla s'i mjaftonte.

— Duhet ndihmuar fshati. Sidomos fshatit malor sot i duhet ndihma e klasës punëtore.

Kështu i kishte thënë sekretari i komitetit një javë më parë. Dhe tani në mbledhje, ai e pa që fshatit i duhej fryma e klasës punëtore. Ai e ndjente që do ta kishte vështirë, shumë vështirë. «Më duhej ajo qerrata shkollë tashti» — mendoi.

... I plotfuqishmi nuk flinte i qetë. Ai rrotullohej shumë dhe gati gjithmonë zbulohet. I ikte velenxa, sa herë që rrotullohej. Sekretari i partisë së zonës malore e mbulonte, sa herë që zbulohet, ashtu si dikur atë e mbulonte i ati.

«Sonte vetëm unë dhe ata të dy, agronomi me brigadieren, nuk flemë në këtë fshat». — mendoi sekretari.

Para pak kohësh kishte ardhur agronomi në fshat. Ai kishte ardhur në kohën e të mbjellave. Në këtë fshat fshatarët, deri dy-tre vjet përpara, bënë bukën, misër, vetëm për gjashtë muaj. Por para dy vjetësh kishin hapur toka të reja (kur u bënë kooperativë) dhe tokat e reja bënë grurë të

mirë. Në fakt në kuptimin që i jep fusha, gruri nuk ishte i mbarë. Por fshatarët këtu ishin malësorë dhe grurin nuk e njihnin. Ata njihnin misrin, kumbullat dhe pjergullat me rrush. Kështu që, sapo e morën vjet frutin e parë, dhe aq më tepër kur gatuan karvelen e parë me miell gruri, atyre iu duk një çudi e madhe. Atje ku hante pula gur, tashti hante fshatari grurë. Ishte me të vërtetë çudi.

Kurse agronomi i ri mendonte ndryshe: ai donte të mbillte grurë të ri, ai donte të eksperimentonte. Ai ishte i bindur që varieteti i ri, që ai mendonte, do të jepte rendiment më të lartë. Kështu mendonte ai dhe sapo erdhi, aty e tre muaj më parë, nga mesi i shtatorit (tashti ishte fillimi i janarit të vitit 1969) ua tha kooperativistëve mendimet e tij. Kështu mendonte ai, por fshatarët nuk mendonin kështu. «Ta hajë dreqi. Deri dje nuk dilte as buka e misrit, vetëm gjashtë muaj bukë bënim, tashti ngopemi e dëndemi me bukë gruri gjithë vitin, dhe agronomi — ke parë ti? — kërkon të na bëjë Muzeqe. Ore, por nuk jemi Myzeqe ne. Malësi jemi. Ç'kërkon nga ne; or tungjatjeta?» — «Të eksperimentojmë» — ngulte këmbë agronomi i ri. — «Ik, ore, në Myzeqe. Ik, ore, nga ke ardhur. Atje shko e eksperimento! Mos na bjerë më qafë kot, se do të na lësh pa bukë».

Kështu ishte ngrënë agronomi me fshatarët dhe asnjë nuk e kishte dëgjuar. «Është djalë i mirë — kishin thënë pleqtë, — por jo për ne. Kur kemi vezën sot, ç'na duhet pula mot?» — thoshin ata. Por agronomi nuk jepej kollaj. Ai ishte i ri dhe ja shtroi këtë mendim të tij për diskutim rinisë. «Dyfishin e grurit që morët sivjet do të marrim mot, në mbjellshim farën e re» — u kishte

thënë dhe ua mbushi mendjen. Dhe rinia, shokët e tij të fshatit, e ndihmuan. Ishte ajo brigadierja, që nuk duhej të flinte sonte që e ndihmoi më shumë. Me vendim të organizatës së rinisë, ju shtrua kryesisë që gruri i ri të eksperimentohej një herë në ngastrat e brigadieses, pastaj, kur të shikohej se ç'rendiment do të jepte, edhe fshatarët do të bindeshin.

— Ore, po do t'u thyejmë kokën atyre që nuk kanë besim tek ne, tek rinia — u kishte thënë kryetari i kooperativës. Pa ç'ka që tashti s'ishte hiç i ri.

— Ai e përkrahu, por dhe fshatin e përçau — thoshin fshatarët për të.

Dhe kështu fshati u nda më dysn. Mënjandë shumica, që ishin për vezën sot dhe në anën tjetër pakica, që ishin për pulën mot.

Dhe u nis një ditë, aty e dy muaj më parë (se gruri mbillet vonë në këto anë) agronomi të merrte farën e re të grurit në qytet. Qëlloi që edhe brigadierja kishte mbledhjen e komitetit të rinisë së rrethit në qytet. Ishte anëtare e komitetit ajo. Ishte aktiviste; në hekurudhë kishte qenë vullnetare. Ata e kishin lënë të shkonin në një ditë, bashkë në qytet, se rruga ishte e gjatë. Pylli ishte i madh. Kishte egërsira në pyll. Brigadierja femër ishte, çupërlinë, dhe i tha agronomit ta shoqëronte. Djalë i mirë ishte agronomi. Vajzë e zgjedhur ishte brigadierja. Dhe u nisën. Ai për farën e grurit të ri. Dhjetë kile farë. Kurse ajo për mbledhje. Kur ata ikën në mëngjez, pak kush e mori vesh nga fshati që ata u nisën bashkë në rrugën e gjatë, në pyllin e madh... Kur u kthyen, se e priti agronomi brigadierën sa të mbaronte mbledhja, u kthy-

en bashkë. Këtë e mori vesh gjithë fshati, se atë ditë në arat rrëzë malit të fshatit mungoi agronomi dhe brigadës i mungoi brigadierja.

Agronomi ishte beqar, kurse brigadierja ishte e fejuar. Turpi që kishte bërë ajo, duke gjezdisur qytetit me burrin e botës, nuk kishte ndodhur kurrë atje dhe e tronditi gjithë fshatin. «Edhe gurët e sokakut» — thotë kënga, edhe këtu kështu ndodhi, edhe gurët sikur lëvizën nga vendi.

Agronomi ishte djalë i mirë. Brigadierja ishte vajzë e mirë. Asnjë njeri nuk kishte menduar për keq. Fshati ishte i mirë. Njerëzit ishin të mirë; asnjëri nuk mendonte keq, se nuk e donte të keqen njeri. Por ata ishin lindur e rritur në këtë trevë, që thotë se, po u bashkua femra me mashkullin, qoftë edhe për pesë dekika, prite pas fesatin. Turpin e ka gjithë fshati. Dukej sikur kjo ndjenjë e turpit të fshatit ishte një diçka jashtë ndërgjegjes së fshatarit, jashtë dëshirës së tij, sikur ajo vinte nga lart (si ato retë nga deti) dhe ulej në mes të njerëzve (si retë në majë të Kulmakës) dhe ata nuk kishin se ç'i bënin (si dhe maja e Kulmakës që nuk ka se ç'u bën reve), por prisnin vetëm rrebeshin që sillte ajo me vete. Ç'rrebesh do të vijë? Mjerë ata që do t'i zërë!

Brigadierja ishte e fejuar. I ati dhe vëllezërit e së fejuarës, po të ishte kohë e parë, duhej ta lanin turpin me pushkë. Por ligjet ishin të reja, ligje punëtorësh, që nuk e lënë brigadieren ta vrasë njeri. Dhe ata nuk e vranë, as e nganë, por thanë atë ditë që e prishën fejesën për turp të brigadieres. Dhe brigadieren me turp nuk e pranuan as prindërit e saj atë natë. I fejuari i saj ishte ushtar. Kur vajzën nuk e qasën në shtëpi prindërit e saj,

atëhere dhe shtëpitë e tjera të fshatit s'kishin pse ta qasnin. Dhe ajo do të kishte mbetur midis arës që sapo e kishin mbjellë me grurin e ri. Por kishte të rinj dhe të reja, shokë e shoqe, që do të bashkoheshin me të e do të kalonin natën tok pranë ugarëve të freskët, si buka e ngrohtë. Por puna nuk arriti deri aty. Brigadieren e mori në shtëpi kryetari i kooperativës, i cili tha ato fjalë që nuk i harron fshati sot e kësaj dite: «Turqit vërtet kanë ikur, që kur erdhi Ismail Qemali, por zakonet e tyre të vjetra kanë mbetur akoma në fshatin tonë». Është pa shkollë kryetari. Partizan ka qenë. Bandat ka luftuar dhe e do partinë më shumë se jetën, më shumë se kalamajtë. Dhe meqë partia ka thënë që të rriten rendimentet, dhe ai ishte për rendimentet; meqë partia thotë të venë vajzat në mbledhjet e rinisë e të partisë në qytet e më tej akoma, dhe ai ishte që vajzat të venë në mbledhje. Ai i tha brigadieses të flinte në shtëpi të tij, me fëmijët e tij. Ai ishte i vetmi komunist në fshat. Para ca muajsh kishte qenë dhe Brahimi, po ai kishte zënë punë tashti në Poliçan. Brigadierja fjetei atë natë dhe netët e tjera më vonë tok me fëmijët e të vetmit komunist të fshatit, kurse agronomi, të cilin po ashtu e zbuani nga shtëpia ku flinte (se i zoti i shtëpisë nuk deshë të bënte hasm fshatin), shkoi e fjetei qysh prej asaj nate me mësuesit e shkollës.

Dhe kështu u thellua më keq lumi, që filloi të ndante fshatin e vogël malor.

Brigadierja flinte te kryetari, agronomi te shkolla dhe fshati ziente për disa ditë me radhë. Kur mori vesh ushtari, i fejuari i brigadieses, u shkroi prindërve që të mos merreshin me thashe-

theme; por, në qoftë se vajza nuk e donte, le t'i shkruante vetë. Ai i shkruajti një letër tjetër vajzës.

Ja, ky ishte pra fshati i parë, ku filloi punën sekretari i ri i partisë së zonës malore; ky ishte fshati, ku e kishin këshilluar të jetonte së pari, shokët e partisë së rrethit, sekretarin e ri.

Atë mbrëmje u bë mbledhja e asamblesë. Do të zgjidhej kryetari i ri i kooperativës. Ata, malësorët, s'kishin ç'të thoshin për kryetarin që kishin. Ai që punëtor si ata, i ndershëm si ata dhe më i drejtë se ata. Por vetëm zakonet e liga ky kryetari i tyre i urrente më shumë se ata. Por pse e mbante në shtëpi vajzën e botës, pse e bëri si bijë vajzën e botës, partia nuk thoshte të mos e zgjidhnin kryetar. Dhe fshatarët thanë të mbetej përsëri si kryetar. Kurse për agronomin thanë të shkonte në Myzeqe; «andej nga ka ardhur të vejë. Nuk i kemi vajzat të na i shalojë ai, nuk i kemi për t'i hedhur poshtë» thoshin.

Sekretari i partisë së rajonit malor shihte malësorët e tij, shokët e tij të rinj, që nuk e donin agronomin. Agronomi shihte brigadierin, që, me sa dukej e donte, kurse brigadierja e shihte agronomin dhe përdridhte çipin e shamisë.

Sekretari e mbrojti agronomin atë mbrëmje dhe u tha që partia e kish dërguar agronomin të kryente punën dhe, në kish bërë punë të poshtra, thoshte, ta dënonin. «Por punë të poshtra nuk ka bërë» tha. «Thonë që e do vajzën tuaj. Por edhe në e do, ç'të keqe ka? Po e deshi dhe ajo, le ta marrë.»

— Si punëtor nuk ka si e shajmë — thanë shokët. Por që është rrufjan, është rrufjan — thanë disa prej tyre.

Agronomi shihte brigadieren. Ç'i kishte thënë vallë atë ditë që vajtën në qytet ai asaj? E ç'i kishte thënë ajo atij? Asnjë nuk e di. Bile, as sekretari i ri.

...Ajo mbledhje kishte qenë e vështirë. Ndoshta kështu do të jenë të gjitha ditët që do të vijnë.

Nata ishte e gjatë. Sekretari mendonte për të gjithë. Po vinte një ditë e re dhe këndezët, që s'mendojnë për njeri, filluan të këndonin; të parët që i dëgjuan këndezët qenë sekretari i partisë së zonës malore, brigadierja dhe agronomi. Dhe të tre ata ishin të parët që filluan atë ditë të ngriheshin nga shtrojet e tyre. Dita do të ishte e mirë. Grurin e kishte mbuluar bora. Dielli ndriçonte dhe bora të verbonte. Njerëzit po zgjoheshin, kurse toka dhe gurët flinin nën borë.

AJO

Ajo është ulur pranë meje dhe unë çuditem se si ne u mësuaam aq shpejt me të. S'kanë kaluar dy muaj që ajo erdhi në qytetin tonë, dhe neve na duket sikur ka vite që jeton me ne; të paktën mua kështu më duket. Ajo flet, ajo po më përgjigjet se çfarë janë foraminiferët. Domethënë foraminiferët janë njëqelizorë. Po njeriu çfarë është? Njeriu natyrisht është shumëqelizor. Qelizat formojnë indet, indet formojnë organet...

Ajo është ulur pranë meje dhe flet. Ajo kujton se unë po dëgjoj për format karakteristike të foraminiferëve të miocenit në Shqipëri. Por unë atë s'po e dëgjoj fare. Sikur ajo të kishte folur kaq shumë dy muaj përpara, kur erdhi në qytetin tonë të vogël, sa një fshat i madh, me siguri që sot nuk do të kishte rast të fliste. Qyteti ynë punëtor nuk i duron njerëzit, që flasin shumë. Por ajo para dy muajve nuk fliste fare. Para dy muajve, kur erdhi, ajo heshtte dhe na lejonte neve të trillonim turli historira për ardhjen e saj.

...Ajo atë ditë zbriti nga autobusi i vjetër i qytetit tonë të ri, aty te sheshi. Dhe gjëja e parë që pa ishte shkolla e re dhe fuçitë e bitumit. Asaj

nuk i bëri përshtypje shkolla, por fuçitë e bitumit. Pyeti se ku ishte hoteli dhe, si mori vesh se ku ishte, u nis për atje.

Kur erdhi ajo, ishte vjeshtë dhe në vjeshtë qyteti ynë është i bukur. Gjethet e plepave bien dhe mbulojnë asfaltin e ri të rrugëve me një sixhade të artë. Dhe ajo po shkelte mbi gjethet e thatë të plepave.

Asaj filloi t'i vinte keq për gjethet që shkelte, dhe, deri sa arriti te hoteli, mendoj se sa e shkurtër ishte lumtëria e gjetheve të plepave: vetëm një pranverë. Por ajo a kishte qenë e lumtur vetë? Në qoftë se gjethet janë në pranverë, atëhere sa pranvera kishte qenë e lumtur ajo? Asaj nuk i pëlqeu t'i përgjigjej pyetjes, që i bëri vetëvetes dhe i hodhi mendimet te hoteli. A do të gjente vallë vend? Një pyetje e tillë për hotelin e qytetit tonë s'kishte kuptim. Tek ne mund të mos gjesh gjëra të tjera, por vend në hotel për një femër e gjen me siguri. Ajo nuk e dinte këtë para dy muajve dhe ishte e natyrshme një mendim i tillë për të. Asaj i dhanë dhomë teke.

Në mbrëmje hëngri darkë në restorantin, që ndodhej në katin e parë të hotelit. Kështu që pak njerëz e panë dhe e vunë re ardhjen e saj në qytet. Por nga kolegët e mi gjeologë kishte dhe disa që vonoheshin mbrëmjeve e nuk arrinin të hanin në mensën tonë; atëhere shkonin në restorantin e hotelit. Dhe aty ata e panë atë. Por nuk e panë vetëm. Ajo po hante darkë me kolegun tonë dhe shokun tim më të ngushtë, Dhimitrin. Dhimitri është inxhinier si unë dhe po si unë merret me mikrofaunën e lashtë të shtresave.

Atë natë krevati i tij, në dhomën tonë të ka-

panonit të beqarëve, mbeti i paprishur. Hotelxhiu i qytetit tonë kishte thyer ligjet duke lejuar dy njerëz të pancelebruar të flinin në një çati. Më të nesërmen Dhimitri nuk erdhi në punë. Përgjegjësi i laboratorit tonë të vogël i preu ditën e punës. Mua më erdhi keq dhe i thashë që kampionet e Dhimitrit do t'i përcaktoja unë. Përgjegjësi m'u përgjegj: «Kampionet përcaktoji po të duash jo vetëm të atij, por dhe të të gjithë laboratorit. Por ligji është ligj. Kur mungon në punë të pritët rroga. U largova tërë inat nga zyra e tij. Aty nga dreka Dhimitri më mori në telefon dhe më tha: «Thoma, mos e ki merak që nuk fjeta në dhomë. Dje erdhi Marianthi. E mban mend? Dhe sot isha në Komitet të Partisë për t'i rregulluar punë».

Unë natyrisht e mbaja mend Marianthin. Portretin e saj e shikoja çdo mëngjez e çdo mbrëmje në komodinën e shokut tim. E, megjithëse e mora vesh se kush ishte «femra nobël» për të cilën bisedohej gjithë ditën në laborator, unë nuk mund ta fshihja habinë time. Dhe kisha të drejtë të habitesha se Marianthi vërtet i kishte dhuruar një fotografi të saj Dhimitrit, por ajo ishte e martuar me një burrë tjetër dhe, veç kësaj, jo vetëm që ishte e martuar, porse bashkë me burrin e saj jetonte në një nga ambasadat tona, nuk më kujtohet se ku. Dhe lajmi që më dha Dhimitri kishte shumë për t'u çuditur. Megjithatë unë e urova atë për ardhjen e Marianthit dhe, meqë ato ditë mua më duhej një laborante, i thashë t'u thoshte në Komitetin e Partisë për një mundësi të tillë pune. Ai më falënderoi për idenë time dhe më tha se do të përpiquej t'ja arrinte qëllimit.

Unë lashë receptorin e telefonit, por, mbas

këtlj bisedimi telefonik, nuk isha më në gjëndje të punoja. Foraminiferat studjohen në mikroskop dhe mikroskopi do vëmendje të madhe. Një gjë të tillë nuk isha në gjëndje ta bëja më. Shqisat e mia e ndjenin veten të dërmuara dhe të paaftha për një punë të tillë, mbas lajmit që më kishte dhënë Dhimitri.

Unë fillova padashur të kujtoja Marianthin, domethënë portretin e saj e bashkë me të solla ndër mend se ç'e lidhte atë me shokun tim më të mirë.

Gjithmonë shoku im e kishte dashur atë grua. Natyrisht, kur them gjithmonë, kam parasysh që ditën që ata u njohën. Ata u njohën ashtu si të gjithë nxënësit e Politeknikut «7 Nëndori» mund të njihen me vajzat e pedagogjikes. Ata u njohën në një nga ato mbrëmjet e vallëzimit, që në fillim të viteve pesëdhjetë organizoheshin me torona ose hallva. Në të tilla mbrëmje të gjithë venin. Nuk mungonte njeri. Shoku im hante hallvë, atëhere kur morën damat fuqinë. Ajo erdhi e ftoi të kërcenin. Ai i tha se nuk dinte të kërcente. Asaj i vinte turp të kthehej «e refuzuar» te shoqet dhe i tha: «S'ka gjë, të mësoj unë». E, meqë vajza që po e ftonte ta mësonte, kur të bëhej mësuese me siguri që do të ishte jo vetëm pedagoge e mirë, por dhe fort e bukur, ai iu bind dëshirës së saj. Pak njerëz e vunë re dobësinë e tij në tango.

Ashtu ata u njohën. Mbas dy vjetësh ata mbaruan shkollën e mesme. Gjatë këtyre dy vjetve ata i bashkuan me dhjetëra herë fatet e tyre në jetë. Ëndërruan shumë gjëra të bukura deri dhe «në dashurinë gjer në varr».

Veçse, mbas pushimeve të verës, kur ai u kthye nga fshati në Tiranë të vazhdonte studimet, ajo

ishte martuar me një punonjës të Ministrisë së Jashtme dhe, si kishin kaluar pesëmbëdhjetë ditë në plazhin e Durrësit, kishin fluturuar mbi fshatin e shokut tim për në Afrikë.

Natyrisht që ikja e saj jo vetëm që nuk pritej nga shoku im (ca kohë më vonë ne u njohëm me Dhimitrin në fakultet), por dhe kur mori fotografinë e saj, që nga ato vende të largëta, ku burri i saj ishte me shërbim, atij iu duk sikur fotografia nuk ishte e saj, kurse Marianthi do të ishte në Korçë me nënën e saj plakë e të mirë. Ai është njeri shumë i ndershëm, prandaj nuk mund të besonte se njerëzit mund të mashtronin në këtë mënyrë.

Kur Dhimitri më tregoi lidhjen e tij me atë, unë u përpoqa t'i mbushja mendjen që të mos mendonte më për të. Por kjo ishte diçka e pamundur. Megjithëqë në semestrin e parë ai e pati vësh-tirë nga ikja e saj, i mori provimet mirë dhe më vonë rezultatet e tij ishin shumë të mira. Ai dilte me të gjitha pesa. Ajo i shkruante herë pas here letra. Diku thellë ajo e kuptonte gabimin e saj. Dhe, megjithëqë letrat nuk kishin asgjë kompromentonjëse para burrit të saj, unë që e dija historinë, kur dëgjoja Dhimitrin që m'i lexonte, e ndjeja që ajo, qoftë dhe me fjalët «koha është e bukur këtu, me siguri në Tiranë bie shi» përpiqej t'i kujtonte atij që ajo dhe kur është koha e bukur atje, mendon për kohën e keqe në Tiranë.

Ai më thoshte: «Ajo është fëmijë, Thoma, e kupton? Asaj i pëlqeu Orienti, egzotika, Afrika, andaj dhe iku. Por kur të kthehet në Shqipëri dhe kur të mos ketë më Afrikë dhe diplomaci, ajo do të vijë tek unë. E merr vesh, ajo do të velet me

Afrikën ashtu siç velen dhe fëmijët me karamele, apo ashtu siç u mërzhiten të njëjtat lodra». Kurse unë me atë singeritetin tim të pavend, i thosha: «Në është e mërzhitur me të shoqin, atëhere dhe me ty do të velet; në mos është velur akoma, atëhere do të rrijë me Afrikën.» Ai më shikonte me përbuzje, si njeri që s'di të çmojë virtutet e njerëzve.

Se kush kishte të drejtë atë vit, e tregoi koha. Unë u martova, por, meqë s'kisha shtëpi, vazhdoja të jetoja në fjetoren e beqarëve, kurse ai vazhdonte të priste Marianthin. Mua s'më pëlqente kjo pritje, po, meqë kritikant e mia hasnin rezistencë të fortë dhe shpeshherë përfundonin në grindje, dhe unë, ashtu si ç'do të velej Marianthi me Afrikën, u vela me grindjet me të.

Të gjitha këto m'u shfaqën një herë të shkëputura atë ditë kur më mori në telefon Dhimitri.

Më vonë unë u njoha me Marianthin. Ajo nuk ishte aq e vogël sa e kujtoja, por as budallaqe, siç e shpresoja unë. Kur u fut në punë në laboratorin tonë, dhe kur laborantet e tjera e ngisnin për Afrikën, ajo fliste aq pak, sa ishte më mirë të lexoje gazetën, se sa të dëgjoje atë. Ne i lëruam Dhimitrit e asaj një dhomë të kapanonit tonë. Dhe në qoftë se përpara ne mund të shaheshim si të na vinte për mbarë, tashti e dinim që në një korridor me ne banonte dhe ajo. Padashur ajo shërbeu si një mjet edukimi. Një ditë ajo lau së bashku me këmishët e Dhimitrit dhe timen.

Para një muaji, tek po e pyesja në kursin e kualifikimit se ç'është klima subtropikale, se si më erdhi dhe e pyeta se çfarë klime ka Afrika. Ajo m'u përgjegj: «Bënte shumë vapë atje, tmerrësisht vapë». Unë nuk e njoh burrin e saj të parë, por

kur një grua mban mend vetëm vapën, më shkon mendja në shumë gjëra...

Unë shoh Marianthin tek më flet për njëqelizorët dhe mendoj sa shpejt që u mësuam ne me të. Nga përvoja unë di që vetëm me njerëzit e mirë mësohet shpejt njeriu. Atëhere fajin që ajo e la burrin e kishte ai? Jo. Ndoshta, bile, ndoshta nuk e kish fajin as ai, as dhe toka e huaj, me të cilën ajo nuk u mësuua dot, por me siguri rinia e saj e nxituar, e pakaluar në vështirësi, në bukurinë e madhe të jetës, në punën. Shumë gjëra janë të paqarta për mua në këtë histori. Veçse për një gjë unë jam më se i qartë, që qyteti ynë punëtor është shumë më i dashur për të se Afrika dhe me siguri ajo zor se do të dëshërojë të ndahet nga ne, nga njerëzit e këtij qyteti, ashtu siç u nda nga Afrika.

RUAJTËSI I THESARIT

Bënte ftohtë. Fëmijët më të mëdhej, dy vajzat dhe djali i madh, flinin. Zjarri në vatër ishte në të shuar. Dru s'kishte t'i hidhnim më, dhe zjarri po shuhej. Gruaja i frynte më të rrallë prushit të pakët, që kish mbetur, se kështu i dukej se i shtonte jetën, se e bënte atë të ngrohte njerëzit, burrin dhe fëmijët. Ajo i ngjante kujdestarëve të zjarrit në lashtësi, kur nuk ishin shpikur veglat e zjarrit, që ruanin ditën e natën të mos shuheshin zjarret.

Kur i frynte prushit, ngrihej hiri si pluhur dhe ajo fillonte të teshtinte. Atëhere burri e merrte vesh që ajo po i frynte zjarrit dhe, padashur, instinktivisht, kthente kokën andej nga ajo dhe kur kongjijtë e prushtë ndrisnin, ai shihte herë fytyrën e së shoqes dhe herë gjirin e saj.

Ajo ushqente foshnjën, por qumësht nuk kishte dhe djali i vocërr, që nuk ngopej, qante. Kurse ajo përpiquej të ndizte zjarrin dhe të shuante të qarën dhe urinë e fëmijës. Kur ajo i frynte zjarrit, errësira e dhomës epej për një çast dhe vetëm për këtë çast harroje që në qytet nuk kishte më central elektrik. Atë e kishin hedhur në erë, para tri ditëve, gjermanët. Ata ishin larguar dhe në të ikur

e sipër kishin dashur të linin një kujtim të ri për njerëzit e qytetit, sikur nuk mjaftonin të tjerat...

Qyteti kishte dy ditë që ishte çliruar, por as furnizimi me ujë, as dritat dhe as drutë për zjarr nuk i kish siguruar akoma. Për të varfërit ishin hapur mensat popullore. Atje hanin tashti gruaja, fëmijët dhe burri.

«Sa është dobësuar!» — mendoi burri. Ndoshta mendoi kështu për të birin, foshnjën që qante, që nuk e pushonte dot as sisa e tharë e bërë eshkë e gruas dhe as kënga e nënës «llullullaj, llullullaj — djali i vogël, mos më qaj». Ndoshta ai mendonte: «Sa është dobësuar!» për të shoqen. Dhe ajo ishte hequr shumë. Djali i vogël qante dhe herë-herë diçka belbëzonte, diçka të tillë që mund të merrej si një vetëpërpjekje për gjumë...

— Ai, kur të lodhet, do ta zërë gjumi e do të pushojë — tha burri. — Kot lodhesh me të.

— Nuk kam qumësht fare — tha gruaja.

— Të thashë, ta kishe ngrënë edhe pjatën time të supës. Të thashë të haje. Nuk më dëgjove. Ua ndave vajzave. Me se do ta ushqesh, po nuk hëngre? Ai ka nevojë për gjirin tënd — tha burri.

— Po ti? Ti nuk ke nevojë, nuk je njeri ti? — pyeti gruaja.

— Unë jam burrë, bëj dhe pa pjatë me supë. Ai nuk bën dot. Nesër do ta hash ti! Dëgjon? — foli me inat burri.

E shoqja nuk iu përgjegj. Ai kishte frikë se mos gruan e zinte gjumi. U dëgjua përsëri e qara e fëmijës dhe burri e kuptoi, që gruan nuk e kish zënë gjumi; s'kish si ta zinte gjumi kur djali qante.

Ajo duhej të ishte mbështetur në mur. Ai për vete ashtu ishte mbështetur dhe në errësirë kishte

drejtuar sytë në një pikë. Ja, atje, mbi buhari, pranë vendit ku varin llambën që përdornin kur priteshin dritat elektrike në qytet. Kjo ndodhte shpesh vitet e fundit. Tashti nuk kishte vajguri në treg dhe llamba rrinte e shkretë, e varur, si një relike pa vlerë. Pikërisht në atë vend ishte një kuti teneqeje, sa ato kutitë e këpucëve me numër dyzet e dy. Ai për këtë kuti donte të fliste me të shoqen. Kurse e shoqja donte të vinte fëmijën në gjumë. Për atë çështja e asaj kutisë në buhari nuk ekzistonte fare. Për burrin ajo kuti kishte qenë problemi më i madh në ato dy ditë, që ishte çliruar qyteti. Kurse për gruan ajo nuk ishte asgjë. Bile për të kjo ishte më e lehtë se larja e pelenave të foshnjës. Ajo ja tha që atë ditë, kur ai u vu në kërkim të njerëzve për të dorëzuar kutinë.

— Pse i bezdis njerëzit, mor njeri. Lufta mbaroi dhe secili ka hallet e veta, bën jetën e tij të re. Kurse ti me atë kutinë mbushur me letra. . . Kush ua ka ngenë atyre — i tha ajo dje në mëngjez të shoqit.

— Si, kush ua ka ngenë? — u çudit ai.

— Tamam kështu: kush ua ka ngenë! Po t'u duhen, ata do vijnë t'i kërkojnë vetë — tha ajo.

— Jo. Nuk është e thënë që patjetër duhet t'i kërkojë dikush. Mundet që ata që duhet t'i kërkonin janë vrrarë në luftë. . .

— Ahere kujt do t'i duhen?

— Unë duhet t'i çoj vetë. Pse, patjetër duhet t'i kërkojnë ata?

— Bëj si të duash — tha gruaja.

Dhe ai kishte dy ditë, që bënte çmos për të gjetur shokët ose njerëzit që duhet të kërkonin kutinë.

Djali i vocërr nuk dëgjohej më. «E zuri gjumi» — mendoj burri.

— Edhe sot u lodha kot — tha burri.

— Të thashë që dje. Kush s'ka kokë ka këmbë. Mos u lodh duke kërkuar kot. Kushedi ku janë ata. Mbase s'janë fare — tha ajo.

— Mbase luftojnë në veri. Kushedi, mos luftojnë në Jugosllavi — tha burri.

— Ç'rëndësi ka. Në qoftë se janë gjallë, do të kthehen edhe ahëre dorëzojua atyre — tha gruaja.

— Por nuk mund t'i mbaj më, nuk mund t'i mbaj kaq gjatë. Unë isha i ngarkuar t'i ruaja ato me nder e faqe të bardhë deri sa të mbaronte lufta...

— Ti i ruajte ato. Ç'do më tepër? — ndërhyri gruaja.

— Për disa lufta mbaroi, dikush tjetër duhet t'i marrë ato. Dikush do jetë i kësaj pune. Duhet të ketë rregulla, ligje. Kështu duhet të jetë. Unë nuk jam komisar i financave, unë jam punëtor i minave. Minator jam dhe në minierë nuk i marr dot vetë. Ato patjetër duhet të dorëzohen — tha burri. Po të kishte dritë, gruaja do të shihte që ai drejtoi përsëri shikimin nga prevazi i buharisë, ku ishte kutia...

— Lëre këtu. Kujtdo që do ta kërkojë, unë do t'i them që ti je në minierë. Po t'u duhet pa derman, le të vijnë të të gjejnë atje — tha ajo, që kurrsesi nuk e kuptonte dot pse i shoqi lodhej duke kërkuar zot për kutinë...

— Jo, punë që s'bëhet. Njerëzve do t'u duhen ato dokumenta...

— Po t'u duheshin vinin e i merrnin — e ndërpreu përsëri gruaja.

Ai heshti. Nuk dinte ç'ti thoshte. Miniera duhej të hapej në mos atë javë, tjetrën. Qyteti ishte pa dritë, por centrali do të rregullohej dhe atij do t'i duhej qymyr guri. Burri ishte minator dhe vendi i tij ishte atje, në minierë. Po vendi i kutisë ku ishte? Ku duhej të ishte? Mos vallë atje mbi buhari? «Kurrsesi» mendonte burri. «Sikur unë të iki pa dorëzuar kutinë, ç'do mendojnë ata shokët, që ma dorëzuan? Ç'do të kujtojnë ata? Ore, po mirë thotë kjo, — kishte parasysh të shoqen — ku janë ata? Pse nuk i takoj dot në asnjë vend... S'është e mundur të jenë vrarë të gjithë!»

Ai kishte dy ditë që i kërkonte njerëzit për t'u dorëzuar kutinë. Shokët e tij minatorë ca ishin nisur e ca do niseshin atë javë për në minierën e mbyllur. Dhe ai do nisej, por ç'të bënte me kutinë?

Kishte tre vjet që miniera ishte mbyllur, që kur dolën partizanët e parë në malet. Shumë nga minatorët u bashkuan me partizanët. Të tjerët zunë punë të tjera ose mbetën pa punë, por miniera u mbyll. Ajo u mbyll sepse partizanët nuk e linin qymyr gurin, t'u shkante okupatorëve ku donin ata. Kurse njerëz të tjerë, që të nxirnin qymyrin, ata s'gjenin dot. Miniera ishte në male dhe në male ishin partizanët. Ai, burri, që sonte nuk donte që të flinte e shoqja, ishte minator i mirë dhe njeri i ndershëm. Ai kishte punuar në minierat e Alsas-Lorenës dhe të Sent-Étienit. Ai kish punuar dhe në minierën e mbyllur. Dhe atij qarkori i partisë i kishte besuar në luftën, që sapo mbaroi, një detyrë të veçantë, që s'kish të bënte fare me minierën, por kish të bënte me ndershmërinë mi-

natore. Ai ishte i ndershëm si minator dhe këtë e dinte mirë qarkori... Pastaj ai vetë kish dalë partizan... Dhe ja, tashti, ishte kthyer, por shokët nuk i ishin kthyer të gjithë...

...Ajo ishte kuti fare e zakonshme. Po të kishte dritë sonde, ai do ta merrte në dorë dhe do ta provonte, që tashti ajo ishte fare e lehtë. Para disa muajsh ajo ishte shumë më e rëndë dhe nuk rrinte atje, mbi buhari, por nën dhe. Në, ato dërrasat ku flinin tashti fëmijët e mëdhenj. Ja, mu te këmbët e vajzës së vogël. Para disa muajsh fëmijët e minatorit flinin mbi florinj. Po, po, mbi florinj të pakët, por sidoqoftë florinj. Fëmijët flinin mbi thesarin e partisë, të qarkorit. Ajo kuti që mund të merrte këpucët me numër dyzë e dy, ishte dje, jo, deri pardje në luftë, ishte thesari i partisë. Dhe mbi këtë thesar flinin fëmijët. Ata nuk flinin tamam mbi thesar; midis thesarit dhe fëmijëve, ishte dheu, dërrasat e kalbura, rrogozi dhe dysheku me kashtë. Kjo ishte e vërteta

...Sa e kërkuan atë thesar të vogël (por që bënte shpesh punë të madhe) italianët, gjermanët dhe njerëzit e vendit të vënë në shërbim të tyre. Ku nuk e kërkuan atë? Për cilin komunist ata nuk dyshuan? Por asnjërit prej tyre nuk i shkoi ndërmend, që ai thesar i vogël i partisë, ajo djersa dhe mundimi i punëtorëve dhe i fshatarëve të kësaj ane, që jepej në formë ndihmash për luftën, ndodhej atje, ku shtriheshin tashti këmbët e vajzës së vogël. Bile dhe fëmijët nuk e dinin, që ato net të luftës flinin mbi flori. Se ndryshe, me siguri, do shihnin ëndrra nga më të çuditshmet, sidomos ato net, kur nëna u tregonte përrallën e thesit me para.

Thesari ishte disa qindra napolona. Partizanët luftonin në male, por në qytetet e okupuara njerëzit, që ishin për luftën çlirimtare, bënë punën e tyre. Në qytet bëheshin atentatet, rrëmbimet e depove e bile dhe të zyrave të okupatorëve dhe njerëzit e varfër jepnin kursimet e tyre të pakta fare, të lëna për një ditë të zezë (por a kishte ditë më të zeza se sa vendi nën fashizmin?) për të ndihmuar partizanët. Paratë e njerëzve të varfër, që bënë luftën, ishin të pakta. Vetëm disa lekë apo disa franga. Por njerëzit e varfër ishin të shumtë dhe, megjithëse kursimi ishte i vogël, prapëseprapë kishin aqe të holla sa të krijohej thesari.

... Sikur të kishte dritë sonte, minatori do të shfletonte letrat që kishte tashti kutia. Ato ishin vërtetime pa vula, vetëm me firma emrash të rreme (pseudonime) të njerëzve të ndryshëm, që vërtetonin se kishin marrë kaqe apo aqe para për këtë apo atë punë.

Vërtetimi i parë: 17 napolona për ilaçe të çetës së Dajtit.

Vërtetimi i dytë: 11 napolona e 7 franga për rrobat e shokëve të Pezës.

Vërtetimi i tretë: 5 franga për një shishe benzinë, ndoshta për të djegur fashon.

Vërtetimi i katërt: 1 napolonë për të blerë bojën e shkrimit të shaptilografit të «Zërit të Popullit»

Vërtetimi i pestë: 10 dollarë për të shtënë në dorë letërnjoftimin fallco të shokut...

Vërtetimet vazhdojnë kështu si një skedar i mirë biblioteke. Minatori nuk e dinte që kishte bërë një skedar të vërtetë me to. Ai kishte qenë në Lion dhe Bruksel, por në bibliotekë s'kish qenë ndonjë-

herë... Në minierë, po... Dhe atij i dukej se kjo që bënte ishte një diçka e panjohur. Çdo vërtetim ishte një skedë më vete, që, po t'i bëje historinë e tij, patjetër dilte një motiv i bukur për një libër me vlerë. Por ai nuk ishte bibliotekar dhe tashti që mbaroi lufta ai donte t'i dorëzonte këto skeda...

Ai (sikur të kishte dritë sonte) do t'i shfletonte vërtetimet (njëqind e njëzet e tre vërtetime) me kujdes si një biblioman i mirë. Po dritë s'kishte dhe në anë tjetër ai nuk donte të sillte më ndër mend vërtetimet. Shumë nga ata që kishin lëshuar vërtetimet ishin vrarë. Ai këtë e dinte. Ata kishin qenë njerëz trima dhe të besës, ata kishin qenë komunistë të vërtetë. Sikur njëri nga këta të njëqind e njëzet e tre të tradhëtonte, minatori nuk do të kishte mbetur gjallë. Sa herë shfletonte shkresat e të vrarëve, gjithmonë i dilnin parasysht ata, ashtu siç kishin qenë, kur kishin lëshuar vërtetimet; dhe, kur i prekte letrat e tyre, atij i dukej sikur prekte duart e tyre dhe nuk i besonte dot vetes që shumë nga ata ishin vrarë.

Kish ndodhur që njeriu, për të cilin ishin blerë ilaçet, ishte shëruar, por ai, që kish blerë ilaçet dhe i kishte dorëzuar vërtetimin rojtësit të thesarit, mbas disa ditësh ishte vrarë në përpjekje me gjermanët...

I kish ndodhur...

«... Ah, po atë ditë, thoshte me vete, duhej të merrej me qira një kamion për të transportuar armë apo miell, a ndoshta të dyja bashkë, nuk më kujtohet. Por puna ishte se duhej kamioni. Shoferin e kishim. Ishte një nga shokët tanë. Por kamion nuk kishim. Atë mund ta rrëmbenim, por në këtë rast nuk udhëtoje dot me një kamion të tillë.

Çdo patrullë, apo çdo postblok mund të të zbulonte dhe të sekuestronte mallin fare lehtë dhe shoferit i rrezikohet jeta. Mënyra më e sigurt ishte të merrje kamion me qira. Kështu mallin e kaloje pa rrezik.

«Ishin ditët e shkurtit, të atij shkurti të lig, që na vrau aqë shokë dhe kontrolli në qytet ishte si mos kurrë. Në çdo çap patrullë gjermane apo mercenarësh të Xhaferr Devës... Atë ditë unë vajta të këmbeja një sahat floriri me dollarë. Ne mund t'i jepnim edhe sahatin atij pronarit, që jepte maqina me qira, por kish rrezik që ai të dyshonte. Nga e gjetëm sahatin e florinjtë? Ata shokët tanë partizanë ja kishin gjetur një oficeri gjerman të vrarë. Kish pra rrezik të dyshonte si pronari i maqinave dhe ne menduam të kthenim sahatin në dollarë apo napolona letër. Më mirë kështu!

«Qyteti ishte zgjebosur me ballistë e mercenarë dhe shokët më ngarkuan mua, që nuk bija aqë në sy, për të thyer sahatin me para. Sarafi ishte matanë rrugës mbretërore, te kthesa e farmacistë. Unë shkova te sarafi dhe ai u çudit se ku e kisha gjetur sahatin e florinjtë. Ai blente cigare tek unë. Unë i thashë që e kisha të Francës. Ai e dinte që unë kisha qenë në Francë. Ndoshta ai nuk besoi, por sahati ishte i vyer dhe ai ishte saraf tamam, nuk mund ta linte t'i shpëtonte një rast i tillë. Ma çmoi sa deshi. Unë mora paratë dhe ika. Nuk i numërova fare sa më dha. Gjithë rrugës, kur shkova dhe kur erdha, kisha vetëm një hall: mos më plaçkisnin ballistët. Ata të kontrollonin shpesh dhe të vidhnin në mes të rrugës... Po të më merrnin paratë, të tjera s'kishim (aqë sa kërkonte pronari i parkut) dhe kamioni mund të mos gjendej më.

«Kur u ktheva në shtëpi, gjeta që më kishin

ardhur për «vizitë» mercenarët e Xhafer Devës. Po të kontrollonin tashti, do të më gjenin vetëm vërtetimin që paratë i kishte marrë shoku: X. Le të më kontrollonin, paratë ishin siguruar dhe ata më merrnin të keqen... Më vajti mendja te sarafi, thashë me vete që do më kishte spiunuar... Por mercenarët e Xhaferit kërkonin batanie. Meqë nuk gjetën batanie, na vodhën dy shkorsat që mbulohehin fëmija. Atë natë e më pastaj fëmijët mbulohehin me pallton time... Kurse kamioni të nesërmen u nis për në jug... Po...»

— Ç'thua ashtu, o burrë — tha gruaja, që kish vënë djalin në gjumë dhe tashti donte të flinte dhe vetë.

— S'thashë gjë — tha burri, që nuk kuptoi se po fliste me vete.

— U plake, burrë, ke filluar të flasësh me vete. Shenja e pleqërisë kjo — tha gruaja nëpër gjumë.

— Ja, mendoj për thesarin. Në këtë luftë unë isha njeriu më i pasur i të varfërve — tha.

— Ç'pasuri ishte ajo? Me kokë në trastë. Pasuria e vërtetë jona nesër fillon, kur të zësh punën ti. U çliruar nga të ligjtë, tashti na e marrin të keqen të gjithë — tha gruaja.

— Po nuk ma pranuan as nesër kutinë në këshillin e qytetit, nuk di ç'të bëj me të... — tha burri.

— Lëre në shtëpi — tha gruaja.

— Ku nuk kam qenë dje dhe sot. Nuk duan të marrin. «Nuk jemi të autorizuar» thanë. Dhe më e keqja është se shumë nga ata nuk dinë gjë fare për thesarin tim. Më duket sikur disa më marrin fare për të lojtur.

— Po ta dinin shumë veta, dje në luftë, atë kuti, nuk ruhej dot ajo deri sot — tha gruaja.

— Atë mendoj dhe unë. Po. Por në bankën e shtetit duhej ta pranonin.

— Duhej.

— Duhej. Por e di se ç'më thanë atje? Njerëzit që i kanë lëshuar këto firma nuk e kanë obliguar firmën tek ne. Firma e tyre nuk njihet. Janë persona jo zyrtarë. «More njerëz — u thashë unë — ç'persona zyrtarë? Ky ka qenë Markua, që firmos këtu. U vra në Pezë. Ky këtu? Po, ka qenë shoku Selim, që mbase lufton në veri tashti. Nuk e njihni. Gjë e madhe! Kur të kthehet do ta njihni. Trim ju them unë». «More zotni, pardon, more shok, — më thanë ata — ne jemi bankë dhe banka nuk i njeh këta emra. Ik e vërtetoji në qendër të punës e na i bjerë. Ashtu mund edhe t'i marrim në dorëzim. «Ke parë ti ç'tuafër? — Ik vërtetoji në qendër të punës! Sikur ata janë apo kanë qenë të gjithë minatorë! Nga ata, përveç meje, asnjë s'ka qenë minator. Ç'vërtetim të marr për ta në minierë?»

— Nuk t'i pranuan në bankë, të shkoje gjetkë — tha gruaja me vendosmëri, se tashti po e merrte inati me burrin që hem s'ishte i zoti të gjente zotër për thesarin, e hem po e linte pa gjumë.

— Vajta. Në komandën e brigadës vajta. Mirë më pritën. Por më thanë: — Ne jemi ushtarakë dhe me dokumenta të këtij karakteri nuk merremi. «Ç'karakter, more vëllezër? Ky ka qenë thesar për luftën, për juve e për neve. Merrni, ore, dokumentat. Njëqind e njëzet e tre vërtetime janë të shkretat. Nuk e rëndojnë, as vend ju zënë. Merrini se unë dua të filloj punën në minierë por me to nuk iki dot. Nesër do t'i kërkonin e nuk do t'i gjeni.» «Nuk na duhen neve, mor shok i dashur,

ka të tjerë që duhet të merren me këto punë» më thanë ata. «Ku të vete?» — u thashë unë. «Në këshillin nacional-çlirimtar» — më thanë ata.

— Vajte atje? — pyeti gruaja.

— Ç'e do, edhe atje nuk i deshën këto dokumenta. «S'janë për neve, shok i mirë» — më thanë. «Është jashtë kompetencave tona. Ne jemi këshillë lagjeje dhe jo qyteti. Atje shko ti».

— Ik pra atje nesër. Përderisa të kanë thënë ata, shko atje — tha gruaja.

— Një fjalë goje. Kush më siguron se do ta marrin në dorëzim dhe ata atje. Dhe inatin më të madh e kam me 29 dollarët, që kanë mbetur akoma pa u prishur. Si s'u gjend ndonjë punë dhe për ta në luftë! Ata nëpunësit e bankës sikur u tallën, më thanë që t'i ruaj deri sa të ndërrohen paratë. Sikur unë jam sarafi i rrugës mbretërore. Ç'e do që nuk po kthehet ndonjë nga ata të tre shokët, që na besuan këtë punën e parave të partisë.

— Po sikur ata të jenë vrrarë? Ti vetë the, që ata mund të jenë vrrarë — tha gruaja.

— Dhe sikur të jenë vrrarë ata, ka shokë të tjerë gjallë patjetër. Dikush duhet të vijë për këtë thesar, qoftë ai shoferi apo ai hamalli, ai jevgu apo ai katundari nga Sauku, qoftë dhe ajo gruaja me çitjane. Mojt, po dikush ka mbetur gjallë dhe unë do t'ja dorëzoj thesarin!

— Ç'rëndësi ka t'i kërkosh? Po t'i duhet dikujt kjo kuti, do të vijë vetë ta kërkojë — nguli këmbë gruaja përsëri në të sajën.

— Jo, pra, nuk është ashtu! — Burri foli me inat dhe u kujtua që ashtu mund të zgjonte fëmijët. — Jo, pra. Unë e ruajta gjatë luftës që thesari

t'i shërbente luftës sonë, ashtu siç i shërbeu. Tashti unë duhet t'i dorëzoj qoftë shkresat, qoftë 29 dollarët.

— Derisa nuk e kërkojnë, do të thotë që nuk i duhet njeriu...

— Nesër do ta shohim — tha ai.

— Nesër... — tha ajo. Dhe e zuri gjumi.

«Me siguri duhet të kujtohet njeri për këtë thesar» — mendoi burri. Dhe nuk e kuptonte dot që rolin e tij e kish luajtur thesari. Tashti fillonin ditët e tjera, ditët e reja të pasluftës, kur ato shkresa, vërtetime, fletëdorëzime e fletëdalje mund t'i vlenin vetëm arkivit të shtetit. Por arkivi nuk ishte krijuar akoma atë natë...

KOMISARI, I DELEGUARI DHE NE

Unë isha i vogël dhe jetim. Ai ishte për mua herë si baba, herë si vëlla i madh. Unë nuk kisha as baba as vëlla. Babanë ma kishin vrarë gjermanët kur hyri prilli dhe shkriu bora maleve.

Komisari im ishte dhe me vite më i madh se unë dhe me trup më i madh. Unë aso kohe, duke u ngritur në majë të gishtave, arrija të shihja nëpër vrimën e kyçit të derës. Ai, kur hynte në shtëpi, ulte kokën. Më vonë, kur u bëra dhe unë sa ai në moshë, lexova diku në kujtimet e shokëve të tij partizanë që komisari im ishte një metër e nëndëdhjetë centimetra i gjatë. Po të kish qenë luajtur në atë kohë basketbolli në Shqipëri, ai mbase do të ish kapiten i skuadrës kombëtare. Por atëhere nuk luhej basketboll. Atëhere bëhej luftë dhe ai ishte jo kapiten skuadre, por komisar batalioni.

Unë e di që bëj gabim kur e quaj atë komisari im. Ai nuk ishte komisar vetëm imi, ai ishte komisar, si për të gjithë partizanët, ashtu dhe për ne, gjithë fëmijët.

Më shumë se çdo gjë në jetë unë besoj se ai donte fëmijët. Sikur të mos kish qenë lufta, ai me

siguri do të ishte martuar dhe do të kish shumë fëmijë. Ka të ngjarë që fëmijët e tij të ishin shokët tanë sot. Por ishte luftë dhe ai ishte martuar me pushkën. Shumica e partizanëve dhe e partizaneve ishin njerëz të rinj, të pamartuar ata ishin martuar, të paktën, për aq kohë sa ishte lufta, me shoqen e tyre besnike, pushkën. Me pushkën ata luftonin, martoheshin, pushonin dhe flinin.

Ai u vra në luftë për fëmijët e botës dhe kurrë nuk pati rast ta provonte veten pa pushkë.

Komisari im nuk pati rast të kish fëmijët e tij. Ai nuk pati rast të martohej se u vra pa mbaruar lufta. Megjithatë, ai na kishte fëmijë ne, kalamajtë e fshatit tim. Përsëri unë gaboj. Unë them prapë komisar i im dhe kalamajtë e fshatit tim. Në fakt ai ishte komisar i të gjithëve dhe donte, me siguri kështu ishte, se s'mund të ishte ndryshe, gjithë kalamajtë e të varfërve në Shqipëri dhe në gjithë botën. Se ndryshe s'kish pse të dilte malit. Kushedi, mbase ndonjë çun tjetër, vërsnik me mua, në ato fshatra, ku luftonte komisar i (se ai s'luftonte vetëm në fshatin tonë), thoshte po kështu si unë: Komisar i im.

I ati kish qenë sharraxhi dhe tavanxhi. Dhe djemtë, komisar i me dy vëllezërit e tij, para lufte kishin punuar po atë zanat, sharraxhi dhe tavanxhi.

Ata prisnin lisat apo qiparizat dhe ashtu me sharrë dhe zdrukth i kthenin ata në dërrasa për të mbuluar dyshemetë dhe tavanet. Dhogat e qipariseve mbajnë erë të mirë dhe, kur janë të reja, të sapovëna në tavan apo në dysheme, të kënaqin me kundërmimin e tyre dhe të zë gjumi shpejt, dhe gjumi është i lehtë... i lehtë si nën hijen e ullinjve. Lisat nuk e kanë dhe atë erën e mirë.

por nuk kanë as rrëshirë si qiparizat dhe pishat, andaj priten dhe më shpejt. Për ta prerë lisin apo qiparizin nga rrënjët ata përdornin sëpatën dhe jo sharrën. Besoj se të gjithë qiparizat dhe lisat nuk vuanin shumë kur i priste komisari. Ai i priste shpejt, vetëm me disa të goditura të sëpatës dhe pema e lashtë binte përtokë.

Pastaj trupit të lisit apo të qiparizit i prisnin degët dhe rrëmbat me cekure dhe e kthenin në një trung të zakonshëm. Mbi një skelë të drunjtë fillonin ta sharrnin trungun për ta bërë dërrasa. Dy vëllezërit punonin me sharrën poshtë, kurse komisari — lart. Sharra ishte e madhe sa një sustë krevati dhe kur e tërhiqte komisari nga poshtë lart, gjithë atë sharrë, djersa i shkonte çurk, por trungu pritej feta-feta, si buka e grunjtë me thikë të mprehtë dhe bëhej dërrasa shpejt.

Mbase nga kjo punë e rëndë, që kish bërë para lufte, gjoksi i tij ish rritur e bërë na, dhe shpatullat e tij ishin aq të gjera, sa ne, kalamajtë, pyesnim sa çuna duheshin që ta përfshinin me duar gjoksin e shpatullat e tij. Ne e matnim gjoksin e tij me pash, sikur ishte ndonjë ulli plak.

Pra komisari kish qenë sharrëxhi dhe tavanxhi dhe kish prerë lisat e qiparizat për të shtruar e mbuluar shtëpitë e botës. Kish qenë i varfër shumë ai, andaj kish dalë partizan që të priste gjermanët e të shtronte ballistët. Ai i priti atë me mitra-loz. Ai ishte usta i mbaruar për të prerë gjermanët. Aq usta ish, sa gjermanët e ballistët jepnin njëmijë napolona flori për kokën e tij. Pleqtë e fshatit tregonin e për kokën e komisarit jepnin më shumë para se sa u jepte Sulltani për Rrapo Hekalin apo Italia për Kapedan Nasen. Por as gjermanëve, as

ballistëve nuk u ndriti. Komisarin e mbronte gjithë populli i varfër dhe, sikur të mos kish qenë ajo përlëshja e madhe, ai edhe sot do të kish qenë i gjallë midis nesh e mbase, kushedi, do ishte drejtor i sharrave të Fushë-Arrëzit apo i kombinatit të drurit në Elbasan.

* * *

Fshatin ne e kemi në këmbë të maleve dhe në buzë të detit. Po të keni qenë ndonjëherë në bregun e detit jonian, do ta keni parë edhe fshatin tim.

Fshati ka treqind shtëpi prej guri dhe të mbuluara me tjegulla. Në fakt sot nuk janë treqind shtëpi, por më pak, se gjatë luftës ato u dogjën dy herë. Një herë i zhuriti italiani, herën tjetër gjermani. Sikur bënin garë midis tyre, kush të digjte më shumë. Pas luftës shumë shtëpi mbetën pa u mëkëmbur më, se njerëzit e tyre ikën nëpër qytetet tona.

Unë nuk do të tregoja hiç gjë për fshatin, sikur ai të mos kishte lidhje me komisarin. Fshati ynë, megjithëse i bukur, ishte i varfër. Kur filloi lufta, burrat dolën malit e i pari ndër ta ishte komisari; sepse kishte shumicën e burrave partizanë fshati ynë, andaj dhe u dogj dy herë. Njësoj siç ka ndodhur dhe me shumë fshatra të tjerë.

Shtëpitë e fshatit janë pranë njëra-tjetrës, bile më afër se në Gjirokastër apo në Mangalemin e Beratit; ato qëndrojnë njëra pranë tjetrës, si njerëzit në shkallët e stadiumit. Po t'ja fusësh me pëllëmbë vëllait të vogël të shtëpisë tënde, në atë

tjetrën dëgjohet e goditura. Shpesh ndodh që një-rëzit, kur bisedojnë midis tyre në një shtëpi, dë-gjohen në shtëpinë tjetër, andaj sekrete të mëdha nuk mban dot. Shtëpitë janë bërë kaq afër dhe në rrëzë të malit, që të mundet të kursehet kështu, sadopak, fusha e vogël e fshatit.

Kështu që kuptohet se sa e lehtë është në fshatin tonë të merren vesh lajmet qoftë për mirë, qoftë për keq. . .

— O Çaçi! — thirri dikush dhe mua m'u duk se më thërrisnin nga thodhua e Spiret. Por ai që foli ishte lart, mbi ne, dhe jo poshtë në thodho. Më kish folur Fotua, shoku im më i ngushtë.

— Ç'do, Foto? — i thashë unë atij, pa e parë.

— Ka ardhur komisari. Në Jal do bëhet mbledhja e rinisë.

— Jo, more! Kur do bëhet?

— Nga dreka. Presim të vijnë dhe djelm nga fshatrat e tjerë.

Është mëngjez akoma. Fotua e dinte me siguri që do të bëhej mbledhja se ai e kishte babanë kryetar të këshillit nacionalçlirimtar të fshatit.

— E, ore, do vemi? — pyeti ai nga ana tjetër e avllisë.

— Vemi, pse të mos vemi — i thashë unë. — Por a do të na qasin. Mos është mbledhje për burrat? — pyeta unë me dyshim.

— Do na qasin. Përderisa mblidhet rinia, pse të mos na qasin. Sikur do të na kërkojnë letër-njoftimet. Mbledhje rinie do jetë dhe ne si të rinj jemi.

— Mirë, mirë — belbëzova unë, se nuk besoja që ai të më kish dëgjuar. Fotua fliste kaluar. Ai ishte më i madh se unë nja dy vjet dhe mund të

ngjante dhe me të rinj. Kurse unë isha trupimët; nga kjo ngjaja edhe më tepër me kalamaj të ve-gjël. Por e ndjeja që nuk duhej të na përzenin. Po të ish puna për mbledhje, ne ishim të gjithë njësoj. Për luftë ndryshonte puna. Atje e kishim provuar që nuk na pranonin.

— Merr bukën me vete — më tha Fotua. — Po të pres te sheshi i shkollës.

— Erdha — i thashë unë.

Kur i thashë nënës, që do shkoja në mbledhjen e Jalit, se kish ardhur komisari, ajo tha «mirë, o zemër, shko!» Dhe, megjithëse Jali është plazhi i fshatit tonë, ajo nuk pati frikë atë ditë se mos mbytesha. Unë dija not, por pak, se sapo e kisha mësuar. Por kur në Jal ishte komisari, nëna e kuptonte se s'kish si të mbytej njeri. Komisar i ishte notar, që nuk linte të mbytej njeri. Ajo më dha një copë bukë misri, nga ai misri i verdhë i Kallararit, një qepë të madhe dhe nja njëzet kokrra ullinj.

S'kishte vajtur akoma ora dymbëdhjetë e dre-kës. Fotua më priste te sheshi i shkollës. Ne në shkollë nuk shkonim, se ajo, qëkur kish filluar lufta, ishte mbyllur, por sheshi i vocërr i saj na shërbente për lodra.

— U vonove ca — më tha Fotua, që kish ardhur para meje. — Ata u nisën.

— T'i zëmë me vrap — propozova unë.

— Shkelja! — tha ai.

Dhe ne filluam të vraponim. Buka e lidhur në rrypin e pantallonave me një pecetë të bardhë mua më përplasej pas vitheve si kobure. Fotos nuk i përplasej, se ai bukën e kish futur në xhepe.

Kur ne i arritëm komisarin dhe shokët e rinisë, me ta pamë dhe ca djem të tjerë, që nuk i njihnim. Duhet të ishin të rinjtë e fshatrave pranë. Pamë se, me të rinjtë e fshatit, si ne, fëmijë të vegjël, ishin dhe nja dhjetë të tjerë. Për më tepër me ta ishte dhe Vitua e Goxhet. Vitua ishte vajzë, pak më e madhe se ne, por në Jal, vetëm pa shoqe, vajzat nuk shkonin. Ç'është e vërteta, me komisarin ishte një shoqe partizane, por ne atë nuk e fushim në numër për punën e Jalit, sepse Jali ishte i fshatit tonë dhe deri atë ditë asnjë vajzë fshati, e vetme, nuk kish vajtur atje. Sa për partizanen, ajo nuk ishte nga fshati. Pra kjo ishte diçka e papritur për ne. Vitua në Jal! Çudi! Si nuk kish kundërshtuar komisari? Ku ta dinim ne, që komisari vetë kishte thënë të vinte dhe ajo, Vitua, në Jal të dëgjonte për luftën e vajzave.

Për ne, për mua dhe Foton, tashti një gjë ishte e qartë, që komisari, ai i deleguari e ca më tepër ajo partizanja nuk do të na qortonin që kishim vajtur pas tyre, përderisa ata i kishin lënë shokët e tjerë tanët, bile dhe Viton.

Unë dhe Fotua u bashkuam me shokët. Ata u gëzuan për ne dhe ne u gëzuan për ata.

— Do kënaqemi me detin sot — tha Milua, njëri nga shokët që takuam.

— Do ngopemi me ujë të kripur — tha Fotua.

— Lum si ne që kemi komisarin me vete — thashë unë, sepse not unë dija më pak se ata.

Dhe vazhduam të ecnim nëpër fushën e vogël të fshatit tonë. Ecëm pak midis hijeve të ullinjve dhe të fiqve dhe fusha mbaroi. Para nesh doli Jali. Doli deti, që të verbonte sytë nga llamburitja e

rrezeve të diellit mbi stërkalet e ujit. Deti valëzonte sikur hidhte valle.

Unë nuk e kuptoja pse, atë korrik të vitit 1944, komisari me shokët e rinisë u mblodhën në Jal, kur fare mirë mund të mblidheshin në ndonjë shtëpi të fshatit pa qënë nevoja të vinim deri këtu. Aq më tepër kur komisari me shokët e tij partizanë, jo vetëm fshatin tonë, por gjithë krahinën e kishin çliruar nga gjermanët. Mua më thoshte mendja, që këtë gjë komisari e mendoi kështu se, po të bëhej mbledhja e rinisë në fshat, ndofta mund t'i binte në vesh ndonjërit nga afendikonjtë e fshatit puna e saj dhe do dilte sekreti sheshit, e pastaj e merrte vesh armiku. Këtë mendim unë guxova dhe ua shfaqta shokëve tek po zbathnim sandalet tona të rënda me gomë maqine, se ato vite lufte për gomë maqine nuk vuanim. Kushedi sa maqina vetëm në fshatin tonë ishin djegur. Fotua, si i zbathi sandalet dhe i lagu këmbët në ujin e kripur të detit, ishte i pari që e kundërshtoi mendimin tim.

— Jo — tha ai — nuk është këtu puna. Se përderisa na qasën dhe ne në mbledhje, kjo do të thotë që komisari nuk ka frikë se mos i dalin të fshehtat kësaj mbledhjeje.

— Kjo nuk do të thotë gjë — u përpoqa ta kundërshtoja unë, — këtu jemi fëmijë bonjakë dhe të varfër. Asnjë nga fëmijët e afendikonjve nuk është me ne. Se po të ish ndonjë nga ata, të jesh i sigurt, se komisari nuk do ta qaste. E po nga ne nuk del asnjë llaf. Aq sa flet ai delfini atje, aq flasim dhe ne. — Në atë çast një delfin sapo kishte bërë një kollotumba në det dhe mua m'u kujtua më parë emri i tij se i ndonjë peshku tjetër, sepse dihet që gjithë peshqit nuk flasin.

Fotua nuk foli. Argumentat e mia mbase ishin shumë bindëse për të.

Por prapë nuk pati njerëz nga shokët tanë që nuk u bindën. Sandri, një djalë qyteti, që kishte një dajën e tij në fshatin tonë dhe që tashti në kohën e luftës kish ardhur bashkë me gjithë nënën e motrën këtu, se babanë ja kishin internuar gjermanët në Gjermani, tha:

— Kushedi, ndoshta komisari ka vendosur të bëjë ndonjë piknik.

Ne të tjerët, djemtë e fshatit, nuk e kuptuam, se nuk e dinim fjalën piknik. Por asnjëri nga ne nuk e dha veten. Ne bëmë sikur e kuptuam dhe mendimin e Sandrit pse ishim mbledhur në Jal dhe jo në fshat.

Atëhere Milua tha:

— E a të vrarë. Ju vete mendja në gjëra të paqena. Unë e di pse e ka mbledhur këtu komisari rininë e fshatit. — Toni i tij ishte i tillë, që nuk të linte dyshim në atë që do të thosh.

— Pse? — pyetëm ne njëzëri, me kërshtëri të madhe, sikur Milon për këtë çështje ta kish sqaruar vetë komisari.

— Ja, ore, që të kridhemi në det e të zëmë ndonjë sinagridhe apo kocë. Do ta ketë marrë malli komisarin për t'u larë një herë në det dhe për sinagridhe, për mbretin e peshqve.

— Ik, ore, mbushu! — i tha Fotua. — Pse, ç'e bëre komisarin ti kontrabandist të detit, si yt atë?

Milua përdrodhi buzët, por nuk guxoi ta mbronte babanë e tij, që vërtet vriste peshq me dinamit ose bomba. Bota luftonte me gjermanin, kurse ai luftonte me peshqit; ishte i varfër i shkretiti... Ndërsa mua, megjithëqë nuk m'u duk mbu-

shamendëse ajo thënja e Milos, prapëseprapë, sikur po më shtynte dikush, mendoja se mund që dhe komisarin ta kishte marrë malli për peshk, se gjithë ato vite maleve nuk do ta kishte provuar ndonjëherë as sinagridhen dhe as kocën. Por që ama të bëhej një mbledhje e rinisë në breg të detit, vetëm për peshk, prapë më dukej e pabesueshme.

Djemtë e fshatit dhe ne, fëmijët, tashmë kishim zënë vend nëpër shkëmbinjtë e pllakat e Jalit, atje rrëzë Gurit të madh dhe prisnim se ç'do të thoshte komisar apo i deleguari.

Komisari kishte një zë të shtruar dhe pak të trashë. Kur filloi të fliste, dukej sikur dallga e detit përplasej mbi rërë, jo mbi shkëmbinj. Kur zëri i tij ngjante me dallgët e detit që përplaseshin mbi shkëmbinj, do të thoshte se komisar ishte me inat (si atë ditë kur u tha milicëve të dorëzoheshin); kurse tani që ai hapi mbledhjen nuk ishte i mërzhitur me njeri, përkundrazi, ai ishte i qeshur, aq i qeshur saqë sytë i ndrisnin. Ai hapi mbledhjen dhe pa nga ne, fëmijët. Ai na buzëqeshi dhe diçka i tha të deleguarit. Ne nuk e dëgjonim se ç'i tha, por i deleguari tundi kokën.

E mori fjalën i deleguari. Ai ishte më i shkurter se komisar dhe më i imët. Kishte një zë të hollë dhe të fortë. A u ngrit më këmbë. Ne rrinim ulur dhe e kishim qarkuar atë si gjysmërrethi. Kur u ngrit ai, shokët e rinisë përplasën duart. Ne kaq donim dhe i bëmë duart tona gjak. Ai nuk priti sa të mbaronim ne së përplasuri duart, por bëri me shenjë të pushonim. Djemtë e rinisë i ndërprejnë duartrokitjet dhe ne bëmë si ata. Dëgjohej vala e detit.

Ai filloi të fliste dhe unë fillova të vrojtoja

lëvizjet dhe veshjen e tij. Dukej që ishte nga qyteti. Ai akoma mbante pantallona civile. Kishte një palë pantallona gri me katrore të mëdha. Bluzën e kishte ushtarake, por këmishën e kish të bardhë, gjë që prapë tregonte se i deleguari tani vonë duhej të kish dalë në mal. Siç dukej, intendent i brigadës akoma nuk kish pasur këmishë ushtarake për të.

Ai dukej se ishte qytetar dhe jo fshatar, jo vetëm nga veshja, por edhe nga të folurit. Ai fliste bukur fort me shenja dhe lëvizje të duarve dhe të fytyrës, me të ngritur e me të ulur zërin dhe nuk përdorte fjalë karakteristike të fshatrave tona. Ai kishte veshur çorape leshi të gjata mbi pantallonat me katrore, por ato i kish lidhur aq keq, sa vetëm ndonjë qytetar i pamësuar me çorape leshi mund t'i lidhte ashtu. Gjelmijtë i vareshin dhe çorapet i kish veshur shtrembër.

Por për të folur ai kishte shok vetëm veten. Ai na sqaroi gjithë luftën; ai foli ku ishin gjermanët dhe ku ishin partizanët e Shqipërisë, ku ishin gjermanët dhe ku ishin rusët, bile ai na tregoi edhe ku ishin partizanët e shumë vendeve të tjera. Ai tha që gjermanit i kish ardhur fundi dhe ndaj rinia do të bënte një kongres të saj në Helmës. Se ku binte Helmësi ne nuk e morëm vesh, por ky emër na bëri përshtypje.

Djemtë e rinisë së fshatit duhej të zgjidhnin delegatin e tyre, me një fjalë, më të mirin e tyre, që të thosh hallet dhe bëmet e tyre në atë kuvend.

Ata zgjodhën delegatin për në Helmës. Ne përplasëm prapë duart (gjatë kohës që foli i deleguari, ne i përplasëm disa herë duart se fliste bukur.) dhe u bëmë gati të zhvishnim rrobat e të laheshim;

të kridheshim një herë në det. Dhe, bash atëherë ne e morëm vesh pse komisari e bëri mbledhjen e rinisë në Jal. Ai, tek na pa se po bëheshim gati të zhvisheshim, tha:

— O djem, mos u lodhni shumë në det. Bëni banjë me karar, se mbasdite vonë, kur të hyjë dielli, do të ujisim nerënxat e Nonë Thinesë.

Po, atëhere ne e morëm vesh pse mbledhja u bë në Jal. As për detin, as për peshqit dhe as për piknik, por për të ujitur nerënxat e Nonë Thinesë, që s'kishte burrë në shtëpi, se djali i vetëm i saj, Petrua, ish vrarë dimrin që kish ikur në malin e Çipinit, tek luftonte për të çarë rrethimin e gjermanëve, kurse i shoqi i kish vdekur nga gripi spanjoll, para se të lindnim ne. E kishte gozhdë në zemër komisari vrasjen e Petros. Ai do të donte më mirë të ish vrarë vetë se sa u vra Petrua, aq shok të ngushtë e kish. Ashtu të vrarë ai e kish mbajtur nja gjashtë orë më krahë, vetëm e vetëm që të mos binte kufoma e shokut në duar të armiqve. Si kishin çarë rrethimin, e kish varrosur Petron në një bokërinë të Bolenës. Thoshin që, kur të mbaronte lufta, do ta varrosnin në fshatin tonë, se kështu donte e ëma, kjo Nonë Thineja që do të ndihmonim atë ditë.

Nonë Thineja vetëm për vetëm nuk i ujiste dot kurrë nerënxat dhe limonin. Një nerënxë e vetme do njëzet llata, gati dy fuçi me ujë; kurse uji ishte larg nga nerënxat e Nonës dhe njerëz të tjerë që ta ndihmonin nuk kishte. Në Jal jetonin tri a katër familje, por dhe ato ishin të zëna me luftën.

Ne u zhveshëm, pa harruar porosinë e komisarit. Tok me ne u zhvesh dhe ai në të mbathura

dhe ne nuk i mbajtëm dot «ahet» tona. Të gjithë do donim që, kur të ishim në moshë si ai, të kishim trupin e tij. Ai kish një trup tërë muskuj. Bile, dhe në bark ai kish muskuj pllaka-pllaka të vogla si ato të ndarat e bombave angleze.

Ne fëmijët të gjithë si mundëm e ku mundëm, u hodhëm në det, kurse komisari u hodh pingul nga maja e «Gurit të madh». Ne, kur binim në ujë, të shurdhohim veshët me rrapamën tonë. Shpesh barku na përplasej në ujë, kurse ai nuk u dëgjua fare. Ai u zhyt si delfin i madh, i madh shumë dhe ne filluam të numëronim se deri sa do ta mbante frymën, i zhytur nën ujë. Të tjerë përpiqeshin të kapnin me sy vendin ku do të dilte komisari mbi ujë. Unë numërova deri në tetëdhjetë e tetë. Mbase të tjerët kanë numëruar më shumë. Ne sahat nuk kishim që të masnim egzakt sekondat. Ai doli mbi ujë gati nja njëqind metra larg nga «Guri i madh». Mbase dhe më shumë, kush i maste dot.

Ne prisnim, ashtu brenda në ujë, se ç'do bënte i deleguari. Ne donim që ai të mos ishte notar aq i zoti, sa që në të folur.

I deleguari foli aq bukur sa na la me gojë hapur jo vetëm ne fëmijët, rininë, por edhe vetë komisarin e mahniti.

Gjatë gjithë kohës që foli i deleguari, komisari ynë e shikonte në sy dhe tundte kokën sikur i kish bërë magji njeri. Aq shumë e pëlqeu fjalën e të deleguarit komisari sa, para se të na thoshte se do të ndihmonim Nonë Thinenë për të ujitur nerënxat, ai tha:

— Djem, unë nuk kam se ç't'i shtoj më tepër fjalës së shokut të deleguar. Unë e falënderoj atë në emrin tonë, të të gjithëve.

Kështu tha ai, komisari ynë, ai që në çdo mbledhje fshati e partizanësh gjente fjalën më të bukur, më të mençur, fjalën, që pastaj i bënte një-rëzit të suleshin mbi gjermanin me tërbim e furi të tillë, sa që të dukej sikur nuk kish vdekje për ta. Por që të shprehej kështu komisari, «se s'kish ç't'i thoshte më tepër fjalës së të deleguarit», kjo do të thosh që i deleguari ishte më i zoti se ai në punë të gojës. Çudi!

Andaj ne prisnim me kërshtëri të madhe se ç'do të bënte i deleguari në det, nga do të hidhej, si do të kridhej dhe sa do ta mbante frymën i zhytur nën ujë. Pas komisarit nga «Guri i madh» u hodhën dhe djem të tjerë nga rinia e fshatit dhe mbase ndonjëri dhe më me hark se komisari, por ne nuk i fusnim ata në numër para tij dhe tashti na interesonte vetëm i deleguari... Dhe i deleguari u fut në det... Ai as u hodh nga Guri i madh dhe as bëri pato të shpejtë në det. Jo. Ai nuk dinte not fare dhe andaj eci në ujë majë gishtave, derisa uji i arriti gjoksin. Fërkoj shpatullat e tija të vogla me ujë dhe ashtu, tek ajo pjesë e detit të cekët, që u përkiste grave (atje po laheshin Vitua me gjithë fustan dhe ajo partizanja me pantallona veshur), ai mbeti i vetmi burrë. Ne të tjerët, të gjithë, ishim atje ku deti të mbulonte disa herë.

Komisarit sikur i erdhi turp që e la të deleguarin vetëm te deti i grave dhe me një krol të shpejtë iu afrua. Pastaj ata dolën të dy bashkë nga ujët; komisari me trupin e madh, me brekët e bardha e të gjata, deri në kyçe të këmbëve dhe leshrat e zeza, që i kishin rënë mbi sy, dhe ai, i deleguari, me atë trupin e vogël, me brekët e shkurtëra të zeza dhe me leshrat e verdha e të holla

si mëndafsh, që e tregonin gati moshatar me ne fëmijët.

Ne nuk u gëzuam aq sa mund të pritej për këtë dobësi noti të të deleguarit. Nuk kishe se si gëzoheshe kur ai nuk dinte not fare, as si gratë tona, e jo më si komisari. Me siguri ai do të ishte nga Tirana ose nga Korça, se atëhere thoshin që në ato anë nuk e dinin notin hiç, kurse komisari ishte rritur në breg të detit, ashtu siç rriteshim ne.

Neve në përgjithësi na erdhi keq për të deleguarin. Kurse mua më erdhi keq për komisarin. Trupin e kish vërtet gjithë muskuj, por në të bardhë si bora dhe vetëm qafën dhe një trekëndësh vend në gjoks (atje ku zbërthehet këmisha) e kish të nxirë. Trupin, me sa dukej, kishte kohë që nuk ja kishte parë dielli. I shkreti komisar kishte tre vjet që luftonte dhe me siguri kjo mund të ishte banja e tij e parë në det gjatë këtyre dy vjetëve. Kurse ne ishim nxirë më keq se harapët.

Ne bëmë edhe pak banjë, pastaj hëngrëm së toku bukën, duke ndarë me njëri-tjetrin kush ullinjë, kush djathin, kush qepët e kush thelpinjtë e hudhrave.

I deleguari ishte po aq i thjeshtë sa dhe komisar. Ai nuk bëri naze fare. Hëngri me ne edhe hudhurat.

I deleguari na falënderoi të gjithëve dhe u ngrit. Komisar. u ngrit dhe ne u ngritëm pas tij.

Po hynte dielli në det, dhe atëhere kur perëndon dielli është koha më e mirë për të ujitur agrumet, qofshin portokallet, nerënxat, limonët apo qitrot. Po të kishte ujë, ato mund të vaditeshin dhe në mëngjez herët, kur nuk ka dalë dielli mirë. Nejsë...

Në të ujiturit e nerënxave ne e dinim, pa diskutim, që i deleguari nuk hahej dot me komisarin, sepse vetëm për vetëm komisari mund të mbante në krahë një fuçi me ujë dhe të ujiste mbase gjithë nerënxat e Jalit. Kjo dihej, andaj dhe për ne fëmijët kjo lloj gare nuk paraqiste asnjë interes. E shumta që mund të mbante i deleguari ishin dyllata me ujë të mbartura varur në shkop, njërën në një krah dhe tjetrën në krahun tjetër.

Ne punuam ndonjë orë të mirë dhe, ç'është e vërteta, u lodhëm. Të gjithë u lodhëm. Por mua m'u duk se më shumë nga ne u lodh ai, i deleguari, se edhe u përpoq shumë në një punë sëcilës nuk ja dinte marifetin. Se edhe ujitja e nerënxave, si çdo punë, ka marifetin e saj.

Vërtet u lodhëm, por tek morëm gjithë ato falënderime, përgëzime e urime nga Nonë Thineja, neve na u duk sikur s'kishim punuar fare. Plaka e mirë, me ato që thosh, e ndjente veten borxhlleshë për gjithë jetën, kështu që neve na erdhi turp pse nuk ishim kujtuar më parë për të, por u desh të zbriste komisari nga mali të na kujtonte. Ç't'i bësh që ndodh dhe kështu. Mbas asaj dite rinia dhe ne, fëmijët, filluam të ndihmonim në çdo punë ato familje, që ishin të paburra e të pandihma.

Si mbaruam ujitjen e nerënxave, ujitëm edhe veten tonë. Pimë ujë të ftohtë dhe u ëmbëlsuam dhe me fiq të Kallamatës, me të cilat na qerasi Nonë Thineja dhe u nisëm për në fshat.

Për të shkuar nga Jali në fshat duhet t'i ngjiteshe një shpati mali, nja dyqind-treqind metra i lartë. Shpat i zhveshur, që ka vetëm një ksi-

lloratë. Zakonisht, tek ajo ksillorata bëhet pushimi i vetëm i rrugës nga Jali në fshat.

Ne u nisëm Komisari ecte i pari krahë tij ishte i deleguari. Komisari i bënte çapet të mëdha, por dhe i deleguari nuk mbetej pas. Ai ishte i lehtë dhe vërtet bënte dy çape kur komisari hidhte një, por ato i bënte shpejt e shpejt dhe nuk mbetej pas. Siç dukej, ai kishte ngjitur dhe shumë herë të tjera male pa çka që ishte qytetar.

Ata ecnin shpejt dhe ne venim pas tyre. Ishte vështirë t'i ndiqje hap pas hapi. Te ksillorata ata të dy u ndalën dhe po dridhnin nga një cigare duhan. Kutinë e duhanit e kish në gjunjë i deleguari dhe unë prisja të shihja se në ç'xhep do futej ajo, në atë të komisarit apo të deleguarit. Kutia, si bëri një xhiro të gjatë, dorë më dorë të shokëve të rinisë, që pinin duhan, më në fund u fut në xhepin e xhakaventos së të deleguarit. Kutia ishte prej alumini, nga ai alumini i aeroplanëve anglezë të rrëzuar. Me siguri kutinë e aluminit ndonjë partizan do t'ja kish dhuruar. Komisari kishte kutinë e tij, prej së cilës u hodhi pastaj shokëve të rinisë për të dredhur cigaren e dytë; cigaren e parë e drodhi me duhanin e të deleguarit. Ata pinin duhan.

— A s'ja marrim një kënge — tha komisari, kur dhe ne fëmijët kishim arritur të gjithë.

— T'ja marrim — thanë shumë nga rinia e nga fëmijët.

Dhe ja morëm asaj këngës së bukur labe të fillimit të atij viti.

*Seç erdhi behari, ra një zi për ne,
Lule, more trima, që ratë për atdhe.*

*Ç'u kish rritur nëna për një botë të re,
Lule, more trima, që ratë për atdhe.*

Ne ja morëm në fillim shtruar. Këua, që u zgjodh për Helmës, ja morrte, komisari ja kthente, kurse ne ja mbanim. Me atë zë, që kish i deleguari, të hollë, tenor, mund t'ja merrte dhe më mirë se Këua; por i deleguari nuk dinte të këndonte këngë labçe. Dhe ky fakt i ri, kjo dobësi e re e tij, kjo dobësi kënge, e uli atë përsëri para syve tona. Partizan apo i deleguar i partisë dhe të mos këndonte labçe? E pabesueshme! Mund të thuash, që ato pika që fitoi në të ngjitur të malit, i humbi tashti me këngën «Seç erdhi behari».

Kënga shkoi e mori zjarr e pastaj gjëmoi buqe, aqë sa kur vajtëm në fshat, njerëzit thoshin: — Ju këndoftë zemra, o djelm, se na kënaqët!

I deleguari mbante vesh e dëgjonte me kujdes; dukej se dhe ai përpiquej të mësonte këngën. Por kur nuk je as lab as himarjot, këto këngë nuk i këndon dot. Në mos qofshi të tillë, mos u lodhni kot.

Komisari ishte zemërbardhë dhe atij i erdhi ligsht, që i deleguari nuk këndonte dot këngë labe. Atij iu duk se kish bërë ndonjë faj të madh që e kish lënë atë pa marrë pjesë në këngë. Nga që i erdhi rëndë për të deleguarin, komisari na tha:

— Ja marrim ndonjë kënge tjetër, o shokë, ndonjë kënge partizane të bukur. Dhe djemtë e rinisë ja morën këngës:

*Fusha, ju fusha,
Fusha, ju të gjera fusha,*

Ja ku shkon e shkel ushtria e kuqe,

Ja kavaleria ku kalon.

O hej, o hej, o hej. . .

Këtë këngë e dinte mirë dhe i deleguari dhe e këndonte bukur. Kur vinte radha për atë «O hej, o hej, o hej» zëri i tij i fortë prej tenori i mbulonte të gjithë zërat dhe vetëm Kiçua mund të ngrinte zërin aq lart sa të hahej me të.

Komisari qeshte i lumtur, më keq se kur qeshin fëmijët. Ai ishte i gëzuar që dhe i deleguari shkëlqeu në këngë, pa çka që kjo nuk ishte këngë labe ose himarjote.

Kur arritëm në fshat, dielli ishte fshehur në det dhe ne nxituam për te shtëpitë tona me komisarin në mendje dhe dashurinë e tij në zemër. Dhe përsëri mua më buçiste në vesh:

«Seç erdhi behari, ra një zi për ne. . .»

Pas një muaji, në fund të gushtit, komisar i u vra dhe kjo këngë qysh atë ditë këndohet dhe për të.

MISIONI

Në një monopat, në një nga ato shtigjet e shumta të çobenjve, nëpër faqet e Maleve të Vetëtimave (disa qindra metra mbi rrugën automobilistike), atë ditë të shkurtër dimri, kishin marrë udhën tre burra. Dy prej tyre ishin veshur mirë. Troku i këpucëve të tyre alpine ndihej deri tutje, në qetësinë e maleve. Kapotat me jakat me gëzof, peliçe këpucët alpine dhe kapat ushtarake me strehë plastmase, në vështrimin e parë të bënin të mendoje se ndonjë patrullë gjermane kishte marrë guxim t'u ngjitej maleve. Po të kishe mundësi t'i dëgjoje tek bisedonin njëri me tjetrin, do të kuptoje që ata nuk flisnin shqip. Por unë sapo thashë që ata ishin tre dhe jo dy burra. Veshja e të tretit ndryshonte nga ajo e të dy burrave ushtarakë. Ai kishte një palë opinga, (nga ato që fshatarët e bregut të detit u thonë shandalla dhe që bëhen me gomë makinash), një palë poture të lehta dhe një gunë çobenjsh. Opingat nuk lëshonin asnjë tingull. Ato ishin memece. Po të mos e vije re që ai u udhëhiqte rrugën dy burrave me kapotë ushtarake, patjetër do të mendoje se ai ishte ndonjë çoban i arrestuar nga gjermanët. Veçse burri me gunën e çobanit, në dorë nuk mbante kërrabën, por një automatik gjerman dhe në kokë s'kish qylaf, por një kapë me yll të kuq.

Ishte partizan burri me gunë dhe ata dy të tjerët me kapota ishin dy oficerë anglezë. Partizani jo vetëm që ishte i veshur si çoban, por, dhe para se të dilte partizan, çoban kishte qenë me të vërtetë. Tani ai ishte shoqërues i dy oficerëve të huaj. Njëri ishte gazetar ushtarak, kurse tjetri i ndërlidhjes. Të dy kishin ardhur atë ditë të takoheshin me shtabin partizan të kësaj zone. Meçua, se kështu e quanin partizanin me gunë, ishte i ngarkuar të shoqëronte oficerët aleatë nga qafa e Shëngjergjit, ku i mori në dorëzim, e deri në Val të Bufit, në malin e Çikës. Anglezët nuk dinin asnjë fjalë shqipe, kurse Meçua nuk kish dëgjuar anglisht asnjëherë në jetë të tij, deri ditën kur i kishte marrë në dorëzim oficerët. Dhe përveç shqipes s'dinte asnjë gjuhë tjetër. Kurse anglezët, sidomos gazetari, dinin shumë gjuhë, veçse gjuhën e Meços nuk e njihnin.

Sidoqë nuk kish ndonjë mendim të veçantë për oficerët, Meçua përpiquej të kryente sa më mirë detyrën që i kishin ngarkuar shokët, domethënë të gjente shtigje sa më të sigurt, rrugën më të lehtë e më pak të lodhshme; se oficerët ishin të huaj e s'duhej të binin në duart e gjermanëve, dhe, më anë tjetër, ishin të penës dhe nuk ishin mësuar me malet tona. Diçka të tillë të përafërt i kish thënë komandanti i tij dhe ai e kish kuptuar mirë komandantin: që anglezët të arrinin shëndoshë e mirë në Valin e Bufit.

Ata kishin udhëtuar, nëpër rrugën e mushkave, nga qafa e Shëngjergjit në majën e Palickës, faqes së malit të Boçkës deri në majën e Qorres së Vogël dhe tashti po zbrisnin Palikonjës, në drejtim të manastirit të Stravillit. Kishin nja gjashtë a shtatë orë rrugë që ecnin. Po të kish qenë vetëm Meçua,

do ta kish bërë këtë rrugë për nja tri orë, do të ishte ngopur me ujë, do të ish drekuar në manastir dhe tashti, me siguri, do të kishte arritur në të përpjetën e Valit, e mbase, kushedi, mund të kishte hasur në rojet e para partizane.

Troku i këpucëve alpine i ngjante Meços me zilet e bagëtisë dhe herë-herë i dukej se kishte vënë përpara dhentë. I vinte të qeshte me veten, kur kujtonte se ata që kishte pranë ishin anglezë të Mbretërisë së Madhe e jo dhentë e shkreta që ja kishte ngrënë lufta. I vinte të qeshte, por nuk qeshte dot, se kishte frikë mos anglezët e merrnin për të dalë mendsh.

Oficeri gazetar ishte i gëzuar, se qysh në ngjiten e parë në malet shqiptare atë po e shoqëronte një njeri, që nuk kishte asgjë të përbashkët me një ushtarak, — kështu mendonte oficeri gazetar. Material i bukur për gazetën!

— Me siguri, ky përdor më mirë thikën se automatikun — i tha oficeri gazetar shokut të vet.

Sikur Meçua të kuptonte atë që tha anglezi, do të çuditej me zgjuarësinë e gazetarit të ushtrisë; me të vërtetë ai e kishte përdorur biçakun shumë, si për të grirë duhanin e për të therur bagëtinë, ashtu dhe për të çarë ujkun. Por ama dhe pushkën e kishte përdorur shumë, si në mal me ujkun, ashtu dhe në luftë me Italinë dhe Gjermaninë. Ishte partizan prej kohësh. Oficerët qenë burra rreth tridhjetë e pesë-dyzet vjeç; kaq dukeshin, pa të vërtetën nuk e di njeri. Kurse Meçua ishte djalë tamam; i kish mbushur të njëzetat.

Meçua nuk kuptonte pse oficerët duhej të kalonin nga manastiri i Stravillit. Manastiri ndodhej pranë xhadesë së maqinave, as gjysmë ore më kë-

mbë larg saj; kurse, po të mbanin faqes së malit e të linin nën vete manastirin, do të arrinin më shpejt në Val të Bunit. Por oficerët donin me doemos të kalonin nga manastiri; kjo kish qenë dëshira e tyre dhe kështu i kishin thënë shokët partizanë, që ja dorëzuan në Qafë të Shëngjergjit.

...Ata filluan të zbrisnin. Manastiri dukej mirë. Që atje tej dalloheshin fiqtë e Adhamit, qipariset, kambanorja dhe bardhësia e mureve të manastirit. Megjithëqë manastiri dukej mirë, njëri nga oficerët, ai koloneli i ndërlidhjes, që për Meçon ishte vetëm «inglizi i gjatë» (se nuk i njihte gradat e tyre), nxori hartën nga çanta e supit dhe buzëqeshi i kënaqur. «Nuk beson, rruffjani; siç duket, ka frikë se mos e shpie në ndonjë udhë të gabuar» — mendoj Meçua.

Oficerët u gëzuan që arritën në manastir, kurse Meçua u mërzit. Kish ardhur koha e drekës; ishte dimër, dita qe e shkurtër dhe për pak orë do të errej. «U pa kjo punë, këta — e kish fjalën për oficerët, — me këtë lodhje që tregojnë e këtë gëzim që s'e fshehin dot për manastirin, kanë të drejtë të thonë se do të flenë këtu sonte» — mendoj Meçua.

Dera e avllisë së manastirit ishte e mbyllur. I ra derës i pari ai koloneli i ndërlidhjes, «inglizi i gjatë». Ishte një e rënë e veçantë që përsëritej disa herë. Një e goditur, dy të goditura, tri të goditura, pushim i gjatë, dhe pastaj përsëri kështu: një, dy, tri, pushim i gjatë.

Derën e hapi kallogreja. Ajo në fillim kur pa anglezët u tremb. Edhe anglezët u stepën, kur panë kallogrenë. Ata prisnin që dikush tjetër t'u hapte derën. Kallogreja e kuptoi që kishte të bënte me të

huaj, por, kur pa pas tyre partizanin me gunë çobani dhe me yllin e kuq, e ndjeu që nuk i vinte ndonjë e keqe nga ata. Ajo i ftoi brenda.

Manastiri nuk ishte ndonjë kush e di se çfarë. Ai më tepër emrin e kishte manastir. Kallogjeri, që kishte qëndruar më shumë në këtë manastir ishte kallogjeri i fundit, ai që kërkonin oficerët anglezë. Kërkonin këtë kallogjer oficerët, ndaj dhe kishin dashur të kalonin nga manastiri, ndaj dhe derës koloneli i kishte rënë ashtu siç i ra. Në këtë avaz të panjohur për çobanin ata i jepnin shenjat e tyre kallogjerit. Por kallogjeri nuk ishte në manastir; bile, as kufoma e tij nuk ishte në manastir, sepse kish vdekur një muaj më parë. Kallogjerin e fundit, që kërkonin anglezët, një muaj më parë e kishte pushkatuar gjyqi partizan si spiun të gjermanëve... Njëzet vjet të shkuara, kallogjeri kish qenë ahëre djalë, kishte ardhur nga Korfuzi. Kishte thënë aso kohe që ishte taksu kallogjer, sepse e kishte tradhëtuar e shoqja, të cilën e kishte dashur shumë, ndaj, nga zemërimi e kishte vrrarë dhe, pas kësaj s'desh më të jetonte. Por njerëz të mirë e kishin këshilluar ta lante gjakun e gruas duke bërë të mira në këtë botë dhe u bë kallogjer. Kështu thoshte ai dhe kështu thoshin edhe ata që ja rritën namën manastirit më të vogël të atyre anëve. Kurse partizanët, që e pushkatuan, thanë që ai vërtet kish ardhur para njëzet vjetve nga Korfuzi, por atje nuk kishte vrrarë gruan (se grua s'kish pasur kurrë), por kishte veshur petkun, rrobën e zezë të igumenit, me urdhër të regjentit të spiunazhit gjerman në Korfuz dhe kishte ardhur në bregun shqiptar për të njohur vendin, që t'i shërbente më vonë Gjermanisë, kur Gjermania të bëhej e madhe. Siç duket,

atje në Korfuz, kallogjeri i ri e kish luajtur mirë kartën, se, në anën tjetër, edhe anglezët mendonin që kishin njeriun e tyre në manastirin e Stravillit.

Gjatë kohës që kallogjeri jetoi në manastir, kishte bërë rilevimin gjeografik të shkallës 1:25.000 të gjithë krahinës. Ai njihte mirë çdo shteg, çdo shpellë e çdo majë mali. Kur erdhën gjermanët, pa vështirësi i zbuluan disa nga bazat partizane. Kallogjeri e kishte bërë mirë punën e tij. Veç një gjë nuk kishte kuptuar mirë ky kallogjeri, igumen Theotaqis, që shqiptarët nuk para i pëlqejnë miqtë e hasmit se, thotë një fjalë, miku i armikut tim është armiku im, qoftë ky dhe njeri i zotit. Kurse kallogjeri e bëri manastirin bazë nga nisëshin gjermanët për të goditur partizanët. Partizanët e panë që diçka nuk shkonte mirë në manastir dhe, një ditë, një muaj më parë, ashtu befas, partizancë, sulmuan manastirin. Disa gjermanë u vranë, të tjerë u dorëzuan; kush mundi e mori vrapin drejt detit. Ata që u dorëzuan treguan se kush ishte kallogjeri: oficer i zbulimit gjerman, Otto Vagner. Partizanët nuk e dinin që ky ishte adashi i Vagnerit të madh, por morën vesh që Fotua, Nakua, Selfua, Abazi e ata partizanët e tjerë, që u vranë në pabesi nga gjermanët, ishin spiunuar nga kallogjeri i fundit. Bashkë me gjermanët e tjerë e vranë dhe kallogjerin. E vranë për gjakun e Fotos të Nakos, të Selfos, të Abazit dhe të partizanëve të tjerë. Gjermanët, mbas asaj dite, nuk e bënë më bazën e tyre në manastir dhe, në atë kohë, kur manastiri mbeti qyq midis maleve, erdhi kallogreja plakë.

Këtë histori të vdekjes së kallogjerit e dinte dhe Meçua, që shoqëronte anglezët, por Meçua nuk dinte anglisht që t'ua tregonte historinë, kurse

anglezët nuk dinin shqip që të merrnin vesh këtë histori. Le që, dhe po të mund t'ua shpjegonte këtë Meçua, kishte frikë se ata prapëseprapë nëpër manastir do të kërkonin të venin, sepse shokët i kishin thënë Meços që njëri, ai i shkurtëri, ishte gazetar, shkruante, e ata që shkruanin i kanë qejf antikarat. Mbase manastiri kishte antika që Meçua nuk i njihte.

Por oficerët pyetën plakën për kallogjerin e fundit. Gazetari e pyeti greqisht dhe plaka i tregoi atij historinë që dinte Meçua. Ata u mërzitën pa masë, sacë as për bukë nuk u shkoi më mendia.

...Kallogreja u dha ujë për të pirë. «Po na potis si delet» — mendoi Meçua. Ajo vajti t'u bënte nga një kafe allaturka. Meçua nxori nga trasta një gjysmë kulaçi të misërt, nja njëzet kokërra ullinj dhe një kokërr qepë. I hapi të gjitha në shesh, para oficerëve dhe, si u tha «Bujrum», nxori biçakun e preu kulaçin në katër pjesë, qepën po ashtu më katërsh, me po atë biçak me të cilin kishte rjepur cjeptë e kishte therur 'ujqërit. Ai e ndau kulaçin dhe qepën për oficerët, për kallogrenë dhe për vete.

Kallogreja ishte një grua plakë, që i kishin vdekur fëmijët dhe besonte perëndinë shumë. Kur mori vesh që manastiri mbeti pa njeri, atë ditë kur partizanët vranë kallogjerin e fundit, igumen Theotaqisin, i erdhi keq për manastirin dhe për zotin, la plakun në shtëpi dhe u taks për kallogre. Ajo ishte e varfër. Manastiri qe i varfër. Luftë ishte dhe Meçua qe i sigurt që plaka nuk do të kishte ç'tu nxirrte miqve, përveç vajit (se kandilet e llambadhat i digjte me vaj manastiri) dhe ndonjë karvele bukë. Dhe ashtu vërtet, pranë kulaçit të

misërt të Meços, kallogreja plakë vuri një karvele bukë gruri dhe në zjarr tiganin me vaj dhe pak djathë të njomë.

Oficerët anglezë nxorën nga çanta e tyre plikot e mëdha sa një dorë burri të çokollatave dhe kutitë me qumësht. «Inglizi i shkurtër», gazetari, mori pak bukë nga ajo e misërta dhe e provoi me ullinj. «Inglizi i gjatë» nuk e ngau fare kulaçin e misërt, por preu disa feta me thikën e tij të brezit nga karvela e grunjtë e kallogresë. Plaka nuk hëngri fare. Ajo rrinte tok me burrat sa për t'i shtyrë ata të hanin. Meçua hante i qetë bukën e misërt. Kurse anglezët, si mbaruan djathin e tiganisur, filluan të hanin qumështin dhe çokollatat. Meços i vinte mendja për një copë çokollatë. Një copë të vogël, sa dy gishtërinj fëmije. Po t'ja jepnin anglezët, do ta fuste në xhepin e potureve, që ta ruante për partizanin e vogël, Naqen, që ishte sëmurë në mal. Po ata nuk i dhanë.

Oficerët hanin të mërziur. Kujtonin igumenin që e gjetën të vrarë, dhe e ndjenin se ç'humbje kishin për detyrën e tyre. Megjithatë, si mbaruan atë drekë, të pasur për Meçon dhe të varfër për anglezët, këta filluan të shëtisnin nëpër dhomat e pakta të manastirit. Bashkë me ta filloi të gjezdiste nëpër manastir dhe Meçua. Ai shoqëronte oficerët, kjo ishte detyra e tij. Te varret oficerët, te varret dhe Meçua; në dhomën e miqve ata, atje dhe Meçua; te altari anglezët, atje dhe çobani. Ata shfletonin librat e shenjta, kurse Meçua që as në xhami s'kish qenë ndonjëherë, shihte se ç'kërkonin në ata libra oficerët. Por që kërkonin diçka në to, dukej she-shazi, se përndryshe ç'dreqin kishin që u duhej të hapnin faqe për faqe librat e shenjta gjithë pluhur

të manastirit, të cilat kishte të ngjarë që as vetë igumeni Theotaqis të mos i kishte hapur ndonjëherë. Por sikur anglezët ta dinin këtë mendim të Meços, mbase dhe do t'i thoshin shoku-shokut se këtu gabohej Meçua, se ato libra jo vetëm i kish hapur igumeni i fundit, por në to kishte shkënuar ca fjalë të shenjta, që vetëm këta oficerët e Anglisë i merrnin vesh (por, kushedi, ndofta dhe ata gjermanët). Gjuhë e ngatërruar shumë ajo e igumenit.

Kur Meçua po çuditej me oficerët, që po humbisnin kohën kot me këto libra të vjetra, kallogreja briti:

— Erdhën gjermanët!...

Ajo thirri shqip, se shqiptare ishte, pa çka që dinte dhe greqishten, dhe këtë britmë e kuptoi vetëm Meçua, kurse oficerët kujtuan se mos plaka po i mallëkonte që ngisnin librat e shenjta.

Të dukej se gjermanët kishin ardhur ashtu papritur dhe e rrethuan manastirin, të sigurt se atje do të kishte partizanë. Kështu dukej. Por kish mundësi që gjermanët, duke u nisur nga fakti që të nesërmen fillonte operacioni, deshën të siguronin prapavijën e ardhshme dhe rrethimi i manastirit të ishte vetëm një masë sigurie nga ana e tyre. Mundet që ata të mos dinin se atje ishte Meçua dhe oficerët anglezë. Po mund edhe ta dinin.

Meçua automatikun e kish varur në sup dhe atje në altar ai i uli atij grykën dhe me vrap iu ngjiti kambanores. Në vrap e sipër u përplas me litarin e kambanës dhe papritmas u dëgjua zëri i saj i fuqishëm, si zë alarmi, në ato ditë të zakonshme, pa asnjë shenjta. Gjermanët filluan ta qëllonin menjëherë. Ai pa poshtë kambanores, pranë manastirit, gjermanët. Hodhi vështrimin rreth e

përqark dhe vuri re që manastiri po rrethohej nga gjermanët. Ata shkallmuan derën dhe ashtu qorrazi filluan të qëllonin. «Kush na tradhtoi?» mendoj Meçua. Ai s'kishte kohë të mendonte më gjatë. Atij i duhej të luftonte. I pëlqeu vendi që kishte gjetur, se nga pas kurrizit nuk e qëllonte dot njeri. Të afrohej njeri fare pranë kishës së vogël të manastirit e kishte shumë vështirë. Sheshin e vogël rreth kishës e kishte në pëllëmbë të dorës. Automatiku i tij të korrte mirë që andej. Ishte vetëm një togë gjermane dhe nga kjo Meçua e kuptoi që gjermanët e dinin që në manastir kishte pak pushkë. «Mos na panë, ku na panë?... Apo mos na kanë tradhëtuar?» Ai nuk e gjente dot, por qëllonte sa herë e shihte që gjermanët përpiqeshin t'i afroreshin kishës.

Kallogreja bënte kryq përballë Krishtit të mbërthyer. Anglezët e kuptuan që qenë të rrethuar, se e ndjenin nga i vinin plumbat kambanores. Lart çobani luftonte, po për ta kjo ishte një luftë e kotë. Kur je i rrethuar, nuk ke pse lufton kot. Ata të qetë prisnin fundin e kësaj mikrolufte. Se e dinin mirë që shoqëruesi i tyre, i vetëm, s'kish ç't'u bënte gjermanëve. Kurse, të luftonin dhe të rrezikoheshin ata vetë, s'kishte kuptim fare për ta. «Do ishte gjëja më idiote të vdisje në Shqipëri» mendonin ata. «Në fund të fundit ndaj është lufta që të ketë robër e jo vetëm të vrarë me nder në sheshin e betejës».

«Kush të na ketë tradhëtuar?» Ky mendim e brente Muçon përbrenda dhe vazhdonte të qëllonte. Atij po i pëlçiste **buza nga inati. Ai thërriste:**

— O mëmo, thuaju atyre rrënjëdalëve të qepen rrëzës së ledhit e të çajnë rrethimin. Unë do t'i mbroj e s'do t'i lë gjermanët të qëllonjë. Thuaju,

o mëmo, t'i ngjiten malit, se më turpëruan para shokëve, të ligjtë. O mëmo...

Dhe britma e tij çante qiellin, kambanoren dhe kishën. Dhe plaka u tha atyre, anglezëve, fjalët e partizanit. Ata i thanë plakës që t'i thoshte partizanit të dorëzohej, se duke qenë një i vetëm, nuk kish më kuptim të luftonte. Nga ana e tyre do t'u thoshin gjermanëve t'i falnin jetën e ta konsideronin rob luftë si ata. Mjaft luftoi.

— Nuk më duhet ajo jetë thuaju dreqërve. Jeta e falur nga hasmi nuk duhet — thirri gjithë maraz Meçua dhe vazhdonte luftën

— Qenka budalla — tha gazetari anglisht.

— Qenka viç — tha koloneli anglisht.

— Qenke trim, o zemër. — tha kallogreja shqip.

Kurse Meçua ja thosh luftës majë kambanores.

... Kaloi gati një orë. Anglezët po nxeheshin me gjermanët që s'po mundnin dot partizanin. Meçua qëllonte. Kurse komandanti gjerman ja bëri benë për ata katër gjermanë që vrau.

«Si më qëlluan kështu, rrënjëdalët! Pse s'qëlluan një herë, të paktën, që të tregonin se i kanë koburet. Pa le, e mbajnë veten për oficerë! Turp i madh, ta hajë dreqi!» mendonte Meçua për anglezët.

Atij po i mbaroheshin fishekët. Herë-herë i binte kambanës, si për t'u thënë gjermanëve: jam gjallë, në jua mban, ejani pranë. I binte kambanës për ta dëgjuar shokët partizanë në mal. Dhe kambana i çante tampanin, ja shkulte veshët fare. Dhe harronte që shokët fare mirë mund të dëgjonin dhe gjëmimin e armëve, po të ishin pranë, më atë anë të malit. Por shokët ishin larg, matanë malit, s'dëgjonin dot, kurse zënë e kambanës dhe atë të armëve mali e shtynte drejt luginës së përroit dhe

lugina e shtynte në det, ku si zëri i kambanës dhe ai i armëve shuheshin.

... Dielli ishte në të perënduar. Deti po digjej flakë nga perëndimi.

«Si nuk u bënë burra, rrënjëdalët!» mendoj përsëri Meçua për anglezët.

«Shumë po e zgjasin gjermanët» mendonin anglezët.

...Qetësi... Dielli digjte detin, kambanoren, kryqin dhe majat e maleve. Meçua nuk kishte më vërtet asnjë plumb, por i kish mbetur një bombë. I shkoi mendja dhe te koburet e anglezëve. «Ç'drejtin do t'u duhen koburet kur të dorëzohen! «Zbriti më vrap shkallët dhe i gjeti anglezët tek pinin duhan. Ju errën sytë, këtë radhë s'pati nevojë për përkthimin e plakës. Me bombë në dorë i shtyu anglezët drejt derës; deshi t'i bënte burra. Ata, kur panë bombën në dorë të tij tek i shtynte, e morën për të çmendur. Ai i nxori jashtë derës, por ata u shtrinë shpejt dhe ai ashtu me bombë në dorë, tek deshi t'i çonte më tutje, ra. Nuk nxori asnjë fjalë; u ngrit një çast në gjunjë, ngriti dorën të hidhte bombën, por përsëri ra.

Gjermanët pritën gjatë; u dukej se kjo qetësi ishte ndonjë dredhi e partizanit; pastaj shtynë dhe një herë në drejtim të kishës së vogël të manastirit. Nuk qëlloi njeri kundër tyre. E kuptuan që partizani kishte mbaruar. Ata e gjetën me gjakun, që i kish rrjedhur si burim nga sisa. Kurse anglezët me duart e pastra përpjetë, dhe koburet në brez, dolën nga kisha. Gjermanët i kuptuan se kush ishin dhe u thanë të ulnin duart. Partizani po vdiste i qetë, se bëri atë çka mundi, vrau shumë prej tyre,

pa çka se jo të gjithë. Por me siguri shokët e tij do t'i vrisnin të gjithë.

Gjermanët nuk dinin kundër kujt të merrnin hakë. Robërit anglezë nuk vriteshin. Dhe si e panë që vetëm me kufomën e shqiptarit mund të merrej haka, ashtu të vdekur, e mbase gati të vdekur, ata e varën çobanin në kambanoren e kishës. Anglezët ulën kokët se nuk e shihnin dot. U dukej sikur dhe ashtu, i varur, ai tallej me ta.

Plaka mallëkoi me gjithë zemër manastirin dhe perëndinë që nuk bëri thagmën e të mbronte çobanin e maleve dhe iku brinjave të malit.

Po errej. Robërit anglezë, së bashku me gjermanët zbritën në drejtim të detit.

Mbetën vetëm pesë gjermanë të vrarë, që shokët e tyre i lanë pa varrosur, se kishin frikën e partizanëve, të cilët mund të vinin natën. Mbeti atje si karakoll i maleve dhe partizani.

Të nesërmen erdhën partizanët.

— Mirë paske luftuar, o Meçe, — tha komandanti, kur pa gjermanët e vrarë.

— U vonuam, o vëlla, — tha komisari. — Na fal. Por do ta marrim hakën.

Dhe haka u muar njëqind për një.

GRATË E FSHATIT

Në fshatin tonë kishin pllakosur gjermanët dhe mercenarët e Xhafer Devës. Ishte mesi i janarit të vitit 1944. Dimër si atë vit nuk mbahej mend.

Fshati ynë është buzë detit dhe vërtet që e rreh tramundana në kohë të ligë, por fort më të rrallë, një herë në njëzet vjet e mbase më shumë i qëllon një brezi njerëzish të shohë borë në bokërinat dhe shtëpitë e fshatit.

Këtu rriten portokallet, ullinjë dhe fiqtë, ata fiqtë e Kallamatës, që në daç për behar i ke, ashtu të freskët, tek i këput herët në mëngjez me vesën si pika loti, në daç i ke dhe për dimër çepella apo bukëfiqe të hojme, që në paç fat të kesh dhe arra apo bajame nuk ke ç'i do fare rehatllokumet e gegës.

Në fshatin tonë rriten portokallet, ullinjë dhe fiqtë. Veçse gruri nuk rritet tek ne, se s'ka fusha për arra, po vetëm bokërina dhe ledhe, me gurë për të mbajtur e ruajtur tokën e pakët, që rrëshqet e do zërë vend përrenjve. Por kur s'ka fusha, s'ka dhe vend për derrin, sado i butë qoftë, se dhe ai do misër të ngopet dhe llucë e baltë të zhytet dhe të lyhet.

Kështu është fshati ynë. Por atë vit as fiqtë u mblodhën dot në behar, se gjermanët zunë me vrap vendin e italianëve të mundur e nuk i lanë njerëzit të mblidhnin fiqtë. Atë dimër të paparë, kur fillon tregimi ynë, operacioni i egër i dimrit i gjermanëve mbërtheu fshatarët brenda katër mureve të shtëpisë dhe ullinjte (ashtu si fiqtë në behar) piqueshin e breshëronin përtokë e kalbeshin shpejt pa arritur t'i mblidhnim. Kurse për portokallet, nerënxat e mandarinat as bëhej fjalë atë dimër të poshtër; me to ëmbëlsoheshin e dëndeshin gjermanët dhe mercenarët e Xhafer Devës.

Unë isha i vogël, s'kisha mbushur as dhjetë vjeç dhe as fjalën operacion nuk e kuptoja dhe as mercenarët e Xhaferit nuk i merrja vesh tek kërkonin petulla me gjalpë. Ata donin petulla me gjalpë, kurse ne as miell të grunjte nuk kishim dhe as gjalpë nuk ja mbanim mend se si e kishte erën atë dimër. Bagëtia na kishin ngordhur me kohë. Ishte luftë. Sos i kërkonin me vaj, por i donin me gjalpë. Le që atë dimër me atë cërë vaj që kishim nuk i kungonim dot gjithë mercenarët e Xhaferit dhe ushtarët e gjermanit. Ky Xhaferi mua atëhere më dukej se do ishte kushëri i Hitlerit, mbase dhe vëllai i tij i vogël, se dhe emrat u mbaronin njësoj dhe të bëmet i kishin njësoj. Ne dhe atë pikë vaj që kishim e ruanim si ujët e bekuar të gjyshes, se me të mund të shtyje lakrat e egra, përkalidhet dhe ndonjë të diel, gjyshja ime e mirë, hallë Mara, mund të bënte bullamaç me një grusht miell misri që vetëm ajo e dinte se ku e fshihte. Kurse mercenarët donin petulla dhe gjermanët proshuta me mish derri. Ne proshutën e dëgjonim për herë të parë. Gjyshja u thoshte: «Ju jeni vetë derra», por

gjermanët nuk dinin shqip që ta merrnin vesh fjalën e saj. Natyrisht që kështu u thoshte gjyshja gjermanëve kur nuk kishin me vete ndonjë mercenar të Xhaferit.

Dimri ishte i egër shumë. Unë rrija të shumtën e kohës shtrirë në dërrasa, tok me mëmën time. Mëma ishte e re, por që kur doli babai partizan ajo u sëmur. Mbase!.. Kush e di të vërtetën! Unë e dija mirë se, po të mos ishte luftë dhe babai të ishte me ne, nëna ime domosdo do të shërohej më shpejt, se ai patjetër do çante malin, mor, po dhe detin do çante, vetëm që të gjente doktor ta shëronte. Por babai duhej të luftonte që të shpëronte gjithë Shqipëria, more, po gjithë bota nga kjo murtajë e zezë naziste. Ndaj babai gjendej maleve. Kushedi në Bogonicë, në Çipin. Unë kisha dashur gjithmonë të mësoja se ku ishte babai atë dimër, kur na pllakosën të ligjtë e gjithë botës dhe mëma ime nuk kishte këllqe të ngrihej, kur gjunjët nuk i punonin fare. Por babai nuk u kthye më në fshat. Ai mbeti maleve, si çoban i mirë që kish qenë; ai mbeti maleve, i vrarë nga gjermanët, jo atë dimër që s'do ta harrojmë kurrë, por në behar, kur kish dalë bari i ri dhe kur kishin filluar kopetë të ngjiteshin përpjetë maleve, që kundërmonin erë trëndeline dhe çaji. Mbase ndaj dhe u vra babai në behar që të rrinte gjithmonë me bagëtinë dhe trëndelinën...

Me siguri atë dimër, babai, atje në malet me borë, ashtu siç e kujtoja unë, ashtu më ka kujtuar dhe ai mua. Ashtu siç e kujtonte ime mëmë, ashtu e kujtonte dhe ai. Mëma thoshte: «I ziu ai, ç'heq atje!» Ajo as emrin nuk ja thosh babait, se ishte turp sa s'bëhej më, që të zinte në gojë emrin e atij

para meje e, ca më keq, përpara gjyshes, vjehrrës së saj.

Babai kishte emër të bukur: Nase i thoshin, njëlloj si atë trimin që i këndohej kënga. Për Nase Labin e kam fjalën, ndoshta nuk ju kujtohet, është ai që i tha marshallit të Italisë:

*Mua s'më lidhi Turqia
Jo do më lidhë Italia!*

Dhe, gjithmonë si atëhere kur akoma s'kisha mbushur dhjetë vjeç, edhe sot që jam burrë, emri Nase më duket se është emër për trima, për kapedanë e partizanë. Dhe atë dimër, tek rrija e ngroheshja në shtrojet e mëmës së sëmurë, unë mendoja që babait tim duhej t'i këndohej kështu:

*Mua s'më lidhi Italia
Jo të më lidhë Gjermania!*

Se italianin e kishin mundur partizanët, tashti ishte radha e gjermanit. Kurse, ngandonjëherë, kur vinin mercenarët e Xhafer Devës në shtëpinë tonë, më shkonte mendja dhe kështu:

*Mua s'më lidhi dot Hitleri
Jo do më lidhë Xhaferi!*

Dhe kështu ishte vërtet, babanë me shokët e tij, atje në male, nuk e lidhte dot as Hitleri dhe as Xhaferi, por ama gjermanët e Hitlerit dhe mercenarët na kishin zënë shtëpitë e ishin bërë si zotër të tyre, sikur kishin lerë ata në fshatin tonë dhe jo ne.

Gjermanët erdhën e na i muarën edhe ato dy shkorsa të leshta dhe tri korrele që i kish punuar mëma kur kish qenë me shëndet. Tashti as ergalinë nuk e kishim më. Mercenarët e Xhaferit na e dogjën për dru që të ngroheshin. Atyre nuk u mjaftonin as bataniet e Italisë, as shkorsat e gjyshes dhe as korrelet e mëmës sime të sëmurë. Uh, sa të babëzitur që ishin!

Fshati po hiqte të zitë e ullirit atë dimër. As gjyshja ime, që qe grua e vuajtur dhe e munduar shumë, nuk dinte si ta quante atë dimër. Herë-herë ajo thoshte që erdhi fundi i botës, kataklizmoi. Unë e dija që ky nuk ish as fundi as fillimi i botës, sepse në malet ishin partizanët, po çka që neve në shtëpitë tona na kishin pllakosur të ligjtë e gjithë botës.

Por kur ne hiqnim të zitë e ullirit që, në fund të fundit, ishim brenda në shtëpi dhe më të rrallë çoku e ngjyenim krocën e misrit me lakra të egra, po partizanët atje, në malet e Gurrës, ç'bënin? Si i bënin ballë këtij dimri? Bora atje në Gurrë, thoshte gjyshja, arrin deri dy bojë njeriu. Për të ngrënë partizanët nuk kishin, se as lakra e as bari nuk gjendej dot në atë shtresë të trashë bore, por dhe as ujk e derr i egër e as dru që të ngroheshin nuk gjendeshin. Majat e maleve tona në këtë anë të bregut janë të zhveshura fare. Thonë që dikur ka pasur pyje me pisha si në Llogora, por njerëzit i kanë djegur për të fituar kullota dhe tashti ato ishin si male të nëmura, pa asnjë dru.

— Orëzë të djëm — thosh gjyshja për partizanët. — Po karkallosin nga të ftohtit e do vdesin nga uria.

— Pse të vdesin nga uria? Ata kanë pushkë,

le të vrasin derra të egër e bisha të malit! — ndërhyja unë.

— Ç'derra të egër, o xhan. As ujk nuk ka tashti në male e jo derra. Janë fshehur të uruarat kafshë nëpër zgëqe e guca, që të mos i presë dimri si me çekure.

Unë nuk isha aq i vogël sa të mos e kuptoja pse nuk ngjiteshin gjermanët maleve të vrasin derra të egër po na kërkojnë neve derra të butë; unë nuk isha aq i vogël, andaj dhe e dija që gjermanët, edhe sikur derrat e egër të hidhnin valle maleve, atë dimër nuk ngjiteshin se kishin frikën e partizanëve, se malet ishin shtëpitë e partizanëve tashti, kurse shtëpitë tona ishin bërë të gjermanëve dhe të mercenarëve.

...Atë ditë, kur gjermanët dhe mercenarët kishin pllakosur fshatin tonë dhe kishin rrethuar gjithë fshatrat e tjera të bregut, që të mos u shkonte dot asnjë ndihmë partizanëve në mal, ato ditë kur ata e kishin vënë ndër mend të shuanin partizanët në malet e Gurrës me uri e me të ftohtë, jo vetëm gjyshja, mëma ime dhe unë mendonim për partizanët, por për ta mendonin të gjithë fshatarët, që kishin partizanë djemtë e vëllezërit, motrat dhe baballarët në male. Të gjithë mendonin se si të ndihmonin që të mos shuheshin nga uria e të mos i priste të ftohtit.

Në ato ditë të gjata dimri e shumë të hidhura, qoftë nga të ftohtit e ca më tepër nga armiqtë, gratë e fshatit, vajzat, motrat, nënat dhe gjyshet i ngjishnin gjilpërat e telta e bënin çorape e fanella të leshta për djemtë e malit.

Gjyshja ime tirte leshin me furkën e gjatë sa unë, kurse mëma bënte rarë çorapet e sojme prej

leshi të butë, që të mos u mbërdhinin këmbët e të mos i vriste opinga partizanët.

Gratë e fshatit tonë bënë atë dimër atë që asnjë nuk e kish menduar, atë për çka me siguri ai dimër nuk do harrohet kurrë në anët tona.

Atë ditë janari, çdo grua kish gatuar bukën e misrit në magje, kish nxjerrë ullinj të e fundit nga talëret e katoqit dhe kish mbaruar çorapet e fanellat e leshta. Ata partizanët e kompanisë së dytë të batalionit të parë atje në Gurrë, për t'i bërë ballë këtij dimri dhe këtij operacioni armik, kishin shumë nevojë për atë bukë, ata ullinj dhe çorapet e fanellat e leshta.

Në i shkon ndonjërit në mend që të pyesë pse nuk sulmonin ato ditë partizanët e malit tonë gjermanët e mercenarët, ashtu siç i sulmuan në malet e tjera, unë u them se partizanët e Gurrës nuk qenë më pak trima se shokët e tyre, por ama gjermanët e mercenarët ishin mbledhur në fshat, nja pesëqind veta, kurse partizanët atje në mal gjithë-gjithë ishin vetëm dyzet e tre burra dhe katër shoqe. Dhe të mos harrojmë se gjermanët ishin brenda në shtëpitë tona, që janë kulla e shkuar kullave, ku dhe me disa dhjetëra njerëz mbroheshin bukur fort. Pastaj edhe fishekët do duheshin me qerre për të nxjerrë gjermanët nga shtëpitë, kurse partizanët kishin vetëm nga dhjetë fishekë secili. Atëhere kur ishte kështu puna, pse nuk sulmonin gjermanët, apo jo? Nuk sulmonin se shkonin me shpresë se s'do ish nevoja të vritej asnjë gjerman, kur partizanët ose do vdisnin nga uria e nga të ftohtit, ose, kështu i gënjente mendja mercenarët e Xhaferit, ata mund të dorëzoheshin vetë si dashi te kasapi.

Gratë i kishin bërë gati të gjitha.

Në shtëpinë e Zahet, që ishte bërë me kohë si depo e partizanëve, qenë grumbulluar njëqind e tridhjetë e katër palë çorape dhe tetëdhjetë e një fanella të leshta, hem të buta e hem të sërta. Me këto çorape mund të mbathje gati një batalion e me fanella mund të vishje nja dy kompani të mira partizane. Malli ishte siguruar, por si t'ua dërgoje partizanëve këtë mall, asnjë nuk e dinte.

Një mbase dite tek ne, si për të takuar mëmën time të sëmurë, erdhën Takja e Mitrushet, që ishte mëmë e dy djemve partizanë, Lilua e Zahet, që kish tre vëllezër partizanë, Dhoksia e Thanet që kish dy motra e vëllanë partizan dhe një vajzë e re, që mbase donte të dilte vetë partizane.

Në shtëpinë tonë drutë kishin mbaruar dhe vaj nuk gjetën më as gjermanët e as mercenarët, andaj tek ne atë mbase dite nuk kish më nga ata. Ishin larguar nga ne e qenë ngulur në shtëpi të tjera. Nëna kujtonte se ata ishin trembur se mos u ngjitej veremi i saj, ndaj qenë larguar. Kurse gjyshja thoshte që as kolera nuk i zë ata e jo veremi, vetëm plumbi i partizanëve bën punë në ta.

Ato gratë erdhën tek ne e, si pyetën për shëndetin e mëmës, filluan pastaj të llafoseshin për punën e çorapeve dhe të fanellave, që duhej t'i merrnin partizanët.

— Është mall shumë. Një barrë e mirë mushke — tha e para Takja e Mitrushet.

— Sikur të nisnim ndonjë nga pleqtë e fortë të fshatit, gjoja si për në Kallarë. Ai ta ngarkojë kafshën me mallin e djemvet, t'ja kuçundrisnim me ullinj, që të mos dukeshin çorapet e fanellat e, po ta takonin të paudhët më të dalë të fshatit, t'u

thotë që vete te këmbejë ullinj të me miell të grunj të Kallaratis. Mbase gënjehen këta të ligjtë e Xhaferit, se për petulla këta shesin dhe mëmën e tyre — dha mendimin e saj Lilua e Zahet.

— Punë që s'bëhet ajo, o jetë! — tha gjyshja ime menjëherë. — Gjermanët, sa të marrin vesh që kafsha e ngarkuar me ullinj po ngjitet malit të partizanët, do ta vrasin në vend kafsharin, edhe malli nuk do t'u vejë djemvet në mal. «Pse, me ullinj do t'i ushqejnë partizanët?» do thonë gjermanët. Duhet menduar diçka tjetër, se kjo nuk vete fare — shtoi ajo.

— O hallë Mara, po sikur të nisësh ndonjë nga burrat, që kanë mbetur në fshat, ndonjë nga ata të territorialit, natën, pa e diktuar njeri? — pyeti Dhoksia e Thanet gjyshen.

— Mirë do ish, po të mos e diktonin, ama — ndërhyri në vend të gjyshes Takja e Mitrushet. — Po kush na siguron që do të mundë të ikë ai pa u rënë në sy e në vesh koshalleve të gjermanit? Mirë po iku, po në mos iktë dot, edhe njeriu vete dëm edhe mallin e merr dreqi e djemtë do na mbe-ten brinjave të malit si Shëndëlli.

— Jo, nuk e kam menduar kaq thellë — u shfajësua Dhoksia.

Mua po më vinte keq për gratë, për gjyshet dhe mëmat tona. Ato po e pleksnin dhe e shpleksnin bisedën për t'u shpurë gjënë partizanëve në mal, në gjithfarë mënyrash edhe kështu, edhe ashtu, e nuk po ja dilnin dot mbanë. Mua më dukej se këtë punë më mirë se kushdo mund ta zgjidhnin burrat, por ata nuk kishin grishur asnjë burrë. Dhe ca më shumë më vinte keq për to, se ma thosh mendja, që ato ishin bërë mendjemë-

dha, përderisa nuk i ftonin dhe as u thoshin burrave e pleqve për këtë punë. Nuk e dija unë, që burrat, ata pak burra që kishin mbetur në fshat, ua kishin besuar këtë shërbesë grave dhe vajzave, se për të çarë rethimin e gjermanëve dhe të mercenarëve të Xhaferit, më lehtë do ta kishin gratë.

Dhe gratë në shtëpinë tonë vazhdonin të shkëmbejnë mendime për çorapet dhe fanellat e partizanëve...

Deri tashti, ajo vajzë e re, që mbase donte të dilte partizane, nuk kish folur fare. Dhe atëhere kur u duk që atë mbase nuk do t'i gjëndeje filli kësaj pune, ajo hapi gojën me turp (se u skuq shumë, më keq se ata dy kongjij prushi që digjeshin në vatër) dhe tha:

— O mëmani, o motrani, po sikur të na i linit neve vajzërisë së fshatit t'ua shpiem mallin partizanëve në mal?

— Folë më shkoqur — tha Takja e Mitrushet.
— Ngaje llafin më drejt.

— Ja, neve vajzave na ka vajtur mendja kështu: T'u themi mercenarëve dhe gjermanëve që do të ngjitemi deri në Mblerës për dru. Se drutë na duhen dhe neve edhe atyre të ligjve, që na kanë zënë shtëpitë. Zjarri në vatër është i mirë për të gjithë. Dimri do vijë dhe më i egër, kurse dru s'kemi fare. Kështu nisemi për në Mblerës, po vrapin do ta mbajmë më tej, në majë të Çikës, në Gurrë. U shpiem partizanëve fanellat, çorapet, bukën e ullinjtë që do kemi me vete. Pastaj më të kthyer rrët e fët një vrap në Mblerës bëjmë shqopa e marishte dhe mbrëmanet më darkë kthehemi në fshat me barrën e druve ngarkuar. Veç për këtë duhen gra të forta, ndaj them të na e lini neve,

vajzërisë, të çajmë malin — tha vajza e re. Ndoshta kjo ishte ligjërrata më e gjatë në jetë të saj. U duk sikur ajo u lodh që foli aq shumë.

Gjyshja ime me shoqet e saj nuk po e kuptonin se si do ta çonin këto vajza mallin në majë të Çikës. Kurse malli ishte kryesori këtu. Ndaj dhe Lilua e Zahet e pyeti vajzën:

— Mirë, o xhane, ta zëmë se na lanë këta të paudhët të nisemi në mal për shqopa, se mirë e the, zjarri është i mirë për të gjithë. Por si kujton ti, se nuk do të na kontrollojnë trastat apo futat se mos u shpiem bukë apo veshmbathje partizaneve?

Problemi u shtrua tashti thjesht, pa asnjë mëdyshje. Dhe mua m'u duk se ajo vajza mbeti ligisht. Vallë si do përgjigjej? Dhe u habita kur dëgjova:

— Jo. Nuk kujtojmë se nuk do të na i kontrollojnë trastat e futat. Por ne mendojmë të bëhemi një tridhjetë-dyzet vajza, nga më të fortat e fshatit, që do ta ngjisim majën e Çikës jo për shtatë-tetë orë, por e shumta për pesë orë dhe më të zbritur do profitasim të bëjmë dhe shqopa e kucura për zjarr.

Ajo e ndjeu që përsëriti atë që kish thënë pak më parë dhe që kështu akoma nuk i kish dhënë përgjegje pyetjes së Lilos së Zahet. Ajo shtoi:

— Kurse çorapet dhe fanellat ne themi t'i veshim vetë. Të mbathim nga tri-katër palë çorape edhe të veshim nga dy-tri fanella në mish. Sado të zgjuar të jenë mercenarët dhe gjermanët, nuk besojmë se do t'u vejë mendja të na numërojnë se sa çorape kemi mbathur e sa fanella kemi veshur.

Gratë qeshën. Ndoshta i bëri për të qeshur ideja se si mund të ndodhte që gjermanët të nu-

mëronin sa çorape kanë më të vajtur në mal e sa kanë më të zbritur. Mua kështu m'u duk. Ato qeshën.

Unë u çudita me zgjuarësinë e kësaj vajzës. Gjyshja dhe Takja e Mitrushet buzëqeshën të lumtura dhe atëherë pashë që dhe gratë e tjera e miratuan këtë mendim të vajzave. Megjithatë Dhoksia tha:

— Po për bukën e partizanëve si do t'ja bëjmë? Karvelet me bukë nuk i vesh e as i mbath dot si fanellat e çorapet.

— Ne kemi menduar dhe për këtë — tha vajza. — Them i marrëm për udhë nga një gjysmë karvele bukë a gjysmë kulaçi dhe një çanak ullinj sa për vete. Për dhjetë orë rrugë në mal dhe tri-katër orë punë për të prerë drutë mbase dhe gjermanët do na i lenë kaq bukë. Po na i lanë, ne kemi gjykuar që gjithë bukën dhe ullinjtë t'ua japim partizanëve, kurse për vete atë ditë të rrimë pa ngrënë...

— Ne mund të dendemi me përvëlak mirë atë mëngjez që do nisemi — tha Dhoksia.

— Po — tha vajza dhe vazhdoi. — Do ta kemi vështirë shumë. Ndaj themi që duhen vajza e gratë reja e të forta, se do të duhet të bëjmë mbi dhjetë orë rrugë, të ngjitemi e të zbresim malet në mes të borës dhe të suferinës, të bëjmë drutë e të kthehemi me to ngarkuar në fshat...

— Dhe të gjitha këto me bark thatë — tha Dhoksia si për të plotësuar mendimin e vajzës.

Unë që e kisha ngjitur një herë malin për të gjetur babanë në Valët e Bufit, e dija sa e vështirë ishte ajo rrugë. Prandaj unë prisja ç'do të thoshin gjyshja me shoqet e saj.

— Mirë e keni menduar, bija, — tha gjyshja ime. — Por të shkoni vetëm ju vajzëria nuk e keni drejt. Nuk është hiç e udhës.

— Pse, hallë Mara? — Pyeti e çuditur vajza.

— Si pse! Ti vetë the që do mbathemi e do vishemi me çorapet dhe fanellat e djemve. Kjo do të thotë që sa më shumë gra e vajza të vemi në mal atë ditë, aq më pak mund t'i bjerë në sy gjermanit veshja jonë. E më anë tjetër, sa më shumë gra e vajza të jemi, aq më tepër shumohet buka e ullinjte për djemtë. Kështu de, bija. Ndaj është e mbara e punës të nisemi të gjitha, jo vetëm ju, por dhe ne gratë e plakat e forta të fshatit. Sot është e para herë që ngjitemi Çikës ne. Strallët e Çikës vërtet na i kanë ngrënë shollët, por ama dhe kockën na e kanë bërë më të fortë se stralli. Durojmë ne, o xhane, durojmë shumë ne, o zemër, — shtoi gjyshja për të forcuar një mendim që të gjitha e besonin dhe pa këtë sqarim.

Po atë mbrëmje Takja e Mitrushet dhe gjyshja ime, që kish nusen të sëmurë e i duhej zjarri, i thanë të madhit të mercenarëve të Xhaferit, se nesër do ish mirë të ngjiteshin në mal për dru, jo deri në majë, se atje nuk kish dru, por deri në Mblerëz. Kështu i thanë të madhit të mercenarëve.

Zjarri u duhej dhe armiqve, ndaj ata i lanë të niseshin të nesërmen dyzet e tetë gratë dhe vajzat më të forta të fshatit për të ngjitur malin për dru.

Ato kishin mbathur kush dy palë e kush tri palë çorape e kishin veshur nga dy fanella. Ato dukeshin atë mëngjez të shëndosha si asnjëherë. Trastat e tyre, kur i kontrolluan koshallet e gjermanit në të dalë të fshatit, kishin vetëm një

gjysmë kulaçi me miell misri e nga një çanak me ullinj dhe në brez kishin lidhur tërkuzën dhe cekuren e druve. Dhe koshallet i lanë të shkonin se nuk kuptuan gjë.

Ato u nisën që me natë. Bënte të ftohtë i madh. . . Unë dëgjova gjyshen kur iku, sepse në të errët kërkonte nën jastëk rrypin e brezit, të cilin e shtrëngoi fort si ushtarët. Ishte e fortë gjyshja ime, ndaj dhe brezin e shtrëngon si ushtarët, ndaj dhe malin e ngjit si vajzë. . .

— Udhë e mbarë — i tha mëma. Atë nuk e morën në mal se ishte e dobësuar nga sëmundja.

— Ruaj veten — i tha gjyshja, — ki kujdes djalin. — Kjo porosi ishte për mua. Unë bëra sikur nuk e dëgjova, por qejfi m'u bë shumë.

Atë mëngjez bënte ftohtë, por ato, gratë e vajzat, që ngjitën malin, nuk mbërdhinin, se ishin veshur e mbathur mirë si asnjëherë dhe se në zemër kishin dashurinë për partizanët edhe në gojë këngën e tyre.

«Lule, djemtë e nënave»

Kur ato ja morën këngës në majë të Mjeglloshit dhe ne i dëgjuam në fshat, e kuptuam që e kishim kaluar rrezikun. Atë mëngjez shumica e fshatit u zgjua jo nga kokosharët, por nga kënga buqe e grave në majë të Mjeglloshit. Kurse i madhi i mercenarëve kujtoi se ato këndonin që të largonin të ftohtin. . . Dhe këngën e djemve të nënave ai nuk e dinte e ca më tepër gjermani, që nuk e merrte vesh hiç.

Ato ngjitën malet shkallë-shkallë, si ato shkallaret e stadiumeve dhe të anfiteatrove, ato kaptuan

Mjeglloshin me mjegull, ndaj i thonë Mjegllosh, pa zbardhur akoma. Kapën majën e Mblerëzës, pa u shuar akoma Ylli i mëngjezit dhe, ashtu me dritën e yllit dhe të hënës, që ish mbledhur e bërë sa një grusht, sa një mandarinë, (se, si dukej, dhe ajo kishte të ftohtë) ato panë hilqet e buta, marishtet e shkurtëra, dëllinjat gjëmbaçe, shqopën që digjet me bujë dhe mretet, që i duan aq shumë dhitë. Këto do ishin drurët dhe shkurret që do prisnin në të ardhur poshtë e që do t'i ngarkonin mbi vete.

Kur arritën në Gurrë, që ka ujin me emër në të gjitha Malet e Vetëtimave, atyre nuk iu desh ta shuanin etjen, se bora, që kishte qenë mbi gjunjë e u kish bërë qull këmbët e fundet e këmbëshëve, filloi atje të bëhej afër një boj njeriu. Askujt nuk i vajti mendja për ujë.

Në majën e Mesimerit, 1800 metra mbi det, i preu era, dhe ato, që të mos i rrëmbente murlani, u lidhën varg njëra pas tjetrës, siç bëjnë sot ata çiliminjtë e çerdheve dhe të kopshtëve kur shkojnë nëpër bulevardet.

Siç duket, atje në Mesimer, tek luftonin me erën e fortë, i panë dhe partizanët nga shpellat karstike të majës së Çikës, sepse kur ato ngjitnin majën e Çikës, drejt tyre po zbrisnin nja dhjetë partizanë të zbathur e të lodhur. Ka të ngjarë që ata t'i kenë marrë gratë e vajzat e fshatit për gjermanë, ndaj dërguan për tek ato pararojën, atë skuadër prej dhjetë vetash.

Gjyshja që më tregoi më vonë se si e ngjitën malin, nuk e dinte pse zbritën partizanët në drejtim të tyre. Ajo kujtoi se ata zbritën, që të mos lodheshin më shumë gratë. Sidoqoftë, puna është që partizanët e asaj kompanisë së parë të batalionit

të dytë atë ditë dimri u veshën dhe u ushqyen mirë.

Më vonë, kur edhe i gjithë batalioni u bashkua me kompaninë e parë dhe partizanët zbritën në fshat për të zburar gjermanët dhe mercenarët e Xhaferit, ne, çiliminjtë e fshatit dallonim, në gjilmijtë dhe brezat e çorapeve dhe në ojnat e fanellave të tyre, mjeshtërinë e nënave, të motrave dhe të gjysheve tona...

PËRTEJ DETIT...

Gjatë gjithë kohës që kisha qenë partizan, deri atë ditë, më vinte plasje që nuk kisha mësuar në ndonjë shkollë tjetër, në mos ushtarake, të paktën në gjimnaz, se ndryshe nuk do të isha intendent i kompanisë.

— E, a derëbardhë, për tregëtar u nise, tregëtar do të mbarosh — më thoshte shpesh komandanti, një lab kokëfortë, kur i kërkoja të luftoja dhe unë «ne shokët. Dhe nuk më shkonte kurrë në mend që shkolla tregëtare e Korfuzit do të më vlente një ditë, gjatë jetës sime partizane.

... Kur më caktuan në njisitin, që do të merrte pjesë në një aksion sekret, gjithë ata që e morën vesh, u çuditën. Kishte më trima e më të vjetër, më të regjur e më të zotë se unë. Bile dhe vetë, kur pashë se do të isha së bashku me «njeriun e lindur me këmishë,» me gjigandin mirditor dhe me zëvendëskomisarin, u turpërova e s'dija ç'të thosha. Po urdhëri ishte urdhër dhe, bashkë me tre shokët e tjerë, u paraqita në shtab të batalionit.

Komandanti, ai labi kokëfortë, që i kish fjalët të pakta, na tha: — Ju kemi besuar një detyrë të

rëndë. — Ai nuk tha të rëndësishme, por të rëndë. — Ka shumë mundësi që dikush prej jush të mos kthehet. Do të niseni nesër për në Jal të Vunoit, ku ju pret njeriu ynë, dhe të pasnesërmen, që menatë, do të çani ujërat për në ishullin e vogël grek te Strakënas. Në bazë të të dhënave që kemi, atje fshihet Jani Koçua. Është spiun i vjetër. Ka rrëfyer shumë nga shokët tani dhe është përpjekur të organizojë luftën kundër lëvizjes sonë në bregun e Himarës. Ky armik duhet asgjësuar. Do të ishte mirë të kapej i gjallë, por, në pamundësi, le të vritet atje ku është. Po jua përsëris dhe një herë: barra është e rëndë. Kush nuk e mban dot, mund të mos shkojë. Kaq kisha t'ju them. Të tjerat do t'i mësoni nga zëvendëskomisari. — Ai foli shkurt, pa i zbkuruar gjërat.

Shokët e njësitit kthyen sytë nga unë. Kurse unë drejtova vështrimin nga ata dhe dukej sikur u thosha: kini besim tek unë. Nuk do t'ju turpëroj.

Kështu pra, duhej të asgjësonim spiunin. Dhe ky spiun ishte Jani Koçua, profesori im i greqishtes, ai që shpesh më përgëzonte për sukseset e mia në shkollën e Korfuzit. Ai kishte qenë shqiptar si dhe unë, po më vonë e mohoi Shqipërinë. Andaj gëzohej për sukseset e mia në greqishte. I dukej se po fitonte një njeri tjetër, i cili një ditë do të harronte shqipen. Vetëm atëhere e kuptova përse isha caktuar në atë njisit. Nga të gjithë partizanët unë isha ai që ndoshta e njihnte më mirë profesorin.

...Dhe ja ku po vozitnim drejt ishullit.

Unë shihja ishullin dhe kujtimet e mia mplek-

seshin keqas, e vetëm zëri i zëvendëskomisarit më shkëputi nga ato.

— Pse mendon, Andre? — tha

— I vjen keq që do t'i vrasim profesorin — u përgjegj «njeriu i lindur me këmishë». Ai ishte partizan i vjetër i çetës së Bregut, ishte një nga ata njerëz, që luajnë me vdekjen, ashtu si luajnë fëmijët me bombë. I kishte shkuar vdekjes shpeshherë në takim, po, me sa dukej, ajo akoma i trembej. Ndaj dhe shokët e quanin: «njeriu i lindur me këmishë».

— Mos u tall, he burrë! — i tha mirditori. Atij i vinte keq për mua. Ishte gati dy metra i lartë. Për të parën herë lundronte në det e habitej me detin, ashtu si gocat e vogla të fshatit kur hutohen mbas kukllave, që hapin e mbyllin sytë. Tregonin se ishte përleshur me ariun, megjithëse mua s'më besohej. Ndoshta vetëm kjo forcë e tij e shtyu komandantin ta niste së bashku me ne.

— E pse, ç'të bëjmë thua ti, të mbajmë zi për Janin? — u përgjegj «njeriu i lindur me këmishë». Ai i kishte përgjegjet në majë të gjuhës.

— Jo, po le të hapim sytë. Megjithëse, me sa dimë, nuk ka gjermanë në ishull, s'është çudi që amiq të ketë. Le të nxjerrim pra armët. Sido që të ndodhë, të jemi gati për çdo gjë të papritur — tha si me vete zëvendëskomisari. Ai vinte i dobët. Vuante nga tuberkulozi. Po asnjëherë nuk e kishim parë t'i trembej sëmundjes ose të fliste për të. Mбай mend njëherë, doja t'i jepja, si intendent që isha, një pallto lëkure të një majori gjerman me lesh përbrenda, por ai nuk pranoi:

— Unë mirë e kam kapotën, jepja Marios, se

ai është siçilian e mërdhuh në malet tona. — Mario ishte italian e luftonte si mitralier në batalionin tonë. Ai mërdhinte shumë.

Ne i nxorëm armët nga fundi i varkës dhe i bëmë gati. Fjalët e zëvendëskomisarit nuk mund t'i quaje urdhëra, por ai as dhe një herë nuk urdhëronte, ashtu siç jemi mësuar t'i kuptojmë ne urdhërat; ai gjithmonë fliste shtruar, sikur kërkonte mendimin tonë. Megjithëse zëri i tij tregonte një farë pasigurie, fjalët ishin gjithmonë bindëse e me vend. Ai ishte nga ata udhëheqësit e rrallë, që askush nuk mund t'i mallëkojë për urdhërin e dhënë. Njeriu që u lodh më shumë nga vozitja, ishte ai, po dhe njeriu, që e shfaqti më pak këtë lodhje, ishte po ai. Vetëm kolla e tradhëtonte. Përpiquej ta mbante, po ajo i shpëtonte në mes të dhëmbëve e dilte e çjerrë dhe thërrëse. Ne bënim sikur nuk dëgjonim gjë. Dhe për këtë shikimi i tij bëhej aq i dhëmshur e mirënjohës, sa herë-herë të vinte një dëshirë e tillë, që këtë kollë ta kishe vetë.

I ishim afruar ishullit fare pranë; filluan të dalloheshin ullinjtë dhe qiparizet e tij. Njerëz nuk shihnim.

— Shtëpitë i kanë përmatanë — na sqaroi varkari, — ndaj nuk duken njerëzit. Këtëj vetëm ca mulqe kanë. — Ne e lidhëm varkën në një nga shkëmbinjtë e shumtë, të shembur gjatë bregut.

I vetmi njeri, që e njihte vendin, të paktën rrugën për në fshat, ishte varkari. Ne katër të tjerët mbanim armët në duar, kurse ai la lopatat në varkë dhe ashtu, me duar bosh, që tashti s'i zinin vend, po na udhëhiqte për në tokën e panjohur. Natyra përreth ishte e njëjtë me atë të

Himarës. Ne i ramë ishullit rreth e qark, anash. Nuk kaluam mes për mes tij, sepse nuk donim të ekspozoheshim pa ditur si ishte gjendja në ishull.

Ishte një vapë e tmerrshme. Shkëmbinjtë gëlqerorë, të badhë, paksa të përhimtë, lëshonin një avull të vakët, që të merrte frymën. Shokët shkolin përpara e unë shikoja hijet tona në gurët e ishullit. Ato ndodheshin pranë njëra-tjetrës edhe ngjanin me pesë plumbat e një krehri fishekësh. Ne do të pushonim në shtëpinë e një miku të varkarit. Përpara nesh filluan të dukeshin shtëpitë e fshatit. Kishim dy ditë që qemë larguar nga batalioni dhe, përveç pak buke që na ndau varkari, kur u takuam, nuk kishim vënë asgjë në gojë. Lodhje dhe uri.

Ecnim, kurse unë mendoja: «Po sikur të mos na pranojnë? Jo, duhet të na pranojnë! Ne s'jemi kusarë, ta hajë dreqi. Neve na duhet vetëm profesori im i greqishtes dhe do të ikim. Nuk ngasim njeri. Po mirë, po sikur këta njerëz këtu të jenë të uritur si korfiatët? Keq. Ahere s'do kemi asgjë të hamë. Jo, gjersa këtu nuk kanë ardhur gjermanët, duhet të ketë bukë! Nejse, le të na pranojnë, se në fund të fundit do bëjmë si të mundim për urinë; behar është, lakra ka. Vetëm të na pranojnë të çlodhemi pak dhe të gjejmë profesorin... Po, të gjejmë spiunin, se ndryshe...»

— Erdhëm, djema, — m'i ndërpreu mendimet varkari.

Ne u gjendëm përpara një shtëpie të vogël, të ndërtuar me gurë. Pranë saj luanin ca fëmijë, të cilët u larguan sa na panë. Qeni i shtëpisë lehu. Kur iu afrua varkari, ai pushoi. Dukej që e njihte.

Në skollopat dikush doli. Po nuk ishte i zoti

i shtëpisë. Ishte e shoqja. Ajo diç bisedoi me varkarin dhe ai na tha:

— I zoti i shtëpisë është në kafene, luan kartërat. Gjermanë në ishull nuk ka.

Ç'të bënim? Po të rrinim në shtëpi e të prisnim mikun e varkarit do të çlodheshim, po ashtu nuk dihej se sa kohë do të humbisnim. E, pra, koha vendoste gjithshka. Në qoftë se vonoheshim për të gjetur spiunin në këtë ishull, nuk ishte çudi që gjermanët në Korfuz të merrnin vesh që në ishull kishin ardhur partizanë shqiptarë. Spiunë, si profesori im, duhet të kishte dhe midis banorëve të ishullit.

— Të mos humbasim kohë — tha zëvendëskomisari. Miku nuk dihet se kur vjen, shkojmë në kafene.

Dhe ne vazhduam rrugën më tutje për në kafetë e ishullit. Kafeneja ishte në një ndërtesë të bukur dykatshe, me dritare të mëdha. Meqë jashtë ishte vapë e madhe, njerëzit ndodheshin të gjithë brenda.

Ne hymë në kafene. Dhe unë shtanga në vend. Para nesh, një nga tavolinat, ku luhej kumari, ishte mbushur me para. Sa shumë para... Asnjëherë nuk kisha parë aqë të holla, megjithë që kisha studjuar për tregëti. Habinë time e vuri re dhe varkari.

— Mos u çudit. Luajnë me dhrahmi, e jo me dollarë. — Ai nuk e dinte që dhe unë i njihja dhrahmitë.

Çudi! Në atë kafene njerëzit e kishin harruar luftën. Aqë e kishin harruar, sa që, megjithëse ne qemë njerëz të armatosur e të panjohur për ta, askush prej tyre nuk luajti vendit. Loja ishte e

zjarrtë. Dhe sot e kësaj dite unë nuk e kuptoj se si këtyre njerëzve nuk u bëmë asnjë përshtypje. Lufta për ta sikur kish marrë trajtën e bi-xhozit.

Vetëm si mbaroi dora që kishin, njëri nga lojtarët u ngrit dhe u rrok me varkarin. Siç dukej, ishte miku i varkarit. Nuk isha gabuar.

— Komisar, çfarë t'i them mikut? — pyeti varkari. Zakonisht kur i drejtohem zëvendëskomisarit, e quanim komisar; nuk na vinte për mbarë ndryshe.

— Le t'i thotë që jemi partizanë shqiptarë, që kemi rrethuar ishullin e që na duhet spiuni — tha «njeriu i lindur me këmishë», pa i dhënë zëvendëskomisarit kohë të flasë. Greku nuk e kuptonte shqipen.

Që ne ishim partizanë, kjo nuk ishte zor ta kuptojë; armë kishim në krah e yj të kuq në kapelë; po që kishim rrethuar ishullin, kjo ishte gënjeshtër, e megjithatë zëvendëskomisari i tha varkarit:

— Ato fjalë i thuaj!

Lajmi se ishulli që rrethuar nga partizanë shqiptarë e ne të pestë ishim vetëm pararoja u përhap në të gjitha tavolinat. Unë dëgjoja përshtypjet dhe llafet e grekëve dhe çuditesha se sa shpejt njerëzit mund t'u besojnë lajmeve, qofshin dhe të rreme. Më dukej sikur lajmin e gëlltitnin me mezet dhe gotat e verës.

— Le të mblidhen burrat e fshatit — tha miku i varkarit.

— Pse, ore, ke akoma burra të tjerë? — pyeti i habitur «njeriu i lindur me këmishë».

Siç dukej, fshati kishte akoma burra. Jo të

gjithë ata luanin bixhos në luftë. U detyruam të prananim këtë propozim. Neve na duhej ndihma e vendasve. Ishulli, megjithëse nuk ishte i madh, kishte të fshehtat e tij. Dhe për ne, që nuk e njihnim vendin, ishte pothuajse e pamundur të gjenim se ku ishte fshehur spiuni.

Tellalli thirri:

— Mbani vesh, o fshat, mbas një ore të mbli-dhen te kisha të gjithë burrat. Kanë ardhur an-dartët shqiptarë.

Oshëtimën e zërit të tellallit e dëgjuam dhe ne, besoj se e dëgjoji dhe profesori, atje ku ishte fshehur.

Kisha e fshatit ishte e vogël, po sheshi i saj ishte i madh.

Unë, miku i varkarit, zëvendëskomisari, dhe «njeriu i lindur me këmishë» ishim ulur pranë një varri. Mirditori dhe varkari shkuan të ruanin var-kën dhe të shikonin se mos ikte ndonjë fillukë vendase për të lajmëruar gjermanët e Korfuzit.

Ne rrinim e prisnim të mblidheshin burrat. Ata vinin dhe na shihnin me vërejtje të madhe. Natyrisht jo ata të kafenesë. Thua ishim njerëz të një planeti tjetër. Ata përshëndesnin dhe ne u përgjigjeshim. Nuk kuptoje se ç'u bënte më shumë përshtypje: rrobat tona apo yjet në kapelë. Sido-qoftë, jo armët tona. Një pjesë e mirë e tyre ki-shin vetë armë. Ata nuk hapnin me ne muhabet, po dhe ne nuk ja hynim kësaj pune.

— Akoma s'kanë ardhur të gjithë. Ja, më në fund, po vjen dhe urata, qenka me kryeplakun — na tha miku i varkarit.

Njerëzit u ngritën më këmbë, po shpejt u ulën. Urata dhe kryeplaku u drejtuan nga ne. U

njohëm. Gjë që me siguri nuk ishte e nevojshme. Tërë ishulli tashti e dinte se cilët ishim ne. Po asnjë njeri nuk e dinte pse kishim ardhur, me përjashtim të mikut të varkarit.

— Fillojmë? — pyeti zëvendëskomisari.

— Filloni — u përgjegj kryeplaku. Dhe në tonin e tij dukej që ishte mësuar të urdhëronte.

— Shokë! — tha zëvendëskomisari; pastaj priti sa u ndërpre në bisedat. — Ne jemi partizanë shqiptarë. Si të tillë ne luftojmë armikun, që sot është një, si për ne ashtu dhe për ju. Ne kemi ardhur këtu jo për të luftuar me ju, ne armët i mbajmë jo kundra jush dhe as ju nuk i mbani armët përkundra nesh. Kështu, pra, këtu në ndonjë nga shtëpitë ose shpellat e këtij ishulli, ka gjetur strehë dhe fshihet Jani Koçua. Këtë njeri për tradhëtitë dhe vrasjet që ka kryer në viset tona, ne duhet ta dënojmë simbas ligjeve dhe zako-neve tona. Si të kemi mbaruar këtë punë, sonte në darkë, do të largohemi nga ishulli juaj. Populli, që na dërgoi, e pret këtë njeri të gjallë ose të vdekur. Dhe ne do ta gjejmë atë, spiunin, veç në mos dalshim të gjallë nga ky vend.

Zëvendëskomisari foli me një theks të tillë, që shprehte një dëshirë dhe një vullnet të madh për t'ja arritur qëllimit. Unë prita që ta zinte kolla, po për çudinë time nuk u kollit; ai e di se si e mbajti. Asnjë nga burrat e ishullit nuk u përgjegj. Kryeplaku buzëqeshte lehtë; ai ishte i kënaqur nga kjo heshtje. Prifti na shikonte drejt në sy, sikur donte të dinte ç'efekt na bënte heshtja e thellë. Edhe ai ishte i kënaqur nga kjo heshtje. Kurse ne, shqiptarët, prisnim me ankth. A thua nuk do të na

e dorëzonin spiunin? A thua do të na duhej të vriteshim me këta njerëz?

Ne ishim gati të prisnim çdo gjë, po kjo heshtje ishte diçka e jashtëzakonshme. Dhe sot, kur i kujtoj ato minuta varri, më rrënqethet mishi. Heshtje. Ne pritnim dhe nuk dinim ç'do të ndodhte. Ata kishin pushkë dhe ne ishim vetëm tre veta. Në një përleshje të mundshme me ta, ne patjetër do të ishim të humbur. Por ne, pa profesorin tim, nuk iknim të gjallë andej. Ne prisnim. E vetmja dëshirë ishte të mbaronte kjo heshtje... Dhe më në fund akulli u thye.

Një peshkatar, ndoshta më plaku i fshatit, u ngrit dhe tha:

— Djemtë e mi. Derisa këta njerëz kanë lënë vatrat dhe njerëzit e tyre për të ardhur këtu, në këtë nisi, në këto kohëra të rrezikshme, patjetër një hall i madh i ka shtyrë. Dhe ky hall, me sa duket, është dëshira për të çuar në vend vendimin e popullit të tyre. Jam plak e nuk mbaj mend që prej atyre brigjeve, nga kanë ardhur këta njerëz, të na ketë ardhur e keqja. Andaj le të mos u bëjmë keq. Njeriu që këta kërkojnë, do jetë shumë i lig përderisa kanë marrë këtë rrugë të rrezikshme, në këto kohë të rrezikshme. Vrasësi nuk ka vend midis nesh. Mos i pëgërnin këto shtëpi dhe këtë tokë të bekuar. Le ta dorëzojmë atë që e mbajtëm për mik. Armiku i popullit të tij nuk mund të jetë mik i popullit tonë.

Kaq tha peshkatarin plak dhe heshti. Burrat e fshatit e aprovuan mendimin e tij. Dhe ata vendosën që së bashku me ne të gjenin spiunin. Pse e bënë kaq shpejt këtë? Ndoshta se plaku ishte shumë

i moçëm dhe i dëgjohej fjala apo ndoshta u erdhi keq për ne?

— Ka shumë gra pa burra — na tha miku i varkarit. — Shumë i kanë burrat në kurbet, shumë kanë mbetur të veja nga lufta. Në ndonjë nga këto gra do të jetë fshehur dhaskali. Të shkojmë e të kontrollojmë shtëpitë e tyre — shtoi ai.

Ne bashkë me burrat e fshatit u ndamë në tre grupe. Në grupin tim kishin qëlluar të rinjtë. Siç dukej, ata më kishin zili mua që isha partizan. Unë isha i ri si ata, por ata nuk ishin partizanë si unë. Ne kontrolloam tri shtëpi, po përveç grave pa burra nuk gjetëm njeri. Ne vazhdonim të kërkonim. Njerëzit, që më shoqëronin, nuk e humbnin durimin. Nga këmbëngulja e tyre për të gjetur spiunin unë kuptova se ç'do të thotë armik i përbashkët. Mbas një ore andej nga kërkonte grupi i «njeriut të lindur me këmishë» u dëgjua një bombë.

— Bomba tregon se e gjetën spiunin. Ky është sinjali, — u thashë unë grekëve të grupit tim.

Unë u nisa për atje ku shpërtheu bomba. Pas meje erdhën dhe grekërit, që ishin me mua.

— Dreq o punë, ku qenka fshehur rrufjani — tha njëri nga të rinjtë — te shtëpia e kryeplakut, kurse ne e kërkonim te gratë e fshatit.

— Ç'i duhen gratë atij — u përgjegj një tjetër, — kur ka vajzën e kryeplakut.

Mua më erdhi për të qeshur, po nuk ishte koha.

Ne e morëm me vete spiunin. Ai më njohu dhe u përpoq të më përshëndeste; seç belbëzoi, po unë ktheva kokën mënjanë. Më erdhi të ndotë prej tij. Rrugës, «njeriu i lindur me këmishë» i lidhi duart

me një tel gardhi. Profesori shtrëngoi nofullat. Ndoshta nga dhimbja, ndoshta nga urrejtja, mundet nga të dyja bashkë. Në breg të detit, pranë varkës, takuam mirditasin me varkarin. Zëvendëskomisari, «njeriu i lindur me këmishë» dhe varkari u larguan. Thanë se do të shkonin të falënderonin peshkatarin dhe fshatarët dhe, si të errejë, do të ktheheshin. Në breg mbetëm tre veta: unë, profesori dhe mirditori. Dielli ishte në të perënduar. Dhe dukej kaq i madh, sa kishe përshtypjen se ai, në ato kohë të vështira lufte, ishte rritur shumë.

Profesori, si pa që mbetëm vetëm dhe kuptoi nga dialekti se gjigandi ishte mirditor e, natyrisht, nuk e dinte greqishten, (ai na dëgjoi kur ne bisedonim, gjatë kohës që u takuam) m'u drejtua greqisht:

— Andre, mos ke ndër mend të më dorëzosh te armiqtë e mi? — Ai buzëqeshi, nuk ishte i sigurt për këtë. — Mos ke ndër mend të lejosh të më vrasin mua, profesorin tënd? Vallë i harrove mësimet e mia, dashurinë time për ty?

Unë heshta. Por ai jo, ai donte të jetonte.

— Andre, mendo se çfarë bën. Ç'të lidh ty me këta njerëz, me këtë malok të pagdhëndur? Ti je njeri me shkollë. Vendi yt nuk është pranë këtyre, që nuk kanë dëgjuar se ç'është Iliada, që s'njohin Sokratin, Ezopin...

— Mjaft, profesor. Unë i kam menduar këto gjëra me kohë; unë e di mirë se ku është vendi im.

— Çka thotë ky qen? — pyeti mirditori.

— Asgjë, kërkon mëshirë.

— Andre, mos u bëj i marrë. Merr pushkën dhe vrite këtë njeri të egër, që na ruan, e pastaj

hajde të nisemi. Deti është i madh. Shkojmë ku të duash, po jo te gjermanët, se puna e tyre mori fund. Nuk u ndala kot unë në këtë ishull. Çajmë për te anglezët, andej nga brigjet e Italisë. Ata priten dita ditës të zbarkojnë në Himarë, e atëhere atyre do t'u duhen njerëz si unë, si ti, që të njohin vendin e të kenë kulturë. Kupto, Andre, se çfarë të pret nesër. Ti do të jesh vetë kreu i vendit. Kurse tashti, me këta njerëz, ti jellum, që një shi i lehtë mund ta lajë. Banditë...

Mirditori dëgjonte. Atij i vinte keq që armiku e tij ishte aq i dobët e lypte mëshirë, andaj e shihte si ndonji qen të ngordhur. Ku ta dinte ai se ç'bluante mendja e profesorit.

Po unë e njihja mirë profesorin. Ai ishte nga ata njerëz, që mendojnë se atdheu është atje ku jetohet më mirë. Me të ishte e kotë të bisedoje për lirinë e vendit, për barazinë e njerëzve, bile dhe për vetë jetën. Ai asgjë nuk do të pranonte nga këto. Andaj unë vetëm i thashë:

— Jam roje dhe, si roje, nuk më lejohet të bisedoj me ju.

— O zot, — ai bëri provën e fundit, — thua s'ke qejf të shohësh Italinë, të jetosh si njeri? A thua s'do që të jesh tregëtar i madh? — ... Ai kishte parasysh shkollën time tregëtare.

— Jo, profesor, nuk dua të jem tradhëtar i madh — i thashë pak në mënyrë pompoze.

Mirditori nuk mori vesh asgjë nga biseda jonë. Dhe asnjë njeri nuk e di që mua m'u propozuan gjëra që asnjëherë nuk i kisha pasur ndër mend dhe s'do t'i kem ndonjëherë. Unë i ktheva krahët profesorit. Pak më vonë erdhën shokët.

— Keni të fala nga peshkatari plak — na thanë.

Dielli kish perënduar dhe ne u nisëm të kënaqur që ja kishim arritur qëllimit. Profesori shikonte me sy të zmadhuar njerëzit që e kishin arrestuar. Ai nuk besonte që ne ishim ata, që e arrestuam. Unë dhe varkari vozitnim. Profesori ishte shumë nevrrik. Pastaj u dëgjua një e qeshur prej të çmenduri. Spiuni me duart pas të lidhura, u bë gati të hidhej në ujë. «Njeriu i lindur me këmishë» kapi për supesh profesorin dhe s'e la të mbytej.

— Kaq e pati ky — tha ai.

— Mirë bëre që s'e le të mbytej, ndryshe do të na ndynte detin, — tha varkari. Ai e donte shumë detin.

Mirditori shikonte yjtë e mëdhenj, që vezullonin mbi kokët tona, dhe dukej që e kish marrë malli për dikë. Zëvendëskomisari, pa iu drejtuar njeriu, tha si me të qeshur:

— Ky ishte udhëtimi im i parë jashtë shtetit. Kurse nata dhe deti dëgjonin.

NJË UDHËTIM I ZAKONSHËM I GJEOLGJËVE

Ne ishim përgatitur shpirtërisht që drekën ta hanim në Pukë. Kishim diskutuar një mbasdite të tërë për itinerarin. Po asnjëherë gjatë atyre pesë muajve udhëtim s'na kishin ndodhur aq të papritura si asaj dite.

E papritura e parë filloi qysh në çastin kur po silleshim në restorantin e hotelit «Turizmi». Zakonisht ne uleshim të hanim në tavolinën pranë tablosë së Simon Rrotës. Nuk e di si quhej tabloja, po në të ishte piktura e një ure dhe një grua që mbushte ujë. Ka të ngjarë që ura të ishte ajo e Mesit. Mua më pëlqente tabloja dhe, gjatë shërbimeve që kam pasur në Shkodër, aq isha mësuar me të, sa njëherë i kërkova drejtorisë së hotelit që ta bleja. Kërkesa nuk m'u pranua. Atë mëngjez tabloja mungonte. Kamerieri na tha se e kish marrë komiteti i partisë. U gëzova, sepse në restorant ka shumë tymb. Kjo natyrisht ishte e papritura e parë; por sikur asaj dite të mos kishim pasur edhe të tjera të papritura me të vërtetë të rënda, ndoshta ajo ditë do të harrohej e bashkë me të dhe mungesa e tablosë.

Maqina erdhi në ora tetë dhe ne u nisëm.

Drekën kishim ndër mend ta hanim në Pukë, por punën tonë ne e kishim në Kçirë, një fshat në të hyrë të Pukës.

Ischim katër veta, katër inxhinierë gjeologë dhe shkonim për të kërkuar ammonitë. Ammonitet kanë qenë kafshë deti e kanë jetuar këtu e dyqind milion vjet përpara. Në Kçirë, qysh më 1908 një gjeolog i huaj kish zbuluar një «vorrezë» të madhe të tyre. Neve na duheshin ekzemplarë të tjerë për të vërtetuar moshën e shkëmbinjve, me të cilët merreshim. Kështu do të ndihmonim në sqarimin e fazave të magmatizmit mesozoik të Mirditës. Në këtë rast ne vepronim si arkeologët, që kërkojnë të zbulojnë gjurma të aktivitetit njerëzor për të thënë se ç'kohe i përket kultura e atyre njerëzve që i kanë lënë ato gjurmë; ne kërkonim mbeturina kafshësh — fosile, për të thënë se ç'moshë është «vorreza» e tyre dhe e shkëmbenjve ku ajo ndodhej.

Në të dalë të Shkodrës, në rrugën për në Kukës, takuam shumë njerëz, që pritnin maqinë. Ishte e hënë dhe arësimitarët ktheheshin në fshatrat e tyre, në shkollat e tyre. Në «Gazin» tonë kishte tre vende bosh. Ato tre vende i zunë dy vajza të reja dhe një burrë.

Burri, që sapo hipi, kishte diçka të përbashkët me portretin e Majakovskit. Unë i thashë atij për këtë ngjasim. M'u përgjegj se nuk e njihnte këtë njeri.

— Nuk asht shkodran — m'u përgjegj ai me një ton që nuk të ngjallte dyshim. Unë u habita se si ishte e mundur që një mësues të mos njihnte Majakovskin. Veçse ai burri më hoqi mendimin e keq, që më lindi, kur tha se:

— Jam shitës në Vaun e Dejës, lum miku.

— Asht akoma shpejt që të gjithë shitësit të njohin Majakovskin — shtoi njëra nga vajzat.
— Por do ta njohin. Të paktën nxanësit tanë, në u bafshin shitsa, e dinë kush ka qenë Majakovski.

Kështu ato zbuluan profesionin e tyre.

— Po ju a e njihni, moj shoqe? — pyeti shoferi ynë me shpoti.

— Ne natyrisht e njohim, s'jemi kot arësimitarë. — Ato nuk e kuptuan shakanë e Sotirit.

Vajzat ishin mësuese. I pyetëm, se në ç'fshat punonin.

— Në katundin Mnelë, që asht në kufi me rrethin e Pukës — na tha më e reja.

— Vështirë do ta keni sidomos në dimër — u qau hallin vajzave Jani, një nga shokët e mi.

— Ashtu asht — tha më e madhja nga ato.

— Sa herë në muaj veni në Shkodër? — pyeti Jani. Ishte e qartë se atij po i interesonte fati i tyre shumë më tepër se ne.

— Si të qëllojë, kur asht koha e mirë vijnë çdo javë — iu përgjegj më e vogla Janit.

Unë ua harrova emrat atyre mësueseve të reja. Por sa herë që jam larg familjes, i kujtoj, dhe atë nostalgjinë e mallin që më merr për nënën, sikur ma zbutin ato vajza të njoma, që kishin lënë familjet dhe Shkodrën e tyre për fëmijët e malësisë.

Ne vazhdonim bisedën me vajzat, të cilat me punën e vështirë dhe sjelljen e tyre na bënë për vete, aqë sa nuk shihnim se ç'ndodhte jashtë mu-shamasë së «Gazit» tonë. Shitësi, që i ngjante nga pamja Majakovskit, na tregoi «Gazin» tjetër, që

kaloi para nesh. «Gazit» tjetër po i derdhej benzina. Mbrapa tij mbetej një rrëke e hollë benzine, që e ndante rrugën më dysh.

— Duhet ta arrijmë, se ndryshe do t'i vejë dëm gjithë serbatori — tha shoferi ynë.

Dhe ja shkeli Gazit. Por dhe shoferi me serbator të shpuar dinte të ecte shpejt. Atij i dukej sikur ne donim t'a kalonim, andaj sedra prej shoferi nuk e linte që të na priste. Ne thërrisnim me sa kishim fuqi, por në këtë garë të çmendur ai nuk dëgjonte asgjë. Ne donim ta ndihmonim, kurse ai kujtonte se kishim ndër mend t'ja hidhnim. Maqina jonë mbante targën e Beratit (ishim gjeologë të naftës), ai atë të Tiranës. A mund t'ja kalonte Berati Tiranës? Dhe ne, si për shpërbllim, thëthinim me mushkëritë tona gjithë pluhurin që ngrinte ai. Sikur të mos kishte pakësuar shpejtësinë të shkolla e Jubanit, ne nuk do ta kapnim kurrë. Aty, të dy shoferët u takuan si miq të vjetër, megjithëqë nuk e njihnin njëri-tjetrin. Mbas atij bashkëbisedimi të ngrohtë maqina e Tiranës mbeti pas, siç dukej, për të rregulluar serbatorin. Kurse ne shpëtuam nga pluhuri. Gjithmonë më ka habitur mirëkuptimi dhe dashuria e shoferëve.

Te Vau i Dejës shitësi privat zbriti. Ai iku pa paguar. Shoferit tonë i mbeti gozhdë në zemër.

Ne deshëm të vazhdonim rrugën. Unë them deshëm të vazhdonim, sepse rrugën nuk e vazhduam dot. Nuk kishim bërë asnjë kilometër, kur Sotiri frenoi.

— Është shpuar goma e pasme. Zbritni ta ndërroj — urdhëroi ai. Kjo ishte e papritura e tretë mbas asaj të privatit.

— Ç'faj kam unë? Gomat ndaj i ka bërë fabrika, dhe do shpohen — tha Sotiri. — Është zor që të gjesh në gjithë Shqipërinë shofer më gjakftohtë se ai.

Sidoqoftë kjo e papritur, me tërë seriozitetin e saj, kaloi shpejt. Ne kishim gomë rezervë. Vazhduam rrugën përsëri. Maqina filloi të ngjiste të përpjetën e Qafës së Çelës. Aty te Qafa e Çelës mësueset zbritën. Ne u ndamë me to dhe një boshllëk na mbeti në zemër, sepse kishim diçka të përbashkët, që na lidhte: vështirësitë. Sotiri nuk pranoi t'u merrte lekë. Ato falënderuan dhe ikën. Ne shihnim me keqardhje vendet e lëna shkretë.

Po udhëtonim prej një ore, duke mos numëruar ndalesat. Asnjë prej nesh nuk kish qenë në Pukë, por na kishin thënë që me «Gaz» e bën për nja dy orë nga Shkodra. Ne e morëm me mend që na kish mbetur diçka më pak, se gjysma e rrugës. Koha ishte e mirë, sahati tregonte nëndë e gjysmë dhe ne gëzoheshim që kishte dhe nja gjashtë orë ditë, të cilat mjaftonin për të mbledhur amonite.

Por... gëzimi ynë ishte i parakohshëm. Si u larguan vajzat nga maqina, nuk shkuam dot shumë. Maqina, sikur t'i vinte keq që u nda nga to, u ndal. U ndal për të mos xhiruar më. Gëzimi ynë u zhduk si një filluckë sapuni. Goma rezervë që ndërruam te Vau i Dejës, bëri skopio.

Tashti dhe Sotiri ynë, shoferi më i mirë i Bregut, e humbi durimin dhe shau ashtu siç dinë të shajnë vetëm shoferët. Ai i vuri maqinës krikon dhe ne ngelëm mu në mes të rrugës. Shumë pak maqina kalonin. Ato u përpoqën të na ndih-

monin. Po kamardaret tona kishin të tilla «gaver-na», sa që duhej «pneumotoraks» për to. Duhej gomisti. Gomisti ndodhej në Fushë-Arrëza, kurse në Shkodër ka një repart të tërë. Më afër ishte Fushë-Arrëzi, por Sotiri vazhdonte të përpiquej ta rregullonte vetë. Pranë nesh kalonin Skodat shyta, të cilat ja ngacmonin më keq nervat.

— Eh, mor, ta hajë dreqi ta hajë. Ç'e do këtë plesht? — tha Sotiri duke treguar Gazin tonë. — Të kesh një bukuroshe të tillë! (e kish fjalën për Skodat). Të kënaqet shpirti. Do iki nga qyteti Stalin. Do shkoj në Laç; atje punohet. Vend i ri, maqina të reja. Do marr ndonjë me naftë e ahëre le të flasë im vëlla, që është inxhinier. Në Laç. Një Skodë shtetë dhe kapelën mbi sy — e mbaroi gjithë pasion ligjëratën ai.

Me gjithë hallet tona, mua më bëri përshtypje mendimi i tij. A thua kaq shpejt u plak Qyteti Stalin? A thua Sotiri ka të drejtë? Kuptohet se Laçi, që është akoma i ri, nesër do të jetë me siguri qytet më i mirë se Qyteti Stalin, por kjo s'do të thotë që ky i fundit u plak. Jo, ka diçka që i krijon Sotirit këtë përshtypje, është e reja që po i zë vendin kaq me shpejtësi së vjetrës, sa që ajo, e cila sot është e re shumë, shpejt kthehet në të vjetër. Ka ndryshuar nocioni i së resë. Po le ta lëmë këtë. Unë e di që Sotiri do të marrë maqinë me naftë. Për fuqinë e krahëve të tij një «Gaz» është me të vërtetë plesht.

Ne nuk e ngjitëm dot gomën, andaj vendosëm që shefi ynë, Hektori, i cili njihte kryegjeologun e Pukës, së bashku me Sotirin, të niseshin për në Pukë. Hektori me shoferin ja hipën një kamioni, kurse unë, Irakliu dhe Jani mbetëm të «ruanim»

maqinën. Si shëtitëm dhe një herë, duke kujtuar ammonitët e Kçirës, që nuk po i mblihdhim dot dhe, duke diskutuar për gëlqeroret e mesozoit të Italisë, — tema jonë ka të bëjë me ta, — vumë re që kaloi ora e drekës dhe jo vetëm uria, por më shumë etja na bënte të krahasonim veten me ata udhëtarët e shkretëtirave. Përreth nesh nuk kishte asnjë burim. Veçse në shkretëtirë askush nuk interesohet për fatin e udhëtarëve, sepse nuk ka kush interesohet, kurse këtu në rrugën për në Pukë, njerëzit pyesnin për ne e donin të na ndihmonin, qoftë edhe me fjalën e mirë. Po ujë nuk kishin me vete,

Ne pritnim të vinte Hektori me Sotirin, por po shkonte ora katër e mbasditës e ata jo vetëm nuk dukeshin, por as na dërguan ndonjë lajm që ta dinim të paktën ç'po bënin. Filluam të merrnim me mend gjithë të papriturat, që mund t'u kishin ndodhur, deri edhe... vdekjen. Se, në fund të fundit, siç ka thënë një shoku ynë, ne gjeologët rrugeve ose shtigjeve do të vdesim. Larg qoftë!

Si pritëm pothuaj shtatë orë dhe e pamë që s'kish më kuptim të prisnim, trioja jonë vendosi të largohej nga vendi fatal, Mbasi siguruam maqinën, duke i mbyllur të gjitha hyrjet e saj, bile dhe konofonë e motorit, me dry të markës «Tatius» ndalëm një nga Skodat shytë. Shoferi i kishte të tria vendet të lira. Ne hipëm. U njohëm me shoferin. Ishte shkodran, i ri dhe i muhabetit. Ai shkonte për në Kabash, nja katër orë larg Pukës,

— Paske rrugë të gjatë.

— Po, por të bukur. Më pëlqejnë bjeshkët dhe në këto vise ka njerëz të mirë,

Shoferi u interesua të dinte për punën tonë.

Kur mori vesh se kishim pritur shtatë orë, duke ruajtur maqinën, qeshi dhe tha:

— Por ç'dreqin keni dashtë me e ruejt ve-turën, mor burra? A thue keni pasë frikë se po jua vjedh njeri? Veç për këtë të mos kishit gajle fare. Këtu nuk vjedhin. Në fund të fundit, po të kishit pasë mend, mund t'ja lejshtit maqinën kopil te dera postës së policisë te Ura e Gomsiqes.

Kishte humor shoferi. Ne në fillim nuk e kuptuam se ç'do të thoshte ta linim maqinën kopil te dera, por, kur e morëm vesh, ashtu bëmë. Policisë së Gomsiqes iu shtua edhe çështja e Gazit tonë me targën Br-40-76. Sido që të ndodhte tashti, ne e hoqëm merakun dhe mund të vazhdonim udhëtimin të qetë, sepse maqinën e lamë në duar të sigurta.

Në orën pesë ne arritëm në Pukë. Përpara se të arrinim, shoferi na tregoi Kçirën. Ishte në të errur dhe ne ammonitët nuk i kërkonim dot atë ditë. Vorreza e tyre mbeti, hëpërhë, e paprekur.

Njohja e parë me Pukën filloi me shtëpinë e madhe të dimrit.

— Aty ka pasë jetue Migjeni — na tregoi shoferi. — Unë pata paturpësinë të mos i besoja.

— Nga e di ti? — e pyeta.

— E di, or shoku inxhinier, se e kam poetin tim.

— E quan poetin tënd, me qenë se ka qenë Shkodran?

— Jo, por si poet që asht, si lexues që jam, atë e due ma shumë.

Puka shtrihej para nesh; tani s'na mbetej gjë tjetër veç të kërkonim shoferin dhe Sotirin. Po

afrohej nata. Muzgu kish mbuluar qytetin, megjithatë shquheshin ndërtesat e reja që, me ata trupat e mëdhenj të tyre, dukeshin sikur mbronin nga era e fortë, që filloi të frynte, shtëpitë e vjetra të vogla. Era në Pukë është e ftohtë. Ne të tre ishim veshur me këmishë. Veshja jonë stononte me atë të pukjanëve, e sidomos me kapotën e policit, që na pa me vërejtje.

Nuk u lodhëm të kërkonim shokët. Puka është qytet i vogël dhe çdo njeri i ri që vjen, bie menjëherë në sy. Pyetëm një ushtar dhe ai na tha të shihnim në Bufe «Tërbuni». I gjetëm atje. Gomën nuk e kishin ngjitur. Kryegjeologun e kishin takuar, por ai s'kishte pasur kohë t'i ndihmontë; kishte mbledhje. Ata prisnin sa të mbaronte mbledhja.

Na kishte marrë një uri e tmerrshme; kisha përshtypjen se kishim mote që s'kishim vënë bukë në gojë. Ora ishte gjashtë e mbrëmjes dhe restoranti i Pukës nuk punonte.

Meqë gomat nuk i rregulluam dot, morëm një gomë rezervë te shokët e gjeologjisë, si mbaroi mbledhja; dhe si falënderuam policët e Gomsiqes, e shpëmë Gazin në Pukë. Ne vendosëm që të flinim në Pukë. Si do që të ndodhte me gomat, Kçira ishte fare pranë; të paktën e nesërmja të mos na ikte kot. Ishte mbrëmje dhe dielli, që sapo kishte perënduar diku, andej nga deti, lëshonte rrezet e fundit, tashmë të zbeta; të ngjante sikur me ato rreze të pafuqishme donte të mbahej mbas tokës sonë. Rreth e qark male. Malet e Pukës, të Gomsiqes, më tutje të Cukalit e larg, shumë larg, si pro-

përgjigjeshin. Të gjithë të ardhurit bënin të njëjtat pyetje dhe punëtorët u jepnin të njëjtat përgjegje.

Njerëzit mendonin se ku mund të kishte rënë bateria (një lloj tubi i trashë e i rëndë i shpimit). Pse ra bateria? Nuk mbajtën kunjat apo u godit anash me instrument nga pakujdesia e kryesondatorit? Në ç'thellësi ajo e blokonte pusin dhe a ishin shembur faqet e trungut të shpuar të pusit. Kur të gjithë këtu diskutonin, Sheme Mara nuk ishte; atëhere dëgjova kryesondatorin Haki që tha:

— Le të vijë Shemja. Ai mund t'i bëjë derman kësaj pune.

Le të vijë Shemja! — Dhe vetëm atëhere njerëzit e ndjenë, e kuptuan që midis tyre mungonte Shemja, mjeshtri i shërbimit të avarive. Më vonë mua m'u duk krejt i natyrshëm ai epiteli që i kishin ngjitur punëtorët duke e quajtur «kirurg Shemja», se edhe ai operon puset njësoj si doktor Cania njerëzit. Sapo kryesondatori tha: — Le të vijë Shemja, dikush pyeti:

— More, po ku është dreqi i Shemes?

Shokët e drejtorisë së ndërmarrjes thanë që Shemja ishte në avarinë e pusit D-34.

— Duhet të ish me lejë të zakonshme, por nuk e lamë. Nuk bëri as dy ditë pushim dhe ja ndërpreme — tha drejtori i ndërmarrjes, Lilo Caci. — Na plasi avaria në D-34 dhe e thirrëm. Atje është. Na, tashti, edhe këtu avari, ta marrë e mira ta marrë!

— Le të vijë Shemja — tha sekretari i partisë së rajonit, Paskal Sinani.

— Vanë prapë pushimet e Shemes. U bë his-

tori më vete kjo — tha Vangjel Ziu, mekaniku i pusit tonë.

— Pse vanë prapë pushimet e Shemes? — pyeta vetëm unë, se të tjerët e dinin historinë.

— Sepse deri më sot Shemja asnjëherë nuk i ka bërë pushimet tamam. Gjithmonë ja presim o në mes, o në fillim, se gjithnjë do kemi ndonjë avari në puset — tha Lilo Caci.

— Tashti që e morëm për në avarinë e D-34, ai kishte dhe gruan të sëmurë — tha shoferi i gazit të ndërmarrjes.

— More, po herë-herë e kemi ngritur dhe të sëmurë nga shtrati të varfërin — tha dikush që unë nuk e njihja.

— S'ke ç'bën, o drejtor, duhet të vijë Shemja — thanë prapë punëtorët. Shoferi i gazit të ndërmarrjes mori urdhërin për udhë dhe u nis për në D-34.

Ishte mbasdite. Filloi të frynte erë.

Gazi nxitonte luginës së vogël. Zhurma e tij nuk dëgjohej, se era bënte punën e saj dhe gazi dukej si grumbull i shpejtë që zbriste luginës.

Miqtë e ardhur në pus ngritën jakat e xhaketave dhe pastaj u hipën maqinave dhe ikën në shtëpitë e tyre. Punëtorët e turnit vazhduan të merreshin me motorin e pusit, që të kujton mokrën e mullirit; jepnin emerrnin duke e xhiruar atë sa mundnin për të zhblokuar pusin. Ata të turnit të natës vanë të flinin se i priste një natë e lodhshme. Unë mbeta në pus me punëtorët e turnit të mbasditës dhe bashkë me Seitin fillova të pastroja kanalet e argjilës.

Koka e injektimit të argjilës (solucioni i ar-

gjilës për pusin është njëlloj si gjaku për njeriun; pa solucion argjile nuk shpohet pusi) rridhte dhe në sheshin e sondës binte shi. Ne u zhytëm keq dhe u lodhëm me pastrimin e kanaleve. Kur mbaroi turni, Seiti ndezi drutë e skaldabanjës dhe ne, si hëngrëm darkë, në orën njëmbëdhjetë të natës u lamë me ujin e ngrohur nga Seiti. Flokët nga balta e solucionit të argjilës ishin bërë si të ngjitura me qirish.

Aty nga ora një e natës, nga dera, hyri një brez i gjerë drite sa një kapak dollapi. Drita më ra në sy dhe më zgjoi. Në dhomë po vinin njerëz të tjerë. Unë dëgjova zërin e përgjegjësit të pusit, të Skënderit.

— Ja tek e ke krevatin, Sheme, — tha ai me zë të lartë e duke treguar të vetmin krevat bosh që kishte dhoma jonë:

— Me avash, mor i uruar! Ç'borxh të kanë njerëzit t'i zgjosh në mes të natës? — tha tjetri, ai që quhej Sheme.

— Hë, se s'prish punë — tha Skënderi, — tanët janë, nuk prishemi.

— Tanët, tanët, por dhe gjumi duhet natën se janë lodhur njerëzit — tha Shemja.

— Po për ty, o Sheme, nuk është nata për gjumë? — nguli këmbë tjetri.

— Mos bërtit se zgjove dynjanë, të thonë — tha Shemja prapë dhe mbylli derën, si vuri re që mua më binte drita në sy.

Ashtu, duke dremitur, unë dëgjova bisedën e tyre. Përgjegjësi i pusit vazhdonte me zë të trashë, se me siguri sapo do ta kishin zgjuar dhe nuk i kish dalë gjumi akoma, kurse Shemen sa e kishin prurë me gaz nga D-34. Me siguri gjithë ditën atje

do të ishte marrë me avaritë, pastaj kishte bërë këtë udhëtim prej disa orësh në mes të natës dhe tashti do të ndërronte rrobat e zakonshme me kominoshet e zeza dhe do të nisej për në pus. Në pus e prisnin shokët e tij, punëtorët e turnit të natës, ata që thanë «Le të vijë Shemja».

Dera u hap prapë. Drita më verboi përsëri dhe unë hapa sytë. Ishte shoferi i gazit të ndërmarrjes që hyri.

— SHEME, e gjete krevatin? — bërtiti ai.

Shemja shikoi me merak të madh nga ana jonë që flinim; dhe kur më pa mua që isha zgjuar, më tha:

— Na e bëj hallall që të prishëm gjumin sonte, o shok. Mbylle derën, malukat! — i tha pastaj shoferit.

Ai filloi të ndërronte pantallonat.

— Dhe me avash, dëgjove? — i tha Shemja shoferit. — Mirë këtë e zgjuam, por në befshim kështu, do të zgjojmë edhe të tjerët.

— Hajde se s'prish punë — tha shoferi, duke mbyllur derën. — Inxhinieri bën punën në prodhim këtu, le të kalitet dhe pa gjumë (inxhinieri isha unë). Veç në do shkosh të punosh sonte në pus, krevatin ma lërë mua — tha ai.

Shemja nuk u përgjegj. Ishte e qartë që ai do të shkonte te pushi. Pusi heshtte dhe priste SHEME Marën.

— Natën e mirë, inxhinier. Më fal që të zgjuam — më tha Shemja.

Për të parën natë unë dëgjova këtu bulkthin që këndonte dhe qentë që lehnin (me siguri i lehnin Schemes që po shkonte në pus). Çdo natë tjetër në barakat e fjetores së pusit dëgjoheshin vetëm motorët e pusit.

— Është nata e tretë që fle në krevatin e tij — tha shoferi, si u mbulua mirë me batanie. Kur ka avari, unë e kam mirë, se në vend të fle në sedilje të maqinës, fle në krevatin e Shemes.

— Nata e tretë pa gjumë? — pyeta unë. — Por ku ka fjetur ai?

— Ku di unë. Mbase fle ditën a mbase nuk fle fare — tha shoferi qetë.

Kështu erdhi Sheme Mara në pus. Dhe kështu u njoha me të, se, megjithëse gjithë punëtorët e shpimit e njihnin, unë që nuk merrem me shpimet e naftës, nuk e njihja. Për një çast desha të shkoja me të në mes të natës në pus. Isha i lodhur shumë, prandaj me mendimin të ngrihesha a të mos ngrihesha, më zuri prapë gjumi.

Në mëngjez herët unë shkova shpejt te pusi. Shemja mbante frenat; ai i jepte peshë të madhe deri në njëqind linja — (mbi shtatëdhjetë tonelata), por pusi nuk zhblokohej. Ai kishte punuar gjithë natën bashkë me punëtorët e turnit, por s'kishin arritur gjë; ai kishte tri ditë e tri net pa gjumë, se edhe avaria e D-34 kishte qenë e rëndë, dhe megjithatë, kur më pa në këmbët e kullës së pusit, iu përgjegj përshëndetjes sime:

— Mirë mëngjezi, inxhinier. Erdhe të marrësh turnin? — dhe qeshi. — Duhet retifikuar trangu — shtoi, — është blokuar keq.

Kjo do të thosh të zgjerohej dhe ca trangu i pusit. Mbas dy orësh bërthama teknike e pusit, me inxhinier teknikun dhe punëtorët, e përkahën mendimin e Shemes dhe filluan menjëherë ratifikimin e trangu të pusit. Mbas ratifikimit do bëhej peshkimi në kokë i baterisë në fund të pusit.

Të nesërmen ishte e diel. Berati festonte ditën e çlirimit, 25-vjetorin. Thoshin se do të bëhej panair i madh. Unë iu qepa Shemes pas, se doja të mësoja prej tij sa më shumë për avaritë. Shemja shkoi të hante mëngjezin dhe unë pas tij në menxë.

— Nesër bëhet pazar i madh në Berat — na tha kuzhinieri. — Lum si ju që mund të shkoni. Unë i shkreti kam dy muaj pa bërë pushimet e të dielave. Ata burokratët e NSHFP-së nuk dërgojnë njeri të më zëvendësojë. Sikur s'kam familje fare.

Shemja qeshi. Unë u çudita pse qeshi. Me veten time mendoja: «a thua me të vërtetë nesër Shemja mund të shkojë në Berat për panair, kur pusi është në avari?»

— Pse qesh me të? Apo t'u bë qejfi që do të vesh nesër në Berat? — e pyeta.

— Si të mos qesh me të. Jo panair i Beratit të jetë, por panair i gjithë botës të jetë, kur ka avari pusi, unë nuk kam ku vete. Hiç s'kam ku vete. Për këtë punë jam unë, për punën e avarive. Të gjithë punëtorëve të tjerë të shpimit punë u zihet ajo kur punon sonda, kur shpon pusin. Të vetmit që i zihet punë, kur është pusi në avari, jam unë. Shpesh nga kjo më duket sikur unë i ndjell avaritë. Kurse Shyqo kuzhinieri më thotë do të bëhet panair në Berat. U bëthti (nuk i shpëton të folmes së Kozarës dhe sot e kësaj dite) në Berat panair dhe futboll, sa të jetë pusi në avari, unë këtu jam — dhe qeshi prapë pa të keq, ashtu siç qeshim ne me budallallëqet e çiliminjve tanë. Si dëgjova ato çka tha Shemja, m'u kujtua një diçka tjetër e shpimit.

Një shoku im, inxhinier shpimi, dikur në fjetoren e beqarëve (kur ishim beqarë), në qytetin Stalin, më pat thënë: «Vetëm një herë jam dehur në jetë dhe atëhere jam dehur në punë, në pus. Ishte 29 nëndori i vitit 1964. Unë punoja te pusi i Kryeviidhit. Kishim avari. Natën nga Tirana fekste qielli. Ishte festë dhe atje hidhnin fishekzaret. Bënte të ftohtë i madh. Njerëzit në Shqipëri festonin njëzetvjetorin e çlirimit, kurse ne në pus luftonim të likuidonim avarinë, të çliroheshim nga avaria. Bënte ftohtë, dhe qielli, që llamburiste nga Tirana, sikur na ngrohte pak. Drita gjithmonë duket sikur të ngroh.

Vonë, atëkohë kur në fshat filluan të këndonin këndezët, e likuiduam avarinë. Po gdhinte dita e parë e vitit të njëzetënjëtë të Shqipërisë së lirë. Punëtorët se ku kishin gjetur ca raki të fortë, me siguri Skrapari, se shumica e brigadës ishin skraparllinj. Në fakt punëtorë shpimi më të mirë se skraparllinj të nuk gjen. Nejse. Filluam të pinim ne të turnit që likuiduam avarinë. Dhe u deha shpejt. Ndoshta se isha i lodhur dhe s'kisha ngrënë as bukë, a mbase piva me tamaqarllëk të madh se atë ditë më 29 nëndor dhe unë kisha ditëlindjen, kushedi, por atë të dejtur e mbaj mend dhe atë festë e kujtoj gjithmonë kur ka festa».

Kështu i kish ndodhur atij shokut tim dhe këto ja thashë Shemes, duke shtuar nga xhepi im, që zanati më i vështirë në Republikë është ai i punëtorëve të shpimit, se vërtet e kanë vështirë minatorët, punëtorët e koksit e të tjerë, por ata kthehen mbas turnit në shtëpitë e tyre, në familjet e tyre.

Shemja qeshi përsëri dhe unë fillova tashti

të mendoja se ai ose tallej me mua ose ishte mendjemadh.

— Më kujtohet — tha Shemja — ashtu ka ndodhur. Atë mëngjez ne u dehmë të gjithë, jo vetëm inxhinieri që kish ditëlindjen. Më kujtohet. Atë natë bënte të ftohtë të hidhur. Ne dogjëm naftë në një kovë dhe shkoni e ngroheshim. Ne venim të ngroheshim, po kur prekje hekurin e frenave, të mbetej lëkura në hekur, aq i ftohtë ish. Atë natë i kisha mbështjellë frenat me rrecka si bebet me pelena.

— Paske qenë dhe ti atje atë natë — thashë unë gati si duke pyetur.

— S'ka pus ku nuk ka qenë Shemja — tha një punëtor tjetër, Zenuni, që po hante bukë në tavolinën pranë nesh dhe që kish dëgjuar bisedën tonë. Dhe po Zenuni shtoi: — Pyete, o inxhinier, sa herë ka festuar vitin e ri në shtëpi me kalamajtë!

Unë u bëra gati ta pyesja. Po Shemja po hante makaronat i qetë pa e pasur mendjen atje.

— Thuaji, o SHEME, inxhinierit sa herë e ke kaluar vitin e ri me kalamajtë. Nuk flet, hë? Nuk do ta thuash? Po ja tek po ta them unë, o inxhinier. — Dhe punëtori mori pjatën me makarona dhe u ul në tavolinën tonë. — Asnjë vit të ri nuk ka festuar me kalamajtë. Hiç, ore hiç.

— Si asnjë? — u çudita unë.

— Ja, ashtu, asnjëherë në vitin e ri nuk ka qenë në shtëpi. Gjithmonë puseve, gjithmonë avarive. Ore, po këtij i duhet thënë jo SHEME MARA, por SHEME AVARIA.

— Kam dëgjuar që i thonë SHEME DOKTORI — thashë unë.

— SHEME MAVRIA, AVARIA,

Që s'të sheh shtëpia. Kështu i duhet thënë — tha Zenuni.

— Zenun, ore, e di që ke vërtet hakë. More, për ideal, e di që nuk mbaj mend të kem festuar ndonjë vit të ri me kalamajtë? — tha Shemja i çuditur vetëm me atë që dëgjoji dhe që iu duk si një zbulim i papritur.

— Thashë unë që kështu është. Vjet e festuam në Belesovë. Parvjet në Divjakë. Një viti në Kryevih. Ku nuk e kemi festuar vitin e ri ne, kudo në Shqipëri, vetëm në shtëpi jo — këtë Zenuni e tha me një mënyrë të tillë që nuk e kuptoje se ishte i mërzhitur apo ishte i kënaqur kështu me këto festa të vitit të ri.

— Pse, Shqipëria ç'është, nuk është shtëpia jonë? — pyeti Shemja.

— Shtëpi është, por e madhe shumë, ku nuk i takojmë dot çdo ditë kalamajtë e gratë — tha Zenuni dhe, papandehur, më pyeti mua: — Ore, inxhinier, ç'fëmijë ke, or tungjatjeta?

— Dy kam. Një djalë e një vajzë — thashë unë.

— Por sa vjet ke i martuar? — pyeti ai rish-tazi si në gjendjen civile.

— Kam nja gjashtë vjet.

— Ore, po nuk i shërbehet kështu socializmit. Ore, po ç'bëni, ju inxhinierët kështu! Jo, me një, jo me dy fëmijë. Ore, po duhet rritur Republika. Merr, ore, shembull nga unë. Nëndë fëmijë kam.

— I paç me jetë.

— Falemnderit. Merr, ore, shembull nga Shemja, që ka gjashtë fëmijë. Megjithëse edhe ky qerrata mund të bënte më shumë. Kështu bëhen kalamajtë, që të mos u mbash mend as emrin. Por jo dy — i vuri pikë ai bisedës.

Mua nuk po më pëlqente që biseda më Shemen po merrte udhë tjetër. Në tjetër shteg doja të dilja unë. Dhe meqë po bisedohej për fëmijët, unë gjeta rast ta pyesja Shemen për moshën e tij. Ai më dukej i ri, moshatar me mua dhe unë nuk kuptoja dot se si pikërisht ai mbahej si njeriu më me përvojë në likuidimin, mënjanimin e avarive, në ata mijëra punëtorë të naftës.

— Sa vjet ke i martuar? — e pyeta Shemen.

— Kam ca, nja dymbëdhjetë-trembëdhjetë vjet. Por jam martuar i madh. Se gjithë kohën kam punuar puseve dhe s'kisha kohë të shtija sevda me nusen.

— Pse thua se je martuar i madh. Sa vjeç ke qenë kur u martove?

— Tamam burrë isha. Me të mbaruar ush-trinë, u martova.

— Njëzet e një vjeç

— Aq kam qenë.

— Por tashti sa vjeç je? — pyeta unë prapë.

— Aty rreth tridhjetë e katër vjeç.

Kjo përgjegje nuk më çuditi; edhe unë aq e kisha menduar moshën e tij. Tashti ishte tamam koha që unë mund ta pyesja sa vjet kishte që punonte.

— Por sa vjet ke që punon në naftë, Sheme?

— Kam ca, nja njëzet e një vjet. Që kur kam filluar punën, në naftë e kam filluar. Ti e di, Kozarja jonë buzë për buzë puthet me Qytetin Stalin. Ngjitur janë.

— Domethënë, kur ke filluar punën, ke qenë trembëdhjetë vjeç — thashë unë.

— Kam qenë nja tre muaj më i madh se trembëdhjetë vjeç. Sa pata mbaruar shtatëvjeçaren.

Më pëlqente puna e shpimit. Se atje tek ne në Kozarë aso kohe shpoheshin shumë puse. Ika nga fshati dhe vajta u thashë atyre të drejtorisë së kombinatit të naftës se «jam shtatëmbëdhjetë vjeç e dua të hyj në punë në shpimet. Trupin e kisha, mashalla, të zhvilluar mirë. Ata të drejtorisë a u gënjyen nga shtati im, a kishin shumë nevojë për krahë pune, nuk e di si qe puna, por ata më pranuan dhe unë fillova punën në shpim. Dhe po të heqësh dy vjetët kur isha ushtar, gjithë jetën tjetër e kam shkuar puseve. Pa asnjë ndërprerje. Kuptohet që këtu nuk duhen futur ata trembëdhjetë vjetët e fëmijërisë.

Ne kishim mbaruar me kohë makaronat. Kuzhinieri filloi të pastronte tavolinat dhe t'i hidhte ujë me gjym çimentos së dyshemesë. Kjo do të thoshte se ne duhej të ngriheshim. Dhe ne u ngritëm. Dhe përsëri unë iu qepa pas Shemes. Dhe Shemja më çoi përsëri në pus.

Unë kam parë shumë kryesondatorë pranë frenave, por të qëndrojnë njeriu te frenat e sondës, si pranë parmendës, vetëm Sheme Marën kam parë. Kur sheh atë te frenat, ke përshtypjen se ai ka vënë në brazdë gjithë pusin si qetë e urtë.

Pasi vazhdonte ratifikimin-zgjerimin e trungut — dhe nën zhurmën e motorëve, me të bërtitur në rrëzë të veshit, Shemja më tha:

— Ata shokët, që më pranuan në punë aq të vogël, bënë gabim se, po të mos kisha filluar punën në atë moshë, do të kisha mundur të mbaroja të paktën shkollën e mesme.

Unë nuk flisja dot me të bërtitur se më ishte ngjirur zëri.

Nga dreka u bë manovër lart. Pastaj u ul

instrumenti me peshkatore. Dhe Shemja me shokët e tjerë e peshkoi shpejt baterinë; u ngrit instrumenti (gjithë tubat e shpimit deri në 1800 metra thellësi) me gjithë baterinë e peshkuar. Rulos së shpimit i mungonte një kokë. Në vend të saj ai pruri lart dheun e fortë të alevroliteve të moshave të lashta gjeologjike që shponte.

Avaria u likuidua dhe punëtorët i buzëqeshnin njeri-tjetrit të kënaqur e të çlodhur. Të çlodhur nga tensioni nervor që krijojnë avaritë. Unë i shtrëngova dorën Shemes dhe kryesondatorit të turnit, Rexhepit. Por ata më panë me habi, si duket unë isha anekdotik në këtë shtrëngim duarsh. Ata me avaritë ishin mësuar.

Shemja nuk iku atë mbrëmje, se donte të sigurohej mirë për likuidimin e avarisë. Ai priste turnin e natës që të fillonte shpimin. Kështu që natën pata rast përsëri të bisedoja me Shemen. Thashë pak përpara që ai mua më dukej si ata kirurgët me duar të lehta, që i operojnë njerëzit shpejt e pa mundime. Kështu dhe Shemja i shëron pusët shpejt nga avaritë. Por kirurgët janë mjekë dhe mjekët mbarojnë universitetin, kurse Shemja ka mbaruar vetëm shtatëvjeçaren e Kozarës. Unë e ngava prapë për shkollën.

— E kam plagë atë punën e shkollës. Por nuk e ndjek dot, sepse asnjëherë nuk bëj më shumë se dy-tri ditë në Qytetin Stalin. Gjithë kohën puseve. Kur të mos ketë më avari puseve, atëhere mbase dhe unë do vazhdoj shkollën, teknikumin e naftës. Shpimi vetëm këtë të keqe ka që me shkollën s'të lë të takohesh fare — tha.

— Po pse nuk shkëputesh ato mbrëmje që

ka shkollë e të vish në Qytetin Stalin? — pyeta unë.

— Pusin, kur ka avari, nuk e merr dot në xhep si kalemin, bile as në maqinë, o inxhinier. Unë nuk iki dot nga pusi. Ta thashë dhe një herë se kur unë ndodhem në pus, domethënë ka avari. Po më pe ndonjëherë në kinema në qytet, dije se atë ditë asnjë pus në ndërmarrjen tonë nuk ka avari. E beson që edhe në mbledhjet e organizatës bazë mungoj shpesh? Nuk duhet të ndodhë kështu, po ç'të bësh. Ja, bëj autokritikë. Dhe shokët e byrosë bëjnë autokritikë, që s'më krijojnë dot mundësitë për të qenë në mbledhje.

Ne fjetëm të qetë atë natë. Pusi punonte normalisht. Motorët dëgjoheshin deri në fjetore. Shemen e zuri gjumi shpejt dhe gërhima e tij u përzie me zhurmën e pusit. U shkri në një të vetme, që më vuri dhe mua shpejt në gjumë.

Të nesërmen ai iku. Tek e përcillja, më tha:

— Do t'u them atyre shokëve të komitetit të partisë për atë punën e teknikumit me korrespondencë. Mirë të vate në mendje.

Kur po ndaheshim, njeri nga punëtorët i tha:

— Mos ardhsh më, o Sheme Mara. Ja tha këto fjalë sikur t'i thosh «mos vdeksh kurrë, o Sheme Mara».

— Kurrë mos ardhsha këtu, punofshi pa avari e mos më pafshi më — tha Shemja dhe ky ishte urimi më i mirë që mund t'i bënte Shemja pusit.

RRUGËS MIDIS NJERËZVE TË THJESHTË

Atë ditë më kishin thirrur në ministri. Për këtë më njoftuan sapo vajta në punë. Ishte ora shtatë e mëngjezit, kurse në ministri më prisnin në orën një të drekës. Unë isha në Qytetin Stalin. Po të nisesha me autobus deri në Rrogozhinë dhe pastaj ta vazhdoja udhëtimin me tren, do të arrija në Tiranë në orën një e gjysmë. Dhe nga stacioni deri në ministri, duhej gati gjysmë ore akoma. Kështu që s'do të arrija dot. Në fakt kështu dhe ngjau; takimi nuk u bë, por jo për arsye të maqinës apo për faj të shoferit, po për një diçka tjetër, të cilën po përpiqem ta shtjelloj në këtë tregim.

Meqë me autobus nuk arrija dot, atëhere fillova të kërkoja ndonjë maqinë të rastit. Nga instituti ynë nuk nisej asnjë maqinë për Tiranë. Fillova të interesohesha ndër shokët e mi të ndërmarrjeve të tjera të qytetit. Qyteti ynë është qytet industrial. Kështu që mundësia e vajtjeve të maqinave për Durrës, Tiranë apo gjetkë është gjithmonë e madhe. Unë e di mirë këtë, ndaj isha pothuajse i sigurt që do të gjeja maqinë. Vura

libërthin e telefonave përpara dhe fillova të lëvizja rrethin e plasmastë.

— A keni ndonjë maqinë që niset tashti shpejt për Tiranë? Kjo ishte pyetja ime.

Përgjegjet ishin zakonisht të tilla: «Maqina jonë u nis sot në orën pesë të mëngjezit», «Nuk kemi», «Nuk kemi, por pyet...» Në fund, gjeta një maqinë që po ngarkohej me material dhe do të nisej nga ora dhjetë.

Unë kisha gjashtë vjet që punoja në ekspeditat gjeologjike të naftës, dhe gjatë këtyre gjashtë vjetve kisha bërë dy lutje për transferim në Tiranë, pranë familjes. Më ishin përgjegjur se, për mungesë kuadri, duhej të qëndroja akoma në naftë. Këta dy muajt e fundit institutit i kishin ardhur dy specialistë të rinj, të specialitetit tim, të petrografisë, dhe në letrën që i dërgova para një jave ministrisë ja parashtroja me të madhe çështjen e transferimit duke theksuar: «Tashti kuadri nuk është më mangut. Nga ana tjetër kam gjashtë vjet që punoj larg shtëpisë; nënën e kam plakë, gjyshja është me një këmbë në varr dhe ato kanë nevojë për një njeri që t'u rrijë pranë. Djalë tjetër ato s'kanë. Unë, natyrisht, e kuptoj nevojën që ka nafta për specialitetin tonë, por kam gjashtë vjet që punoj maleve, ku janë e ku s'janë» etj. etj.

Pak a shumë këto qenë arësytet e mia, që i paraqitja ministrisë në letrën time të fundit. Kuptohet, të shtruarra e të shkruara bukur, vende-vende trishtueshëm, (duhet të bënte efekt), dhe më dukej sikur ajo e kishte bërë efektin, përderisa më thërrisnin në ministri. Zakonisht, kur ministria vendoste të transferonte, të përgjigjej me ndonjë shkresë,

kurse, këtë radhë, me sa dukej, duhej ta kishin pasur parasysh lutjen. Megjithkëtë pranë kësaj ndjenje sigurie, ruaja dhe një ndjenjë tjetër, atë të dyshimit të madh. Më dukej se në ministri mund të më kishin thirrur për të më thënë: «Vërju punës mirë, more djalë (kështu i kishin thënë një shokut tonë). Ki mendjen te puna dhe jo te transferimi. Kërko shtëpi në Qytetin Stalin; merri dhe plakati me vete. Martohu e gëzoji dhe ato dhe mos u merr me lutje të kota. Puna jote i duhet naftës dhe pikë. Hajde, të dëgjofshim zënë e mirë!». Këtij arësytimi, që i kundërvihej logjikës sime, unë i trembesha dhe kisha kështu, në vetëvete një dyluftim mendimesh, ndjenjash dhe shpresash.

Kjo ishte gjendja ime kur hipa me maqinë. Shoferi dhe punëtorët, që ishin sipër në karroceri, më bënë zë të ulesha përpara, në kabinë të «Zisit», por, meqë dhe një plakë donte të vinte tek e bija, e martuar në Durrës, i thashë shoferit të merrte plakën përpara.

— Më mirë që ërdhe me ne këtu përsipër, në karroceri, inxhinier. Shoferi ynë vërtet është muhabetçi, por është një e do lodhet duke folur gjithë rrugës, kurse ne këtu jemi katër dhe ti pesë e do të kënaqemi dhe rruga s'do të na duket e gjatë, apo jo? — më tha njeri nga punëtorët, sikur donte me këtë të më ngushullonte për vendin e humbur përpara në kabinë.

— Ashtu është, rruga pa shokë është e mërzitshme — iu përgjegja unë.

Punëtorët më hapën vend të ulesha në gomën rezervë të kamionit

— Do kesh sedilje të mirë nën vete — më tha më i riu i tyre.

Ata ishin katër veta. Tre ishin burra të moshuar; tjetri ishte djalë i ri, më i ri se unë. Ishin të katër punëtorë të pusit të Burizanës, që shpohet dikur, pranë Laçit. Dy ishin skraparllinj, një lab dhe i fundit nga Sulova.

— Si vate dasma, o Rakip? — e pyeti njëri nga burrat djalin e ri. — S'je ngopur me nusen mbrëmë. Të trashëgohesh dhe na i bëj hallall që s'të erdhëm dot në dasmë. Por s'ka gjë, ato adetet tona, si punëtorë, do t'i bëjmë në pus; për martesën tënde e kam llafin.

— Falemnderit, xha Abaz; mirë vajti. Na polli një çikë belaja me krushqit, se donin të ma jepnin nusen si qëmoti. Por rinia nuk i la. Mirë që kisha me vete edhe ca nga djemtë e ndërmarrjes, ca shokë, se ndryshe do të isha bërë emër për gazetë. Megjithëqë, po ta marrësh hollë-hollë, s'kishin se ç'bënin të zeztë krushq, se ne, ne të ndërmarrjes, ishim me maqinë, kurse ata me qerre. Ua hodhëm, për nder!..

— Pse mos t'ua hidhje? Ti u more nusen, i hipe dhe maqinës, kurse ata me qerre donin duvak. Hajde mendje, hajde! Paskan qenë budallenj ata atje tek ju, or mik, — tha xha Abazi, njëri nga ata tre burrat e thyer, me mustaqe si të Çaplini. — Vetëm hap sytë se mos, duke u kënaqur me nuse, harron pleqtë. Duhet marrë dhe ata në qytet tashti. Të jetojnë tok me ty dhe me nusen. Mos e bëj si ai i paudhi im, që iku e u fut kollovar në shtëpi të botës — vazhdoi muhabetin xha Abazi.

— Ashtu, ë? S'ja mbushe dot mendjen shej-

tanit të kthehej në shtëpi? Ku e ka ai nderin në botë? — pyeti tjetri. burrë i thyer, që dukej të kishte qenë «kuqo» se akoma nuk kishte filluar të thinjej.

— Jo, bre, nuk ja mbusha dot mendjen. E dini ç'më tha, more vëllezër? Dëgjoni: «Pse ankohe kot, baba? Ti duhet ta kuptosh. Ime shoqe punon në kombinat. Unë punoj në kombinat. Qyteti Stalin me kombinatin janë larg, apo jo? Përderisa Gëzimja (nuses së djalit ja thonë emrin ashtu) ka shtëpinë në Berat, pse të mos jetojmë kështu? Ku është më mirë, të jetosh pranë punës apo larg punës?» «More i pabesë» — i thashë «po pse, ore, unë që punoj tridhjetë vjet larg shtëpisë ç'kam qenë, budalla?» «Jo, nuk ke qenë budalla, por të tillë punë bëje. Mundësi tjetër nuk kishe. Kurse unë mund të zgjedh ku është më mirë. Nesër do të bëhem me fëmijë. Si do të jetë më mirë për ta, o baba? Po të banoj në Berat do t'i zgjoj në orën gjashtë, më gjashtë e gjysmë do t'i çoj në çerdhe, pastaj i hipi pesë minuta autobusit dhe tungjajteta, filloj punën në vahtin që duhet». «Ju, po deshët, ejani të banojmë bashkë» shtoi nga xhepi i saj nusja. «Aa, të falem nderit, o nuse e djalit; deri këtu, më tutje jo! Boll u bë njeri nga ne kollovar, nuk bëhem dhe unë tashti në pleqëri. Unë nderin e kam në shtëpinë time. Atje e ka dhe ky i paudhi im». Kështu u thashë, o shokëni. Gjykomëni në bëra gabim. Por, — ke parë ti? — më thanë që s'kisha të drejtë. Më mirë do të ishte të veja të jetoja me gjithë plakën tek ata. Unë më një qoshe, plaka ime në tjetrën dhe plaka e nuses më atë qoshen atje, të bëheshim kësisoj azil pleqsh. Unë mora flakë, si ai pusi i Marinzës, e

mban mend, Salo? I shava e i ngava dhe ika. Shyqyr që filloj sot punën, se ndryshe për një muaj nuk do ta harroja atë të djeshmen.

— Po, Abaz, po. Në punë harrohen të gjitha, dhe të mirat dhe të ligat — tha plaku kuqalash që ja thoshin emrin Salo. Dhe ai vazhdoi më tej bisedën, që po kalonte nga njëri punëtor te tjetri si një stafetë e shpejtë.

— E di pse erdha në Qytetin Stalin pardje, o inxhinier? Nga ta dish ti, nuk e di. Erdha për djalin — m'u drejtua mua plaku kuqalash. Ishte një burrë i gjatë fort, koka e tij vinte një pëllëmbë mbi timen, kurse unë jam një metër e tetëdhjetë i gjatë. Era e qëllonte mirë dhe në qafë dalloje rrudhat e shumta, që e tregonin se ishte burrë i vjetër; flokët i kishte pa asnjë thinjë. Ai nuk priti ta pyesja unë për djalin, por vazhdoi më tej:

— Kam dhe unë djalë, jo të vetëm si Abazi, por djalin e madh. Se, shyqyr, i kam nja njëmbëdhjetë fëmijë, një batalion. Më shumë djem se vajza. E që thua ti, inxhinier, (unë e kuptoja pse më drejtohej mua. Shokët e tij në maqinë me siguri e dinin historinë), është i paudhë ai djali im. As për shkollë, as për punë, as për vete, as për ne. Ishte djalë i parë dhe e lamë azat, si atë kalin që e lënë pa fre. Unë kam punuar puseve në të katër anët e Shqipërisë. Por, siç e di ti... i martuar je, inxhinier? Jo, e po ta dish, do ta më-sosh kur të martohesh, mëma kujdeset më shumë për fëmijën në gji, se sa për atë që ecën me këmbët e tij. Dhe shtoheshin kalamajtë, kurse djali i madh rritej dhe harrohej. Si ta them, jo se harrohej tamam, se bukën e hante ai më të madhe se timen, por nuk e kishte njeri në zap. Ime shoqe

po grua, dhe unë larg, ç'të bëja? Or, po për nder, ne punëtorët e shpimit jemi miq për kalamajtë. Mik, si ai që vjen me bujtë dhe ikën. Kështu jemi dhe ne. E di ç'më ka ngjarë? Njëherë njëri nga fëmijët, i shtati a i teti, nuk më kujtohet, sa kish filluar të fliste jeziti, belbëzonte akoma, nuk thoshte dot as «k» as «g», dhe kur vajta në shtëpi më thirri «xhaxhi». Nuk më njohu dhe kishte hakë, kolopuçi i babit. Kisha dy muaj rresht në atë pusin e L-8. e kujton, Muço? (Ky që iu drejtua ishte punëtori i tretë, plak, që s'kishte folur asnjë fjalë deri tani). E mban mend? Kishim rënë në avari dhe nuk iknim dot. Jo do ta ndreqim sot, jo nesër, ditët iknin dhe fëmijët, ata që kuptonin, malloheshin, kurse të vegjëlit na harrojnë. Po na kishte marrë një mall për shtëpinë që nuk thuhet dot me gojë.

Shoferi po e ngiste më shpejt maqinën. Era frynte më e fortë dhe ne, pa e kuptuar, ngjiteshim më fort njëri pranë tjetrit të ngroheshim. Xha Salua e ngau më tutje llafin.

— E, ta kisha fjalën te djali i madh, inxhinier. E ka humbur fare yzengjinë, ka qejf të livadhisë si do ai. Mëmën, time shoqe, s'para e dëgjon, mua po nuk ma ka frikën, se një herë në dy javë vete në shtëpi. Do thuash ti dhe të tjerët, punëtorët e shpimit kanë djem; por nuk u janë bërë kështu! Mbase. Jo mbase, por ashtu është, xhanëm. Këtë vit e futa në punë, në fabrikën e tullave, por kam frikë se mos më turpërojë para njerëzve, para partisë. I trembem turpit me të. U thashë atyre të degës ushtarake ta merrnin ushtar. Nuk pranuan. «Ka ligje shteti, xhaxha. Është i ri djali, sapo ka mbushur gjashtë-

mbëdhjetë vjeç». «Po merreni, ore të uruar, se është burrë rrufjani; ja, pashaportën e ka marrë. Merreni se ushtria i bën njerëz edhe më të pagdhëndurit se ky. Merreni. Një çanak më shumë nuk i rëndon shtetit.» «Jo» më thanë prapë «nuk lejohet. Ti përpiqu ta edukosh, xhaxha». «Ç'ta edukoj kur unë jam larg. Të isha pranë tij, dija unë si e rregulloja». Po ata prapë më thanë: «Përderisa është në punë, le ta edukojë kolektivi». Sikur ngenë e djalit tim ka kolektivi. Sikur e njeh atë kryetarin e degës, o inxhinier, të kam parë nja dy herë me të» — më tha papritur mua.

— Po, e njoh. Kanë qenë partizanë bashkë me tim atë. Babai iu vra dhe vdiq në duart e tij, — iu përgjegja unë.

— Po pse s'thua, or inxhinier, që e gjeta kyçin e burimit? Do ma rregullosh këtë punë?

— Nuk jam kundër t'i them, por kam frikë se mos ti e zmadhon ca, me atë djalin tënd, o xhaxha. Mbase ai shoku i degës ka pasur të drejtë kur të ka thënë se e rregullon kolektivi.

— A, ma hëngërt shpirtin me kolektivin. Kolektivi është gjë e madhe. Unë e di këtë. Bile kolektivi është dhe më i fortë se gjyqi; ja, para ca kohe atje tek ne i bashkoi një burrë e grua që deshën të ndaheshin. Por atë djalin tim nuk po e bie unë dot në vijë, kurse ti thua ta bjerë bota.

— Xha Salo, xha Salo, këtu gabove rëndë. Kolektivi është gjithshka. Si guxon ti ta quash veten më të fortë se kolektivi? — tha dhëndrri i ri.

— Ti ke hakë se kolektivi të bëri me nuse, o xhan. Sikur të mos kish qenë ajo maqina e kolektivit, zor se e merrje nusen, ashtu siç deshe

zotrote. Kurse kolektivi tim biri s'ka ç't'i bëjë. Fërderisa unë i ati nuk ja mbledh dot, ç'do t'i bëjë kolektivi? Për tim bir unë jam kolektiv e shkuar kolektivit.

— Jo, do ta bëjë, ke për të parë që ka se ç'i bën. Ata punëtorët e fabrikës së tullave do ta bëjnë njeri atë.

— Ashtu thonë ata, vërtet ashtu thonë. Kur u thashë atyre të bashkimeve profesionale atje në fabrikë: «Ma lini ta marr punëtor me vete në pus», më thanë «Xha Salo, na ofendon kolektivin. Pse, ne çfarë jemi, nuk jemi punëtorë këtu? Apo vetëm ju të shpimit jeni punëtorë?! Do ta edukojmë ne!».

— E sheh? Atëhere ç'kërkon akoma?

— Ushtrinë dua! Ajo i rregullon shpejt.

— Tënden që tënden, o Salo, — i tha xha Abazi. — Dëgjoji djemtë!

— Ka për ta rregulluar kolektivi — shtoi dhëndrri.

— Ja, unë u martova dje, apo jo? Pse vij atëhere sot në punë? Dhe unë e kuptoj që, po të rrija nja pesë ditë me nusen, ishte punë e bukur. Por ja, unë nxitoj të shkoj te shokët e t'u them: «More vëllezër, dua të marr gruan këtu në pus, a më bëni dot një copë vend në barakë?» Me siguri do më bëjnë.

— Ou, ku të ka vajtur mendja! Ju pjell ajo mendja ju të rinjve sot — tha xha Abazi. — Tri-dhjetë e kusur vjet kam që punoj puseve të naf-tës dhe s'më ka shkuar ndonjëherë mendja ta merrja plakën me vete. Po mirë, ja e more, ç'do të bëjë ajo në pus?

— Si ç'do të bëjë? Do jetojmë tok. Në pastë

ndonjë punë andej nga guzhina, do ta fus atje të punojë. Por në mos gjettë vend atje, në bujqësi le të vejë, në kooperativën e Burizanës që e kemi pranë pusit. Fshatare është dhe ajo, nuk i përton punës.

— A e qasin? Pa, po qe se e qasin, boll të jetë me ty ajo, pa dhe në majë të Tomorrit punon — i tha xha Salua.

— Nuk e di. Nuk e kam menduar që mund të mos e qasin — tha dhëndërri. — Po pse të mos e qasin, me ditë pune është dhe atje, shqiptare është, fshatare është. Ç'do të kërkojnë akoma?

— Mirë e ka. Pse të mos e qasin? Bukur e ke menduar. Kushedi, pas teje mbase i marrin dhe të tjerë kështu gratë. Por në punoftë në kooperativë, do të jetë larg nga pusi. Nesër pasnesër mbetet me barrë dhe do ta ketë vështirë të vejë arave matanë lumit, se pusi është me këtë anë të lumit. Ti, sado larg të jesh nga puna, nga pusi, e bën, je djalë, kurse ajo është femër, e rënduar do të jetë. Po, po, më mirë të zësh shtëpi në fshat — përsëriti xha Abazi, si e peshoi mirë mendimin.

— S'më kishte vajtur mendja, xha Abaz; ashtu do të bëj. Të falem nderit. Do ta marr me vete edhe sekretarin e partisë të pusit që t'i thotë kryetarit të kooperativës atje të më gjejë ndonjë dhomë. Do na qasin, se shqiptarë ata, shqiptarë ne. Më vjen keq për pleqtë që nuk i marr dot me vete. Janë pleq e duan rehat tashti, nuk janë mësuar ata të lëvizin si ne, si ata zogjtë shtektarë që, sa vjen behari, e ndërrojnë follenë. Ç'ti bësh, o vëllezër, dikush duhet ta bëjë edhe këtë punën tonë. Në mos ne, të tjerë. Shqiptar do jetë dhe ai

tjetri që do ta bëjë punën time, bir nëne do jetë — i vuri pikë bisedës dhëndrri i Sulovës.

Kjo ishte filozofia e këtij udhëtimi. Dikush duhej ta bënte edhe punën e tyre, një nga punërat më të vështira që njoh. Po kështu dikush do ta bënte edhe punën time. Unë kërkoja transferimin, po a kishte njerëz të më zëvendesonin tashti?

Më bëri përshtypje gjatë këtij udhëtimi burri i tretë, i plakur, që e quanin Muço. Ai nuk tha asnjë fjalë nga ana e tij, vetëm aprovonte ose jo me kokë të tjerët. Pse heshti ky plak gjatë gjithë kohës? Ne po i afrohem Vorës. Atje unë do të zbrisja, ndërsa ata do të shkonin në drejtim të Laçit, në Burizanë. Nuk dija si ta pyesja atë plakun, si ta zbuloja të vërtetën e tij. Pse nuk tha asnjë fjalë gjatë atij udhëtimi? Mora kurajë dhe e pyeta.

— Po ju, xhaxha, pse jeni kaq i mërziur, mos ju ka ngjarë ndonjë taksirat? Apo mos keni njeri sëmurë?

— Gjithë mirë i kam dhe djemtë dhe vajzat, si të martuarit ashtu dhe të pamartuarit. Dhe plakën mirë e kam. Por vetëm se ky është udhëtimi i fundit që bëj me makinën tonë të shpimit. Sot më lidhën pensionin. Vete sa të ndahem me shokët. Mund të ndahesha dhe të shtunën, por shkova me shpresë se mbase në qytet, po ti kundërshtoja, nuk do të më nxirrnin në pension. U thashë atyre të këshillit të bashkimeve profesionale: «Më jepni rrogën vetëm sa të pensionit, asnjë lek më shumë, por më lini të punoj akoma». Nuk deshën. «Nuk bëhet kjo punë, o xha Muço, boll punove. Duhet çlodhur tashti. Dyzet e pesë vjet që punon, ku do të vesh akoma?». U kundërshtova: «Mor, po e kam

filluar i vogël punën. Ndjaj mos shihni vitet e punës, as moshën, por takatin, fuqinë që kam». Nuk deshën që nuk deshën. Ua kishte mbushur mendjen vajza. E kam instruktore në komitet të partisë. Atë e ka yshtur plaka, kurse vajza u kishte thënë atyre të komitetit të mos më linin në punë më. Ja dëgjojnë llafin.

— Po, shumë mirë, xhaxha. Rrove, u nderove, tashti pusho — i thashë unë.

— Ah, jo, biro, jo! Ja, do punosh vetë dhe, kur do të vish në moshën time, do ta shohësh. Të punosh në mes të shokëve, në mes të punëtorëve të shpimit dhe të kërkosh të dalësh në pension? Nuk bën vaki. E kupton vetë ti se je inxhinier; kur të punon këmba e dora, e kam llafin, se, në qofsh zaif, nuk ke ç'punon më. Por po të jesh mirë si unë, vetëm me pahir të nxjerrin në pension. Janë njerëz të mirë punëtorët e shpimit, vëllezër e shkuar vëllezërve. Kurse ti nuk e kuptove pse nuk thashë asnjë llaf. Këta shokët, Salua me Abazin, sikur e bënë me fjalë, nuk më lanë të qaja hallin tim, nuk më lanë të më shkonte mendja te pensioni. Bile edhe ai dhëndrri i ri e ka marrë këtë adetin tonë punëtor. Edhe ti do ta marrësh, inxhinier. Dhe kur ta marrësh këtë adet të mirë, nuk do t'i lësh të tjerët të dërmojnë veten me hallet dhe brengat e tyre, por do t'i marrësh hallet e tyre për vete. Nuk të iket nga shokët e punës, nga nafta. Për gjithë jetë, deri sa të vdesësh, nuk të iket. — Këto ishin fjalët e vetme që më tha në këtë udhëtim pensionisti naftëtar.

Unë kujtova për të fundit herë ministrinë, transferimin dhe më erdhi rëndë që nuk i qava dhe unë hallet e mia me këta punëtorë. M'u duk

sikur me atë lutjen time ministrisë thosha se më ishin mërzhitur këta njerëz. Kurse kjo nuk ishte e vërtetë. Unë i doja këta njerëz, por atë ditë kuptova dashurinë e tyre për njeriun, sa e donin ata naftëtarin plak, xha Muçon, dhe sa i donte pensionisti ata. Dhe kuptova, e ndjeva mirë, që pas këtij udhëtimi unë do të udhëtoja dhe vite të tjera me këta njerëz, por kurrë me atë shkak që udhëtova atë ditë.

I KA NAFTA KËTO

Shoferi ishte plak dhe Gazi ishte i vjetër. Sikur të kishte pension për maqinat, të dy e kishin kohën për pension. Shoferit i kishin thënë disa herë ta linte timonin dhe të kalonte në oficinë. Por ai mendonte ndryshe; ai donte që, bashkë me pensionin, të dorëzonte dhe maqinën. Merre me mend sa i vjetër ishte Gazi, kur gjithë shoferët e ndërmarrjes nuk donin të dilte kurrë në pension xha Vasili, shoferi plak, se ndryshe Gazin karakatinë do ta trashëgonte ndonjë nga ata.

Ndoshta sepse Gazi ishte aq i vjetër, ndoshta nga që xha Vasili ishte shofer për pension, kilometrazhi tregonte gjithnjë shpejtësinë 30-40 km. në orë. Ishte një shpejtësi kjo jo e natyrshme për pasagjerët e Gazit. Për më tepër, ishte një shpejtësi e lodhshme dhe e mërzitshme. Zakonisht me shoferët e rinj dhe Gazet e reja kjo rrugë bëhej për një orë. Kurse tashti dukej qartë që vetëm mbas dy orësh do të arrinin te pushi. Ishte një rrugë e shkurtër, që do të bëhej në kohë të gjatë. Pasagjerët ishin të gjithë të rinj, të gjithë gjeologë. Ata ishin pesë veta.

Në përgjithësi, njerëzit, kur largohen nga shtë-

pia, nga familja, janë pak të mërzitur, pa çka se ka edhe përjashtime. Por atë ditë, megjithëse po largoheshin nga familjet, arësyeja kryesore e mërzisë së tyre nuk ishte kjo.

Fakti që shoferi e ngiste ngadalë maqinën, e shtonte mërzinë; e shtonte, por nuk e krijonte, sepse shkaktari kryesor i mërzisë që e shprehnin qartë në gjithë qënien e tyre të pesë pasagjerët e Gazit të vjetër (qoftë dhe me heshtjen e tyre solemne) nuk kishte ndonjë lidhje as me maqinën, kryesisht, me shoferin dhe as me rrugën.

Pusi i shpimit, drejt të cilit po shkonin, ishte fundi i udhëtimit të tyre, por dhe fillimi, shkaktari kryesor i mërzisë së tyre.

Ata ishin të pestë gjeologë. Në njërën ose në tjetrën mënyrë, të pestë e kishin projektuar atë pus. Dy prej tyre, Pandi me Theodorin, kishin bërë rivelimin gjeologjik të rajonit, ku po shpohej pusi, dhe ishin kështu të parët që sinjalizuan ndërmarrjen për mundësinë e qënjes së një strukture pozitive, të mundshme për kërkimet e naftës. Këta të dy kishin lëshuar kësisoj shkëndijën e parë të shpimit të pusit. Më vonë Ademi me Irakliun kishin bërë rishikimin e materialit gjeologjik të dy të parëve dhe kishin arritur gjithashtu në përfundimin se te vendi, ku sot është pusi, ka strukturë pozitive.

Këtyre të dyve, Ademit dhe Irakliut iu dha detyra e projektimit të pusit. Ata panë dhe studjuan përsëri rajonin, morën parasysh punimet e shokëve të tjerë, analizuan të dhënat e gjeofizikës për rajonin dhe, sipas gravimetrisë, u dilte që pusi në thellësinë 1200 metra do të kapte gëlqerorët. Gëlqerorët ishin objekti i kërkimit. Nëse do

të kapeshin gëlqerorët, mendohej se, pas një për-
vetësimi të tyre, do të gjendej dhe nafta. Ishte pus
nafte dhe gëlqerorët këto kohët e fundit ishin
objekti numër një në kërkimet e naftës.

Projekti u diskutua në ndërmarrje. Për shpi-
min e pusit ishin të gjithë të një mendjeje. Të
dhënat fushore vërtetonin strukturën. Gravime-
tria tregonte ngritje pozitive. S'kishte pse të dis-
kutohej më. Veçse përsa i përket thellësisë së
pusit, ishin hëngër shumë gjeologët. Pjesa më e
madhe mendonte, që thellësia 1200 metra ishte
e mjaftueshme për të kapur gëlqerorët. Faktet
gjeologjike u flisnin për një thellësi të tillë. Të
tjerëve, që ishin më pak, po këto fakte u flisnin
për një kuptim tjetër të strukturës. Ata mendonin
që gëlqerorët nuk kapen as në 3000 metra. Nje-
rëve u duhej nafta. Shumica ishin të mendimit
që thellësia e pusit prej 1200 metrash i kap gël-
qerorët. Kështu që fitoi mendimi i parë. Dhe
këshilli shkencor vendosi të shpohej pusi me këtë
projekthellësi, 1200 metra.

Po kështu, baza paleontologjike, apo mikrofo-
silet, që tregojnë moshën e shtresave të tokës
(ashtu si enët prej balte të ilirëve flasin për
shekujt e qytetërimit të kaluar) ishin të tilla, që
midis paleontologëve nuk pati mendime të njëjta
përsa i përket moshës së depozitimeve që do të
kapte pusi dhe vetvetiu dhe përsa i përket the-
llësisë së pusit. Dhe paleontologët ishin të ndarë
në dy grupe; disa mendonin se në thellësinë 1200
metra do të kapeshin gëlqerorët, kurse të tjerët
kundërshtonin. Për paleontologët të vërtetën
shkencore do ta tregonte pusi i shpuar. I pesti,

ndër pasagjerët e Gazit të heshtur ishte, pra, shefi i paleontologëve

... Dhe pusi kishte gjashtë muaj që po shpohej. Ai e arriti thellësinë 1200 metra, por gëlqerorët nuk i kapi. Ai u shpua dhe më tej, arriti 1500 metra dhe përsëri gëlqerorët nuk i kapi. Kështu që vetë gravimetria kishte gabuar krejtësisht. Kishte gabuar gravimetria! Jo, nuk është puna këtu, por gjeofizikët, në interpretimin e materialit, që serviri gravimetria, aparatura, kishin gabuar. Ndoshta ata do të kishin marrë për gëlqerorë të vërtetë të thellësisë disa shtresa të holla ranorësh, midis flishit, që i kapi gjatë shpimit pusi.

Punëtorëve të shpimit, brigadës që shponte pusin, u ishte thënë qysh para fillimit të shpimit, se projekti i pusit ishte 1200 metra. Por, meqë gjeologët studjojnë sipërfaqen dhe nuk operojnë tokën, si kirurgu njeriun, nuk kishte pse të kërkoje nga ata: ja gëlqerorët në 1200 metra, ja rashë e vdiqa. Mund të gabosh me 200-300 metra. Edhe kirurgët gabojnë, megjithëse ata kanë të bëjnë me njerëzit, kurse gjeologu me tokën. Toka nuk flet vetë, atë e bën të flasë, e detyron. Por jo gjithmonë gjuha e saj kuptohet. Sidomos kur toka është e vjetër, ndodh si me pleqtë, të cilëve u mbeten fjalët dhëmbëve. Këtë e kuptonin mirë punëtorët, prandaj shpuan më tej.

... Kish kaluar kohë. Thellësia e pusit i kaloi të 1500 metrat dhe përsëri gëlqerorët nuk u kapën. Përsëri u ribënë ndërtimet, u paraqitën përfytyrime të reja, të mundshme të strukturës; u morën në konsideratë ato fakte që më parë ishin dukur të dorës së dytë të parëndësishme. Gjeologët mun-

dën t'u mbushnin mendjen punëtorëve se në thellësinë 2000 metra pusi duhej të kapte gëlqerorët. Tashti s'flitej më që do t'i kapte, por mund t'i kapte, duhej t'i kapte. Tashmë dyshohej më shumë dhe kishte filluar të humbiste bindja profesionale te vetë gjeologët...

Sonda që shponte pusin ishte e vjetër. Motorët kishin nevojë për remont. Qysh para këtij pusi, mendohej se do të ishte mirë që ata të remontoeshin. Por ky pus kishte qenë me një rëndësi të madhe gjeologjike. Do të sqaronte jo vetëm këtë strukturë, por gjithë brezin, që vazhdonte në drejtim të kësaj strukture. Koha nuk priste dhe punëtorët pranuan ta shponin në kushte jo të favorshme teknike. Duhej naftë. Pusi shpohej ngadalë. Herë-herë ai binte në avari. Sonda çante në depozitime të forta, bile dhe konglomeratë. Motorët binin dhe kishin nevojë për remont. Megjithatë, në mes të dimrit, (ishte dimër i fortë, i egër ky që kaloi), ditën dhe natën, ata shpuan, sepse duhej shpuar; ata i kapën dhe të dymijë metrat, por gëlqerorët nuk haseshin fare.

— More, po humbasim kohën kot me këtë punë. Gëlqerorëve as u vjen era fare — thanë disa nga punëtorët, që humbën durimin, kur pusi i kaloi të 2000 metrat.

Projekti kishte ndryshuar kështu dy herë. Gjeologët e ndjenin përgjegjësinë për pusin. Por pusi duhej. Nëse dhe ky pus do të dështonte, atëhere gjithë ky brez, vise të tëra të Shqipërisë, do të dukeshin si pa perspektivë për naftë. Prandaj gjeologët ngulnin këmbë që pusi të shpohej më tej. «Ky pus do të vendosë për fatin e një zone të tërë — thoshin gjeologët. — Le t'i shtojmë dhe pe-

sëqind metra projektit». Kështu thoshin inxhinierët gjeologë, kurse inxhinierët e shpimit thoshin që sonda nuk hante dot në atë thellësi.

Të dy palët kishin arësytet e tyre, por ata që do të vendosnin për shpimin ishin punëtorët e brigadës së shpimit.

... Sonda ishte e vjetër. Motorët kishin nevojë për remont.

Dalta shponte ngadalë dhe punëtorët mezi realizonin planin. Sepse plani, përderisa shpohej, nuk ndryshonte. Herë-herë nuk e realizonin dot. Dhe ashtu punëtorët filluan të çonin më pak lekë në shtëpi, por megjithatë shponin.

Këta pra do të vendosnin përsëri nëse mund të shpohej dhe më tepër. Ata ishin naftëtarë, bile më naftëtarë se vetë gjeologët, sepse gjeologët ishin të rinj, kurse punëtorët ishin tashmë baballarë të gjeologëve. Ata ishin naftëtarë dhe e kuptonin se jo vetëm ekonomia, vendi, por dhe ata vetë nuk kishin asnjë kuptim pa naftën, ndryshe do të ishin si ekspozitë të harruar të muzeve, në rastin më të mirë, të muzeut të naftës. Prandaj pusi duhej t'i kapte gëlqerorët, duhej të haste në naftë. Dhe vendosën punëtorët të shponin dhe 500 metrat e tjera.

Shpuan punëtorët prapë tokën mëmë, e shpuan me dashuri, me sondën e vjetër, me motorët e vjetër dhe me duart e tyre të forta punëtore, ashtu si ai bujku plak (baballarët e tyre), që çau brazdën me Balon plak, avash, por mbolli farën, bukën e re. Ashtu dhe punëtorët, ngadalë, me zor, por i kapën të 2500 metrat thellësi, po përsëri gëlqerorët nuk i takuan. Kjo po u ndodhte si në përrallë. Nuk u besohej dot. Nuk kishte më ku

të shkonte. Dhe më të fortët nga punëtorët po humbisnin besimin te gjeologët.

Ndjenja, që i shtynte gjeologët për të kërkuar që thellësia të shtohet edhe më, ishte dashuria për punën e tyre, për të fshehtën e thellësisë së tokës, por kjo ndjenjë do të ishte foshnjarake, sikur të mos lidhesh me atë kryesoren, me rëndësinë e madhe, që kishte ky pus për gjithë brezin.

Ishte kjo gjendje pra që e bënte udhëtimin e pesë gjeologëve shumë të mërzitshëm. Dhe s'kishte faj këtu as maqina as shoferi. Ishte pusi, ose, më drejt, thellësia e pusit, fakti që ai nuk po kapte dot gëlqerorët, shkaktari kryesor i mërzisë së gjeologëve. Maqina çante në vende të bukura, në toka buke me grurë të ri, në kodra me kumbulla dhe mollë lulebardha, që të kujtonin qëndisimat e hershme të gjysheve, me qiell të pastër, që herë-herë zihej nga tufa e zogjve... Ishte ditë e bukur dhe, padashur, të shkonte mendja, se xha Vasili i jepte maqinës ngadalë, jo se ishte plak dhe Gazi që i vjetër, por se donte të ngopej me gëzimin e tokës e të viseve ku kalonte. Bile dhe vendi ku ndodhej pusi quhej Qafë e Lepurit. Kjo me siguri, në një ditë tjetër, do të bëhej objekt shakash për pasagjerët e rinj, sidomos për Ademin, që ishte gjuetar dhe, përveç çiftes dhe tavllës (natyrisht dhe gjeologjisë), nuk donte asgjë tjetër, bile as grua. Po u afrohej të dyzetave dhe akoma nuk ishte martuar. Dhe pse të mos ishte objekt shakash një qafë lepuri, që tashti mbante një pus, një qafë, për të cilën thonë se dhe emrin ja kishin vënë kështu të parët, se dikur këtu, kur kishte gëmusha dhe shkure të shumta (tashti s'ka mbetur asgjë nga këto), lepujt ziheshin me qerre. Bile

ndodhte që lepujt vinin kope-kope sa tremben qentë. Aq shumë ziheshin lepujt, sa që të shkretët gjuetarë, aso kohe, s'kishin nevojë të vrisnin laraska për të siguruar pikat e gjuetisë.

Sikur të mos ishte brenga e pusit dhe sidomos çështja që do të ngrinin ata para punëtorëve, patjetër që shpejtësia 30-40 km. në orë mund të mos dukej aq e vogël dhe e lodhshme, dhe Qafa e Lepurit, me siguri, do t'i bënte njerëzit të mendonin për lepujt dhe jo për pusin.

Por ata të pestë, unë nuk them të gjashtë, sepse i vetmi që qëndronte jashtë këtyre bren-gave, nga që nuk merrte vesh nga gjeologjia, ishte shoferi plak, pra vetëm ata të pestë në maqinë ishin në hall të madh. Gjeologëve në mbarim të atij udhëtimit, u duhej t'u shtronin për diskutim punëtorëve të shpimit shtimin e thellësisë së pusit edhe 500 metra të tjera. Kjo do të ishte shtesa e fundit. Pas kësaj nuk do të kishte shpim asnjë metër më shumë. Nëse, dhe në këtë thellësi nuk kapeshin gëlqerorët, ahëre nuk kishte më shpresë për t'i kapur. Si inxhinieri i shpimit, punëtorët, dhe vetë gjeologët, e dinin që një diçka e tillë ishte shumë e vështirë, një shtesë e re si kjo ishte gati e pamundur. Prandaj, kur u shtrua midis gjeologëve, të cilët dikur kishin aprovuar pusin, se kush do të shkonte për të biseduar me brazdën për këto 500 metra të tjera shpimi, në fillim asnjë nuk kishte pranuar.

Inxhinieri i shpimit e dinte që, nëse sonda do të mund të shponte edhe këtë thellësi të re, ahëre ajo nuk ishte sondë, por diçka kozmike, sepse teknikisht dihej që ajo nuk do të mundte t'u bënte ballë presioneve të mëdha në tërheqje, që do të

duhej të duronte, rreth 70 ton peshë në manovër. Konstruksionin ajo e kishte për maksimum ngarkese teorike deri në thellësi 2500 metra. Kështu që edhe 2500 metra që shponin sondat ishin një mrekulli, apo thyerje normash shkencore, kur dihej se motorët prej kohësh kishin nevojë për remont. Dhe, meqë mrekullitë nuk ndodhin përherë, edhe sonda nuk ka për të shpuar dot më, — kështu mendonte inxhinieri i shpimit të pusit. Kurse për punëtorët një shpim i tillë i mëtejshëm donte të thoshte t'i futje në avari të rënda, që zor se do të mund t'i kaloje lehtë.

Brigada ishte bërë gati të fillonte çmontimin e sondës. Mbas gati një viti pune me nerva të ngritura në mes të erës (se vërtet që qafa ish e lepurit, por erën e kishte të detit), punëtorët pre-gatiteshin të shkonin në një zonë më të qetë. Dhe të gjithë prisnin vetëm urdhërin për çmontimin e kullës dhe të maqinerive. Kështu që kur barba Kiçua, pontisti plak, që qëndronte lart në njëzet e tetë metra lartësi, në ballkonin më të çuditshëm që njoh, në pontin majë kullës, u tha: «Po vjen një Gaz», të gjithë menduan: «Erdhën më në fund ata të drejtorisë të na thonë për çmontimin». Asnjërit nuk i shkoi ndër mend se ata që po vinin ishin gjeologët.

Irakliu, gjeologu, i cili kishte të atin në pusin e shpimit (barba Kiçua ishte i ati), i bëri zë atij. Dhe burri plak, ashtu i gëzuar, siç ngjiste dhe zbriste shkallët e pallatit, ku banon, po zbriste tashti shkallët e hekurta të kullës së shpimit. Sikur të mund të bashkoje shkallët që kishte ngjitur ai gjatë tridhjetë e pesë vjetve të jetës së tij si naftëtar, në kullat e shpimit, kur ngjitej në pont në çiplak,

me siguri me to ai do të ishte ngjitur gjer në hënë, e ndoshta dhe më larg. Përditë me dhjetëra herë i ngjiste ato shkallë. Veçse jo për ditë kur zbriste i qëllonte të takonte të birin te sheshi i shpimit. Megjithëse të dy ishin naftëtarë, atyre nuk u qëllonte të takoheshin me njëri-tjetrin dhe aq më shpesh në pusët. Sepse tjetër pus mund të projektonte i biri, tjetër shponte i ati. Bile dhe në shtëpi më shumë të shtunave në darkë takoheshin. Të tillë punë kishin. Plaku shponte, kurse i biri kërkonte, dhe të dy qëndronin larg shtëpisë. Plaku kur e dinte që shponte pusin e projektuar nga i biri (kish qëlluar nja dy herë kështu), i bëhej qejfi, sepse ishte baba. Por ata djemtë e gjeologjisë këta dy vjetët e fundit kishin hequr emrin e autorit në punën e tyre e sidomos në projektet, kështu që s'dihej se kush i projektonte pusët; «gjeologjia i projekton...» thoshin. Sikur plaku të ishte çoban, si dyzet vjet të shkuara, do të kujtonte se gjeologjia ishte ndonjë zonjë e madhe, që nikoqirepste pusët. Nejse, djemtë gjeologë, mbase kishin bërë mirë. «Kështu — i kish thënë i biri — luftohet deri në fund egoizmi profesional».

Kësaj radhe, ky pus më mirë që ndodhi kështu, pa autor. U projektua 1200 metra të kapte gëlqerorët dhe as 2500 metra s'i kapi. «More, më mirë, bukuri fare, që i kanë hequr autorët, se po të ish se do ta dija se këtë pus e ka projektuar im bir, do të më vinte plasje, s'do t'u dëlja dot njerëzve përpara». Këto mendonte plaku. Dhe, kur pa të birin, u gëzua që erdhi por kur kujtoi që me pusin mund të kishte punë gjeologu, që e kish projektuar, i erdhi keq për të. Sa zbriti shkallët, pati kohë të ngushllonte veten duke menduar: «Se

mos do orëziu që të mos kapen gëlqerorët!» Por gjeologjia shpeshherë është si gjuetia, e di që nises, por, se çfarë do të dalë përpara, nuk e di. Nuk kthehesh gjithmonë me trastën plot.

Barba Kiçua u takua me të birin.

Ademi i tha brigadierit që të mblidhej brigada. Brigadieri nuk u çudit. Ai priste që brigada të lavdërohej për detyrën e realizuar, për punën e rëndë dhe të vështirë që kryen. Në të tilla raste, përpara se t'u thuhej që të çmontohej sonda, flitej për përfundimet e arritura.

Njerëzit u mblodhën te fjetorja. Megjithëse për një pus të thellë, si 2500 metra, duhej të kishte sallë mbledhjeje ose dhomë pune, këtu nuk kishte të tillë, sepse nuk u kishte shkuar mendja njerëzve që shpimi do të zgjaste aq shumë.

Në krevatet ishin ulur nga dy-tre dhe katër punëtorë. Gjeologët zunë një krevat. Punëtorëve nuk u erdhi mirë, që mbyllja e punimeve në pus po bëhej në këtë mënyrë. «Të paktën ndonjë nga ata të drejtorisë të vinte. Nejse, dhe këta djemtë gjeologë mirë bënë që erdhën, se erdhi koha të na thonë, pse nuk i hasëm fare gëlqerorët. Nuk është puna të japin llogari si në gjyq, por të na sqarojnë, pse ndodhi kështu, që të mos u ngjajë më gjetcë» — mendonin punëtorët.

Irakliu, se ai po fliste në emër të gjeologëve, ndjente vështrimet e punëtorëve, megjithëse sytë i kish mbërthyer te një parullë, ku shkruhej «Brenda vitit të dorëzojmë vendburimin e ri të naftës». «Vendburimin nuk po e dorëzojmë» mendoi ai dhe përsëri ndjeu vështrimet e punëtorëve, vështrimet e shokëve, dhe gjithnjë, megjithëse për-

piqej të mos takohej me ta, haste sytë e të atit, të barba Kiços dhe përsëri ajo parulla...

Plakut i vinte keq që po fliste i biri. Ç'do t'u thosh ai shokëve, punëtorëve? Ç't'u thosh plaku shokëve, kur i biri dukej se s'ishte në binarë? Ai kërkon që brigada të shpojë edhe 500 metra të tjera! 500 metrat e fundit! Kështu thanë dhe ahëre, kur u shtua projekti në 1500 metra, në 2000 metra, në 2500 metra; tashti i biri thotë të shtohet projekti në 3000 metra! «Ç'bën ky djali im dhe shokët e tij, lozin? Me kë lozin, xhanëm, me ne punëtorët, me djersën tonë dhe paratë e popullit? Pse bënë gjithë atë shkollë, që të lozin kështu me ne? Çudi e madhe!» Nuk i besohej plakut; nuk u besonte veshëve. Ndërsa i biri vazhonte:

— Shokë, ne e kuptojmë mirë sa e vështirë, pothuajse e pamundur, është të shposh me këtë maqineri edhe 500 metra të reja. Por ne jua themi troç juve, mu si vëllezërve («dhe baballarëve» mendoi plaku); jemi fajtorë, jemi të paaftë. E rëndë është sa s'mbahet ta thuash këtë, por jemi të pazotë; u treguam të paaftë në projektimin e këtij pusi. Pse ta fshehim pazotësinë tonë, nga babai im, nga ju? Jo, shokë, ne nuk e fshehim. Por dhe pranimi i pazotësisë sonë nuk e shpëtoi pusin. Ne e kuptojmë mirë këtë. Atëhere ç'kërkojmë ne? Pse ngulim këmbë ta shpojme dhe 500 metra të tjera, me sakrifica, me mundim të madh? Mor, po në fund të fundit të shpojme sa të mbajë sonda...

— Sa të mbajë sonda? Çfarë sonde? Ajo ka kohë që s'duhet të mbajë më — ndërhyri inxhinieri i shpimit të pusit.

Barba Kiços i vinte për të vjellë nga inati,

sikur e kishte zënë gazi. Kështu i kish ndodhur kur e kish zënë gazi njëherë, kur shpërtheu fontana e D-4.

Por Irakliu bëri sikur nuk e dëgjoi kolegun e tij të shpimit dhe vazhdoi: — Sa të mbajë sonda, shokë. Është shumë keq të ikim nga kjo zonë pa rezultat. Sikur të jenë gëlqerorët më thellë, sikur të jetë struktura, si do të kthehemi ne prapë këtu? E vërteta është që me sakrificat dhe zotësinë tuaj do të mund të mbulohet pazotësia jonë. Ne nuk duam të fshihemi pas kësaj, por vetëm kështu do të mund të zbulohen gëlqerorët. Ç'të themi më tepër, shokë? Pusi nuk duhet lënë kështu i varur, pa kapur gëlqerorët. Le të shpojme më tej, pa gjithë të tjerat, gjithë të këqiat i marrim ne vetë, ne gjeologët, ndaj kemi ardhur këtu, ndaj ju lutemi juve të gjeni rrugët për shpimin më tej të pusit. Ju vendosni tashti dhe jo ne! Këtë ne e dimë, e dimë mirë, por pusi duhet... ju vendosni... por duhen kapur gëlqerorët...

Barba Kiçua e ndjeu që i biri ishte i ndershëm. Ai nuk gënjeu asnjëherë. E, pra, mund të zbuluronte dështimin e pusit me fjalë shkencore, me fjalë të mëdha që të mos kuptohej hileja, ta vishte dështimin me hile të zanatit, se çdo zanat ka hiletë e tij; por jo, i biri i tha troç të gjitha, me zemër të hapur, sikur të ishte vetë plaku, apo sikur t'ja thoshte vetëm atij, babait të tij, dhe jo gjithë brigadës.

Jo se ishte i biri, por për djem të tillë, që nuk u fshehin asgjë punëtorëve, filloi të mendonte barba Kiçua, se duhej shpuar më tej ai pus. Se nuk kish pse të ngulnin këmbë aq shumë në atë ters pus, sikur të mos ishte gjë shumë e rëndësishme.

Plaku ishte gati të qëndronte dhe javë të tjera, atje majë pontit, me kokën në trastë, se, në qoftë se do të shembej pusi, do ta pësonte i pari ai. Po ra kulla, s'ke nga hidhesh kur je në majë të saj, siç është pontisti.

Ai ishte gati të shponte ndoshta pse këtë e kërkonte i biri. Pikërisht nga kjo ridjenjë kishte frikë punëtori plak. Prandaj mendonte: «Mirë unë jam gati, po shokët e brigadës a do të ishin gati? Ja Mënua, shoku im i vjetër, për hatër të shoqërisë, mund të jetë gati. Po të tjerët, ç'interes kanë të tjerët? Plani as nuk do të realizohet, ose me zor të madh do arrihet; lekët do të pakësohen dhe kokën do ta kenë në rrezik. Zor se do t'u mbushet mendja të gjithëve për shpim. Por nuk qenë të gjithë të një mendjeje, kush do ta shpojë? Vetëm unë majë kullës? Jo! Jo, por mund të jepet urdhër nga lart. Urahëri urdhër, por urdhër, që nuk zbatohet dot, asnjë nuk jep sot. Ata që vendosim jemi ne, brigada. Ç'do të thonë shokët? Të presin shokët, biro!»

Dhe shokët filluan ta shoshitnin mirë, ta peshonin mirë llafin e Irakliut. Ata filluan nga pyetjet dhe mbaruan me diskutimet, si në çdo mbledhje pune. Dhe në blokun e vet Irakliu, shënoi pyetjet:

— A e keni parë ju gjeologët gjendjen e pusit në kompleks, pavarësisht nga dëshira juaj për të shpuar më tej? — pyeti i pari nga punëtorët.

— A keni mendim unik të gjithë gjeologët për shtimin e thellësisë së pusit? — pyeti i dyti.

— Po sikur të shpohet më tej, deri në 3000 metra, dhe gëlqerorët të mos kapen, ahëre çfarë ndihme do të jetë kjo për sqarimin e ndërtimit gjeologjik të tërë brezit, ku kërkojnë naftë? — pyeti i treti.

— A mendohet të shpohet pusi i dytë në këtë strukturë, në qoftë se ky pusi ynë nuk do t'i kapë gëlqerorët? — pyeti i katërti.

— A keni marrë parasysh harxhimet që do të bëjë pusi, po t'i shtohet thellësia edhe 500 metra të tjera? — pyeti i pesti.

— More vëllezër, a mendoni për kalamajtë tanë? Me këtë që kërkoni ju, ne s'do kemi lekë as për duhan!

— Pusho, more ti, aty, vetëm interesin tënd sheh ti. Sikur je babai i interesit personal — i thanë shokët atij, që pyeti për punën e lekëve.

— Kur nuk kishit të dhëna të sakta, pse e projektuat pusin në fillim 1200 metra, pastaj 2000 metra pastaj 2500 metra, kurse tani na thoni 3000 metra? Pse nuk thatë qysh në fillim 3000-3500 metra, që dhe ne të kërkonim sondë tjetër dhe motorë të pregatitur, të gatshëm për të tillë thellësi? — Kjo pyetje ishte e inxhinierit të shpimit.

U bënë dhe pyetje të tjera, të cilat nga forma ndryshonin, por në fakt qenë po ato, të cilave po u bëhej gati t'u përgjigjej Irakliu.

Gjeologët e ndjenë se shumë pyetje të çonin në përfundim që pusi të mos shpohej më tej. Por dhe një pjesë e pyetjeve tregonte që brigada kish forca për ta shpuar pusin deri në 3000 metra. Përderisa ata shtronin problemin: «Po sikur të shkojmë deri në 3000 metra dhe të mos kapen gëlqerorët?» donte të thoshte që tremijë metrat mund të kapeshin, por nëse s'kapen gëlqerorët, atëhere kujt i duhej gjithë ky mundim, shpenzimet dhe koha e humbur? Nëse jemi të sigurt që nuk i kapim gëlqerorët, atëhere nuk kemi pse robëtohemi kot.» Këtë donin të thoshin ato pyetje. Këto sikur

i ngrohën disi gjeologët. Atyre u vinte keq që punëtorët nuk kishin pothuajse më fare besim tek ata. Irakliu dha përgjigjet e pyetjeve. Dhe përsëri doli me përfundimin se pusi duhej të shpohej, duhej të shpohej, se ndryshe po braktisej një zonë e rëndësishme.

— Duhet të shpohet! Po si të shpohet? — tha brigadieri, që hapi i pari diskutimet. — Maqinaria është bërnut. Do remont e shkreta, se nuk ishte përgatitur për këtë thellësi. Na morët në qafë, more shokë gjeologë! Të na kishit thënë qysh në fillim. Mirë e pati inxhinieri. Na thoshit 3000 metra duhen, urdhëro; dhe ne do të kërkonim maqineri për kaqë metra. Jo, po na e bëtë me të pabesë. Pa ngritur sondën, na thatë 1200 metra, si e ngritëm e shpuam, shto e shto projektin. Ne shpo dhe ju shto. Ne shpo dhe ju shto. Aq sa na mbyttët fare. Nuk shpohet më tej ky pus. T'i vemë kyçin kësaj pune. Nuk shpohet, jo!

Fillimi i diskutimeve ishte pa shpresë. Por ata që do të vendosnin ishin jo vetëm brigadieri dhe ai punëtori, që kërkonte të dinte a mendonin gjeologët për kalamajtë e tij. Ishin njëzet burra, dy ndërresat e ditës dhe ata dhjetë burrat e tjerë të ndërresës së natës, që po flinin. Por dhe ata do të pyeteshin, pastaj do të vendosej.

— Për mua, brigadier, më duket se mund të shpohet akoma. Vërtet se zor e kemi ta hamë, por është copë e majme, janë gëlqerorët poshtë, brigadier! Le që dhe në L-3 po kështu qemë, por i hëngrëm ama dhe 3400 metra — tha motoristi i pompës.

«Vota e parë për pusin» — menduan gjeologët.

— Rri urtë, o Braçe, ti i ke mirë motorët e

pompës, njëditëzaj i more. Por me ata nuk shpohet pusi, or mik. Të flasim motoristët e sondës; ata e dinë në e hanë dot apo jo tremijëmetërshin këtu, — ndërhyri brigadieri, i nisur nga mendimi që motoristët e sondës duhej të ishin kundra, mbasi dihej se, po ta linin këtë pus, në atë pusin tjetër, ku do të shkonin, do të merrnin motorë të rinj.

Ishte e qartë që brigadieri nuk donte. Bile ai bashkë me inxhinierin ishte kundërshtari kryesor për shpimin më tej të pusit. Brigada deri tashti kishte qenë e dalluar. Asnjherë nuk kishte rënë në avari të rënda. Kështu që dhe brigada ishte dalluar dhe brigadieri që i shquar. Bile fotografinë e tij, me raste festash, e shikoje në mes të qytetit naftëtar. Kurse me këtë pus, në këtë thellësi që kërkonin gjeologët, me siguri do të binte në avari të rëndë, mendonte ai, dhe nga brigadier i rendimenteve të larta, do të kthehej në brigadier i rendimenteve të ulëta. Bile, qysh kur pusi kaloi të 1500 metrat, brigada e kishte marrë këtë rrugë; por në shpoftë më shumë se 2500 metra, s'e shpëton më asgjë brigadierin. «Do të turpërohem fare», mendoi ai.

— Mirë. Ti, shoku brigadier, ke të drejtë, që motorët e sondës kanë rënë shumë. Bile inxhinieri tha sot se dhe presioni i vajit po bie. Kanë rënë, por jo aqë ama se t'i hedhim poshtë. Bëjnë dhe pa remont kapital ata, o xhan, bëjnë — tha mekaniku më i vjetër i pusit. Fjala e tij në pus peshonte si ajo e atyre profesorëve në mjekësi. — E hanë motorët edhe tremijëmetërshin, pa çka që do duan ca punëra të vogla, por, si thonë shoferët, në ecje e sipër, në punë e sipër t'i rregullojmë — përfundoi ai.

Vota e dytë. Por kjo votë ishte shumë e fortë.

— Shpohet, xhanëm, por do vuajmë cazë — tha njëri nga sondatorët. Sikur kjo cazë të mos dihej se ç'ishte, njerëzit do ta merrnin për lodër. Por kjo cazë kishte të bënte me fatin e pusit.

— Ç'i duam llafet. Kur duhet, do ta shpojme; do shpojme sa të mundim veç naftë të dalë, se u turpëruam — tha sondatori tjetër.

«U turpëruam», kjo ishte fjala më e rëndë, ajo që i goditi më shumë gjeologët. Punëtori nuk tha «na turpëruat», e pra mund të thoshte dhe ashtu, por e mori mbi vete gabimin e tyre dhe tha «u turpëruam». — Ndërgjegjja e klasës — mendoi Pandi, — që përpiquej t'i gjente shpjegim filosofik çdo gjëje.

— Vërtet që do të humbasim ca nga të hollat, do të na shajnë gratë, po shqipëtarë, naftëtare janë dhe gratë tona apo jo? Do t'u themi: gabuam, morëm superxhiro dhe nuk po gjejmë dot gëlqerorët. Duroni ca, të dashura gra! Pak fare do të duroni, se gëlqerorët do t'i gjejmë apo jo? — tha Nevruzi, mekaniku i ri, që kishte gjashtë vajza e po luftonte akoma për djalë. Kur thoshte «gratë» ai kishte parasysh dhe vajzat e tija, jo vetëm gruan.

Kjo ishte goditja e fundit; të paktën kështu u duk, sikur ishte goditja e fundit për ata, që nuk donin të shpohej pusi. «Kur vetë mekanikët dhe, më shumë akoma, vetë Nevruzi, që është me gjashtë fëmijë në shtëpi thoshte të shpohej pusi, aherë ç'kërkojmë ne? — mendonin punëtorët e tjerë.

U duk sikur punëtorët u bindën që pusi duhej shpuar dhe mund të shpohej. Tjetër njeri nga punëtorët nuk po bëhej gati të fliste dhe gjeologët

po lehtësoheshin nga pesha e rëndë e mërzisë. Bile tashti Irakliu nuk u bënte më bisht syve të të atit. Të gjithë punëtorët si gjeologët ashtu edhe punëtorët ishin më të qetë.

... Por inxhinieri i shpimit të pusit nuk ishte i qetë. Ai u tha gjeologëve:

— Mirë bëtë që erdhët të jepni llogari këtu para punëtorëve për shpimin. Shumë mirë. E mirë ishte edhe autokritika.

— E, more, dhe ti, Mitaq. Ç'llogari? Sikur jemi në gjyq këtu. Ne po qajmë hallet me njëri-tjetrin, ti na thua — «jepni llogari», mos e tepëro — i tha xha Nikua inxhinierit.

— Jo, xha Niko, mirë bënë që erdhën të japin llogari. Një për një të japin llogari, se fluturojnë ngandonjëherë këta gjeologët. Ne punën tonë e bëmë, shpuam sa deshën ata, gjeologët. Sa u deshi qejfi atyre. Tani na thonë se duhet shpuar më tej akoma. Ku akoma? Më duket brigadieri e sqaroi mirë. Maqinaria, motorët, duan remont, bile remont kapital. Ka norma teknike, nuk i thyejmë dot. Le që po u çmendëm ne dhe duam t'i thyejmë këto norma, ka të tjerë njerëz lart që nuk na lënë. Për budallenjtë ka të mençur. Ne nuk e kemi pregatitur këtë sondë për tremijë metra, dhe ju që i përkrahni gjeologët, harroni mundësitë teknike. — U dëgjuan zëra që po përpiqeshin ta kundërshtonin inxhinierin.

— Mirë, mirë, ta zëmë se unë gaboj dhe shoku Niko (gjithmonë përpara kësaj dite e thërriste xha Niko) ka të drejtë dhe motorët durojnë, ta zemë se gjendja është edhe këtu si në pusin L-3 edhe mund të shpokemi deri në 3000 metra. Por, a s'më thoni ju, shokë punëtorë, shokë

shpues, që përkrahni gjeologët, ç'bazament kishte L-3?

— Bazament të zakonshëm, me slitë — u përgjegj dikush nga brigada.

— Po, me slitë. Po çfarë slite? Të jashtme! Ajo ishte slitë me çelik special dhe saldim special. Kurse slita, ku është vendosur sonda jonë e këtij pusi, është e vendit. Unë nuk dua të të nënvleftësoj...

— Jo, por ta hedhësh poshtë do! — tha motoristi i pompës.

— Unë nuk dua të nënvleftësoj, po e theksoj. Por ajo lavdi pastë që duroi e mbajti dhe 2500 letra kollonë shpimi.

— Ti dhe kaq nuk besojë se do të mbante, inxhinier. Por ja që mbajti — i tha babai i gjashtë vajzave. Por inxhinieri nuk iu përgjegj.

— Ç'kërkoni të bëjmë më tutje me slitë vendi, të salduar te xha Ramua, të shpojme tremijë metra? Po kur të mbetet kulla, kush përgjigjet? Nuk bëhet kjo, shokë! Përpara teknikës duhet të tërhiqemi. Përndryshe, ky është guxim i tepëruar! Marrëzi!

— Inxhinier, inxhinier, mbase e ke dhe mirë, por nxitohesh, more i uruar, nxitohesh. Vërtet ashtu është. Slita është e vendit, kurse në L-3 ishte e huaj. Vërtet xha Ramua ka ngjitur më shumë teneqe se sa slita sondash. Por mos harro, mor bir, që ka njëzet e pesë vjet xha Ramua, që saldon dhe hekur e jo vetëm teneqe. Mos harro, që xha Ramua saldon për ne, për shokët e tij. Dhe në saldoftë ai për mua ose unë për atë, njëlloj është, dije, more inxhinier, që do ta saldojmë mirë. Mor, do ta qepim atë tegelin e sal-

dimit si ai doktori plagën, apo si ai terziu i mirë rrobën e mirë, në mos më mirë akoma. S'bëhet ndryshe, — vazhdoi xha Nikua. — Do të mbajë slita! Se në ka mbajtur e huaja një herë, ajo jona do të mbajë dhjetë herë. Bën punë pa hile punëtori ynë, xha Ramua, inxhinier! Dëgjon apo jo?

— Gjithmonë nuk më ke kuptuar, shoku Niko, gjithmonë. Unë, natyrisht, besoj në ndërgjegjen socialiste të punëtorit tonë, në aftësitë e tija profesionale, në duart e arta tuaja, more shokë, se ndryshe s'kisha si të jetoja midis jush. Besoj, pa diskutim, besoj në dëshirën e mirë të xha Ramos. Por veçse, kur vjen puna në teknikën, në teknikën e vërtetë shkencore, me mirëbesim kristian nuk shkohet.

— Çfarë besimi kristian? Ne me kohë i kemi prishur kishat — u dëgjua një zë i ri.

— Unë besoj xha Ramon, por më shumë besoj teknikën. Saldime për pesha si kjo që doni t'i jepni ju slitës, bëhen me çelik special dhe kontrollohen me aparate speciale, me rontgen, aparat rontgeni, si ai që vizitojnë të sëmurët. Kurse saldimit të xha Ramos një gjë e tillë nuk i është bërë. Ta hajë e mira, ta hajë! (Ai nuk thoshte dot, ashtu si punëtorët «ta hajë dreqi», nuk ja lejonte kultura). Ne xha Ramos duhet t'i themi falemnderit, ta vëmë dhe në tabelë të nderit për këtë slitë që duroi kaq, dhe pikë muhabetit — i tha fund fjalës inxhinieri i shpimit.

Tashti mbledhja mori karakter tjetër. Dukej sikur një ciklon fryu dhe shkatërroi çdo gjë. Pandi, që i kishte qejf përfundimet teorike, mendoj se kush do t'i kundërvihëj tashti inxhinierit. Që ai gabonte, duke nënvleftësuar kështu mendimin dhe

forcën krijuese të punëtorëve tanë, kjo dukej qartë. Por faktet teknike që ai sillte, dukeshin bindëse. Kush do t'i kundërvihet mendimit të tij? Nga shokët e tij gjeologë, Irakliu mund të fliste më mirë, por s'kishte kuptim, domethënë nuk do të kish atë logjikë, që do të kishte, po të flisnin punëtorët. «Ç'naivitet» vazhdoi të mendojë Pandi. «Kushdo mund t'i kundërvihet. Praktikisht kolegu i tyre s'ka të drejtë. Por zor të kundërshtosh teorikisht atë. Kushdo, por me siguri, të paktën barba Kiçua nuk do t'i kundërvihet».

Por, për çudinë e sigurisë së tij, ai pa barba Kiçon që u ngrit. Plaku ndezi llullën. Kjo tregonte që ishte fare i qetë. «Ç'do të thotë babai?» — mendoi Irakliu.

— Ore, inxhinier, a ke qenë ndonjëherë në uzinën e koksit? — e pyeti barba Kiçua inxhinierin e shpimit.

— Kam qenë — u përgjegj ai i habitur nga që nuk priste të flitej për koksin te pusi.

— Ke qenë, thua. Shumë bukur. Ç'të ka bërë përshtypje atje më shumë?

— Më ka bërë përshtypje që uzina është ngritur pranë qytetit dhe e mbyti qytetin me gaz — tha gjithë inat inxhinieri.

— Ashtu është. Ke hakë. Por gjë tjetër të ka bërë përshtypje?

— Jo, asgjë. Çdo gjë tjetër është sipas rregullave teknike. Teknikisht në rregull — tha i lodhur inxhinieri, që nuk po e merrte vesh se ku donte të dilte pontisti plak.

— Aty ta kam, o inxhinier, — tha i gëzuar plaku. — Çdo gjë tjetër sipas rregullave teknike.

Punëtorët, gjeologët, inxhinieri i shpimit dhe

veçanërisht Irakliu tashti filluan ta kuptonin ku deshi të dilte barba Kiçua, sepse uzina e koksit dihej që ishte krejtësisht shqiptare, bile dhe projekti. Dhe plaku vazhdoi:

— Çdo gjë tjetër sipas rregullave teknike. E po mirë që e the me gojën tënde, o inxhinier. Por a e di zotrote, që kazanët, e, ore, tridhjetë kazanët e të tri baterive të koksit janë të gatuar në vend, në Shqipëri, or byrazer? Ta kam llafin që saldimi i atyre goxha kazanëve, sa një dhomë e madhe gjumi, është bërë nga xha Ramua. Dhe e di ti ç'temperaturë duron saldimi i xha Ramos? Në mos e di ti, ta them unë: 600 gradë; hiç më pak, as një gradë. Kanë vite që po punojnë kazanët dhe ç'të punuar se... Dhe një delegacion rumun, gjithë profesorë ishte, u çudit me ta. Shkrijnë koxsin pa pushuar fare të zeztë kazanë dhe durojnë, or, për nder, si për inatin tonë durojnë. (Ai donte të thoshte «si për inatin tënd, inxhinier», por i erdhi keq, se dhe inxhinieri për të mirën e punës përpiquej, vetëm që së prapthi). S'duan t'ja dinë kazanët as për rontgen, as për ndonjë aparat tjetër. — Plaku thithi mirë llullën dhe, si u ngop me duhan, vazhdoi:

— Jo, sikur thashë unë që s'duhet... Mirë do ishte që ta shihnim në rontgen dhe hekurin si njeriun, por nuk i ka xha Ramua ato takëme sot për sot. Kur t'i kontrollojë dhe me ato, do t'i kontrollojë, kush tha që s'do t'i kontrollojë? Por, ama, do të durojë slita, inxhinier, do të mba-jë ajo, se e kanë bërë shokët e babait tënd! Sikur të të dëgjonte yt atë, se ish burrë i punës ai, ndaj vdiq dhe në punë, do të të pësh-tynte e do të thosh «Hiqmu tutje, lanet, se ti

s'paske besim te klasa punëtores, s'paske besim te xha Ramua»; ishin shokë ata të dy. Le që dhe ti nuk i thua kot xha Ramo! Po pse nuk i thua shoku Ramo, ë?

Inxhinieri heshti. Ai s'dinte si të kundërshtonte më. Logjika e plakut ishte logjikë e fortë punëtores, si ajo e të atit, që sapo ja kujtoi barba Kiçua.

Pandi, që i pëlqente përgjithësimet teorike në fund të mbledhjeve, nuk mendoj që këto do t'i bënte barba Kiçua, më i vjetri punëtor i pusit.

— Besoje barba Kiçon, inxhinier, mbasi në qoftë se nuk mban slita e rrëzohet kulla, ai, që do të na lërë shëndetin i pari, do jetë ai, pontisti ynë, shoku barba Kiço — tha me gëzim babai i gjashtë vajzave, sikur donte që mbledhja, që ishte aq e rëndë, të mbaronte si ai i qeshur.

Ashtu siç filloi pa bujë, ashtu dhe mori fund mbledhja. Shkaku i mërzitjes së gjeologëve u zhduk. Pusi do të shpohej, kështu që mund të bëhej dhe shaka.

— A do të vish sonte me ne në qytet, barba Kiço? — i tha Pandi. — Ka ditë që të pret me mall Kiçovica.

— Jo, ore, lanet, nuk vij dot, se po përgatitem të hidhem nga kulla — tha ai duke qeshur me sytë drejtuar inxhinierit të shpimit. Inxhinieri buzëqeshi hidhur

— Ç't'i them nënës, baba? — e pyeti Irakliu plakun.

— Thuaji të më dërgojë rrobat të ndërrohem. Na fute në punë të rëndë, more djalë. — Nuk kuptohej se ku e kishte fjalën plaku te puna e ardhshme për shpimin më tej të pusit deri në 3000 metra, apo ndoshta te mbledhja.

— Ç't'i bësh, baba, i ka nafta këto — i tha Irakliu të atit, po ato fjalë, që kishte dëgjuar kushedi sa herë në fëmëni, që i thoshte i ati nënës, sa herë që ajo ankohej, kur për javë të tëra nuk vinte babai në shtëpi.

— Hë, qerrata, i ka nafta këto. Por, ama, nafta dhe jo pusët fyçkë, — iu përgjegj me shaka i ati shakasë së të birit.

«Nuk e lëmë hakën pa marrë ne» mendoj Pandi tek dëgjonte ata të dy.

Kurse Irakliu mendoj që, mbas tre-katër muajve, pusi do të kapte gëlqerorët dhe njerëzit do ta harronin këtë ditë të vështirë.

K I O

— Do ecim akoma, Kio? — pyeti më i riu.

— Kemi dhe ca udhë, o xhan, kemi — ju përgjegj më i moshuari.

— Sa rrugë kemi bërë, Kio? — këtë pyetje ai mund të mos e bënte.

— Goxha, o xhan, goxha. Të shumtën e kemi hedhur prapa krahëve. Edhe pak na ka mbetur.

— Ti më bën qejfin, Kio!

— Jo Pse?

Dhe ai tjetri, që quhej Kio, nuk vazhdoi më tej. Ai për të parën herë në jetë gënjeu. Në fakt, ata nuk kishin bërë as çerekun e rrugës. Por shoku i tij jepte shënja të theksuara lodhjeje, pa çka që nuk ankohej, dhe atij i erdhi keq. Kuptohej, që po të mos i jepte zemër, ai mund të mbetej në vend në mes të borës dhe të rrugës. . .

Kio çante borën i pari. Pas tij vinte partizani tjetër, ai që po lodhej. Bora ishte gati një metër e trashë dhe Kio e kishte shumë vështirë ta çante. Megjithatë, ai që po lodhej më shpejt ishte partizani tjetër, ai më i riu, që tashti nuk çante borën.

Ndonjë ndryshim të madh në moshë midis tyre

nuk kishte. Partizani i ri mund të ishte nëndëmbëdhjetë-njëzet vjeç, kurse Kio beharin që vinte do të mbushte tridhjet vjeç, bile po ta merrje lodhjen në përpjestim të zhdrejtë me moshën, siç ndodh zakonisht në jetë, ai që duhej të lodhej më pak, patjetër do të ishte partizani i ri, kurse me këta të dy ndodhte e kundërta. Vërtet Kio ishte pak më i madh, por ai kish qenë sharrëxhi fshati dhe i kish shetituar kushedi sa herë këto male kur ishte i vogël pas të jatit. Dhe qysh ahëre kishte mësuar zanatin e baba-bait dhe rrugët e maleve.

Kuptohet, pra, pse shtabi i brigadës e mbante Kion korier pranë vetes dhe pse tashti dërgoi, pikërisht atë, në batalionin e bregut. Ai i njihte mirë malet e Çikës. Mbanë tjetër, edhe malet edhe shokët partizanë, të gjithë e njihnin mirë atë, Kio Partizanin, korierin e brigadës. Ashtu sikundër e njih-te dhe ky djali i ri, emrin e të cilit Kios nuk ja tha njeri. Ja kishin dhënë për shok dhe kaq i mjaftonte atij. Fjala shok i vinte kapak çdo gjëje.

Ishte operacioni i dimrit. Janar i vitit 1944. Brigada ishte ndarë në tri pjesë. Ishte ndarë kështu që dhe forcat armike, gjermanët dhe mercenarët e Xhafer Devës, të ndaheshin po kështu në tri pjesë. Një ndarje e tillë bënte që sidomos armët e rënda të gjermanëve, artileria të mos kishin mundësi të grumbulloheshin bashkë e të jepnin goditje të forta. Dhe këtij qëllimi shtabi i brigadës ja arriti. Vërtet që gjermanët përdorën topa edhe në Ramicë, edhe në Vërnik, edhe në Sukë, edhe në Kundrevicë, por asnjëherë aq të fuqishëm, sa do të ishin sikur gjithë artileria e tyre të ishte drejtuar kundër një objekti të vetëm. Ajo ishte e ndarë

në tri pjesë, andaj dhe ishte gjithmonë tri herë më e dobët. Kurse, në përgjithësi, kur gjermanët nuk kishin maqinat dhe topat, ishin njerëz krejt të zakonshëm, që dhe paticka e italianit i vriste, jo më «belxhiku» i grekut. Gjermanët pësuan humbjet e para. Dhe u trembën. U tërhoqën. Ata zunë rrugët dhe fshatrat anës së tyre, kurse partizanët majat e maleve dhe stanet e shkreta të gobenëve.

Shtabi partizan mendonte që të djelën e parë të shkurtit të fillonte kundërsulmin. Gjermanët, e sidomos, ata të liqtë e Xhaferrit kishin hapur zëra në krahinë, që partizanët u shuan nga uria maleve. Partizanët vërtet e kishin patur të vështirë, shumë vështirë, thanë që dhe shojet e opingave kishin zier e, megjithëse dhe shokë kishin vdekur nga të ftohtit dhe nga uria, prapëseprapë ata nuk ishin shuar. Fshatarët, sidomos gratë gjenin shtigje e mënyra për të çarë rrethimin e armikut, dhe u shpinin ç'mundnin djemve të malit. Sidoqoftë, kjo se si partizanët nuk u shojtën nga uria dhe të ftohtit atë janarin e vitit 1944, është histori më vete... Unë sot po tregoj për korierin Kio dhe shokun e tij, ndoshta ndonjëherë tjetër do të tregoj dhe për këtë..

* * *

... Era frynte e ftohtë. Acar. Ishte murlani i maleve. Era e ngrohtë e detit akoma nuk u frynte. Ata të dy ecnin më këtë anë të maleve, kurse deti ishte në anën tjetër. Deri te deti ishte shumë larg.

«Nuk e marr vesh pse na dërguan ne të dyve si korierë! — mendonte Kio. — Mirë unë, se korier jam e malet si jatak timin i kam, por ky orëziu nga Elbasani nuk e njeh hiç të keqen e maleve»

Ai tjetri, më i riu, kishte kërkuar vetë të shkonte korier në batalionin e bregut. Ai kishte dalë vullnetar. Kish ngulur këmbë. Ishte i ri komunist dhe shokët e batalionit të tij e patën vështirë të kundërshtonin. Kështu që ja paraqitën shtabit të brigadës si korier për këtë mision delikat. Ndoshta shokët e batalionit gabuan. Më mirë do ishte të dërgonin ndonjë lab — të paktën kështu mendonte Kio. Nga e folura, ai tjetri kuptohej që s'ishte lab, por ata të Shtabit të brigadës e panë djalë të ri dhe nuk e pyetën se ç'ish, lab apo elbasanas. Duheshin dy korierë. Dhe ja tek ishin dy korierë. Të dy të rinj, të dy të fortë. Bile, partizani më i ri kish lënë dhe mustaqe, kurse Kio jo. Andaj ai më i riu, elbasanlliu, dukej më i ngrysur, dhe më i fortë. Kështu dukej vërtet. Bash për këtë dhe Kio në fillim u gëzua, që i dhanë për shok rruge një njeri të tillë. Vetëm kur bënë dy apo tri orët e para të rrugës dhe e pa se si ai tjetri gulçonte tek çante borën e ngjittë malin, e kuptoi që ai për të parën herë po ecte në male, nëpër borë. Njeriu që nuk ka ecur kurrë në borë, dallohet lehtë. Zakonisht, ai çan borën si i dehur.

— Nga të kemi, o shok? — e kish pyetur Kio në atë kohë atë tjetrin.

— Nga ata të normales, — u përgjegj tjetri.

— Ç'normale? — pyeti Kio, që nuk kuptoi se ku e kish fjalën tjetri.

— Nga Elbasani.

— A, haa. Po!

Edhe Kio kish dëgjuar për ata djemtë e Elbasanit. Djem të zotë ishin paraqitur. Të gjithë partizanë kishin dalë. «Djalë trim duhet të jetë, — mendoi Kio, — por për korier nuk bëka.»

— Dil pas! — i tha Kio partizanit të ri.

Tjetri nuk kundërshtoi, por doli pas Kios. Ai kishte çarë dy apo tri orë borën dhe ishte lodhur.

... Dhe ja tashti, mbi tetë orë, borën po e çante Kio. «Keq do e kish po ta çante akoma,» — mendoi Kio për tjetrin dhe për borën. Bora tashti ishte kokërrtrashë, si kokërr orizi, ngjishej mirë dhe nuk ngjitej në opinga. Ndryshe, po të ngjitej, ashtu si disa orë më parë, këmbët do mbartnin dhe borën e do bëheshin gur të rënda.

— Kur mund ta arrijmë majën e Çikës? — pyeti partizani i ri.

— Ja dhe ca, xhan. Pa kur të arrijmë majën nuk mbetet më udhë. Këtë «xhan», megjithëse e dinte, që nuk i shkonte moshës së tij të re, Kio e përdorte shpesh, aqë sa nga kjo fjalë, a mbase dhe nga të tjerat, që ai i thoshte sikur të ishte ndonjë plak i moçëm shokët që kur doli partizan i thërrisnin «shoku plak». Dhe Kio nuk zemërohej për këtë.

— Si, s'na mbetet më rrugë? — pyeti pa e fshehur dot gëzimin partizani i ri.

— Hiç gjë nuk mbetet. Deti... — dhe Kio nuk vazhdoi më tej.

Për Kion maja e Çikës ishte gjithçka. Nga maja shihej deti dhe fshati i tij i lindjes. Rrëzë detit, në shpellat e Jalit, të cilat nga stereja nuk duken e

nga deti mezi shquhen, ishte strehuar batalion i bregut, ku duhej të shkonin Kio dhe ai tjetri. Ata të dy s'kishin as letër me vete as ndonjë shenjë tjetër. Njeri nga të dy duhej të arrinte, patjetër, i gjallë te batalioni i bregut dhe të çonte me gojë urdhërin e shtabit të brigadës: «Të dielën e parë të shkurtit të fillonin sulmin!» Vetëm kaq. Kështu që gjithë brigada, bashkë me ata të teritorialit, të dielën e parë të shkurtit, do të fillonin kundërofensivën dhe do t'u tregonin gjermanëve dhe mercenarëve se partizanët nuk ishin tharë e shuar si rigoni maleve.

Por që ky urdhër t'i shkonte batalionit, njeri nga të dy (natyrisht më mirë do ishte të dy) duhej, patjetër, të mbetej i gjallë. Ndaj dhe në shtab u kishin thënë që t'u bënin bisht përpjekjeve me armikun. Domethënë t'i mënjanoheshin, të mos takohehin me të dhe të mos hapnin zjarr kuturu. Në se detyroheshin të hapnin zjarr, njeri do luftonte dhe do mbante armikun, kurse tjetri do vazhdonte rrugën. Pastaj po të mundnin le të takoheshin prapë me njëri tjetrin. Kështu ishte urdhëri. Me çdo kusht batalioni duhej të dinte që të dielën e parë të shkurtit fillonte lufta e madhe.

Sot, që unë shkruaj tregimin, e di që atë ditë Shtabi i brigadës nisi në drejtim tjetër dhe dy korrierë të tjerë në batalionin e bregut, për çdo të papritur, duhej që në mos njëra palë, tjetra të arrinte në breg. Unë e di këtë sot, pas kaq vjetësh, veçse atë ditë as Kio as ai tjetri nuk e dinin që ishin nisur dhe shokë të tjerë, andej duhej të bënin të pamundurën dhe ta çonin urdhërin në batalion.

... Ata kishin kaluar qafën e Shëngjergjit. Ki-

shin kaptuar shpatin e brendshëm të Polickës dhe Boçkës. Kishin përpara Qorren e madhe dhe pastaj vinte Çika, maja e Çikës.

Kio i tha shokut: «Hiç gjë nuk na mbetet... Deti...» kështu do të ndodhte kur të arrinin në majën e Çikës. Poshtë, në këmbët e maleve shtrihej deti. Po veçse atyre, pas majës së Çikës, deri sa të mbërrinin në shpellat e Jolit, buzë detit, u mbeteshin akoma maja e Palikonjës, Mesimeri, valët e Bufit dhe Vranishtit, Gurra e Vunoit, Xgafa, Mjeglloshi dhe Brinja. Mbeteshin pra kaq shumë maja sa lodhesh vetëm duke i përmendur, jo më t'i hy-pësh.

Por kur Kio shihte detin dhe sytë i ngopeshin me det, kjo rrugë i dukej hiç gjë, shesh fare. Kur i frynte deti, atij i dukej sikur u frynte mëma, si dikur, kur ishte fëmijë, duarve të tija të mardhura. Kur i frynte deti, i dukej sikur ishte pranë zjarrit të vatrës. Kur i frynte deti, qoftë dhe me shqotë e tramundanë, atij i dukej sikur e ngrohte e i jepte fuqi gjithçka që ai shihte përreth, stereja dhe deti bashkë. Toka apo deti?

Kështu i dukej Kios dhe ndaj gjithë ato maja pas Çikës nuk i zinte fare në numur. Kurse ai tjetri, korieri i ri dëgjonte dhe kjo rrugë i dukej pa fund.

— Hiç gjë nuk mbetet! — përsëriti partizani tjetër me habi fjalët e Kios, dhe nuk besoi, që kjo rrugë e lodhshme, si çdo gjë tjetër në male, do merrte fund një herë.

Kio e ndjeu gëzimin e partizanit tjetër dhe përsëri nuk kuptonte pse kishte ardhur korier. Kjo borë trëmb dhe egërsirën, jo më njeriun —

1. Nuk kujtoja
mendoj Kio — dhe për vete harronte që ishte nje-
ri. Vehten ai nuk para e fuste në llogari për të ti-
lla punë, sepse malet për të ishin diçka fort e qar-
të, kurse për atë tjetrin ato duhej të ishin të nga-
tërruara, më keq se ato gërmat e abetares për K'on.

Kio kujtoi abetaren dhe iu duk vetja bashkë
me shokun tjetër si dy gërma të zeza, të murme,
në faqen e bardhë të abetares, në shpatin e mbu-
luar me borë të maleve.

Era frynte. Bora vazhdonte të binte dhe të
ngjishej e të kërciste nën këmbët e tyre si kokrra
orizi. Të dy ata ngjanin si krushq mes orizit të das-
mave.

— Pse erdhe korier ti? — pyeti për të parën
herë atë tjetrin. Kish kohë që e bluante në mëndje
këtë pyetje dhe, tashti që e bëri, e ndjeu veten më
të lehtë dhe filloi të ecë më shpejt. Ai tjetri e ndi-
qte pas, si fëmia i bindur babanë.

— Bëra keq? — tha tjetri.

— Jo. Po a nuk kish lebër ai batalioni juaj?
Pse erdhe ti?

— Kishte. Po unë dola vullnetar i pari. Mos
bëra gabim?

— Jo, more i uruar. Por malet duan njerëzit
e tyre. Pse duhej të dilje ti vullnetar i pari, nuk
kishte të tjerë?

— Unë ngula këmbë më shumë.

— Ngule këmbë më shumë. Pse?! — u çudit
Kio. — Sikur mua të më thoshin: a del vullnetar
për shkollë? Nuk do dilja. Dhe për kursin e të më-
suarit të shkronjave më detyroi komisar. Më urdhë-
roi dua të them. Pa të ish për mua, kurrë nuk dil-

ja vullnetar, e shkronjat për njëqind vjet nuk i mësoja. Kurse ti, pse ke ngulur këmbë kaq shumë, kur nuk njuh malet?

— ...Ju duk sikur tha diçka që nuk e kuptoi dot Kio. Dhe pastaj tjetri heshti.

— Apo mos kishe bërë ndonjë gabim përpara e deshe kështu të laje fajin?

— Jo. Unë ngula këmbë se ashtu duhej, — tha tjetri prerë. Dukej qartë që ai nuk donte ta vazhdonte më këtë bisedë.

— Mbase. Kushedi, mbase dhe kështu duhej. — Kios i erdhi keq që e ngau aq shumë. Në fund të fundit, ai tjetri në këtë rrugë të keqe megjithëse ishte për të parën herë, asnjëherë s'po ankohej.

— Por mos u mërzit në të thashë gjë, o xhan. Do ishte më mirë të ishte vendas, por sa për mua, njëlloj është. Ti je shok i mirë për derisa ke dalë në mal me ne. Aq më mirë që jemi të dy, se kjo rrugë zgjat ca shumë në dimër, e kur s'ke me kë këmben një llaf, të ze gjumi rrugës.

Ai tjetri nuk e dëgjoi fjalinë deri në fund, se nuk i linte era fjalët të arrinin të shkoqura tek ai. Atij i erdhi mirë që Kio nuk do ta ngiste më me pyetje, se ka disa gjëra, si rasti i tij që doli vullnetar, të cilat nuk mund të shpjegohen vetëm me fjalët e shkurtra «jo», «po», por duan pa tjetër shpjegime me detaje, që përveç atij nie të cilin kanë të bëjnë, të tjerëve ore u interesojnë pak, ose nuk u interesojnë fare.

... Pastaj ata heshtën. Ecën dhe heshtën. Bora nuk dëgjohej si kërciste nën këmbë. Frynte

erë. Ata ecnin kokëulur, që era me borë të mos i godiste në sy.

— Ndërrohem i bashkë tashti. Mjaft çave borën ti, — i tha tjetri Kios.

— Nuk jam lodhur, — tha Kio, — kur të lodhem, këmbehemi.

Pushkët dhe gjerdanët u rëndonin të dyve. Kio kishte dhe thikën e madhe, që ai e quante biçak, mbase nga që, në krahasim me sopatën apo sharrat e rënda, ajo thikë ishte e lehtë për të, tamam si biçak. Kishte dhe bombat. Dy bomba.

Ai tjetri kishte pushkën, fishekët dhe tri bomba. Kobure s'kishin as njëri as tjetri.

Kion, kur ecte, ngandonjëherë e pengonin dhe xhepat. Në njerin xhep ai kishte dhe një majë lapsi. Në tjetrin kishte dy feta bukë misri dhe një copë letër të zhubrosur të mbushur me gërmat e alfabetit. Komisari i kishte thënë të vazhdonte kursin kundër analfabetizmit në batalionin e bregut. Sa të ishte atje të mos humbiste kohën e të mos i harronte ato që mësoi në shtab të brigadës.

«Po ta vrasin gjermanët e t'i gjejnë në xhep këtë letër me shkronja, me siguri do ta marrin për shifër sekrete. Do t'u hapë punë atyre specialistëve të tyre alfabeti i shqipës». Kështu mendoi komisari. Ai deshi t'ja thoshte këtë Kios, por u pendua. Kio nuk dinte ç'ishte shifrazhi, paçka që ishte korieri më i mirë i brigadës. Partizanët nuk përdornin shifra sekrete, sepse as specialistë të tyre s'kishin. E shumta që ata përdornin mund të ishin disa shenja të veçanta, marifete, siç thosh Kio dhe parullën e luftës. Po këtë e dinte Kio.

Dy fetat e misrit ua kishin dhënë shokët një ditë më parë në darkë, kur ishin nisur. Aq bukë kishin patur. Tashti ishte mëngjez dhe të dy duhej t'i kishte marrë uria, por asnjeri nuk e kujtonte urinë. Vetë fjala uri, këto ditët e fundit kishte qënë për ta dhe për shokët armiku i tyre më i keq se gjermani, të cilin mund ta vrisje, se njeri ishte, kurse urinë nuk e vrisje dot as me plumb e as me bomba.

— A do të hash? — e pyeti Kio tjetrin.

— Po ti? — pyeti tjetri.

— Ulu! — tha Kio.

Megjithëse nuk donte të hante, e ndjeu që ai tjetri kishte uri, dhe u ul.

Kio nxori nga xhepi njerën fetë të misërt. Dhe kur dora i kapi bukën e thatë, gishtërinjtë prekën letrën e zhubrosur me gërma, që po shuhe-shin nga fërkimi me bezen e xhepit dhe u kujtua që do të kishte përsëri punë me të. Ndonjë vajzë tjetër partizane do lodhej përsëri me të. Dhe qeshi me vete, se mendoi që të paktën vullnetar nuk do dilte. Po ky pse doli vullnetar? — mendoi përsëri Kio për shokun tjetër. Pse?

Fetën e bukës së misrit e ndau në mes. Copën më të madhe, sa një kokër dardhë vjeshtake, të verdhë fare, ja dha tjetrit, kurse për vete mbajti copën e vogël, sa një koqe gorricë.

— Ha! Të na bëjë mirë! — tha Kio.

— Ti more fare pak për vete — tha tjetri, duke e ndarë copën e tij sa një dardhë vjeshtake rish-tazi.

— Haje, more i uruar, se mua më del dhe kjo. Pastaj në xhep kam dhe fetën tjetër, që do ta ndajmë kur të kaptojmë majën e Çikës.

— Dhe atë kështu ke për ta ndarë, — tha i bindur partizani i ri.

— Ha, o xhan, ha! C'ke ti se si e ndaj unë? Mua më del e më tepëron.

— Jo, — tha tjetri dhe e la copën e misërt, sa gjysma e dardhës mbi gjurin e Kios. Gjuri ishte i madh dhe i zi, copa e misërt e verdhë dhe e vocërr. Dukej sikur midis borës pa fund të bardhë, të bardhë, si qefin të vdekurish, mu atje mbi gju kishte mbirë një lule e verdhë. Trëndelinë, — mendoi Kio, — dhe gjymtyrët ju zbutën sikur nuk ishte në borë, por në pranverë, midis erës së çajit dhe të trëndelinave.

Kio e pa që ai tjetri e la copën e bukës mbi gju dhe nuk donte ta merrte më. Ai priti që ai tjetri ta merrte dhe, kur u bind që priste kot, e mori copën e bukës dhe e futi përsëri në xhepin e madh pranë letrës që po i shuheshin shkronjat dhe gjuri mbeti i zi, si kishte qenë, pa lulen e verdhë. Dhe përsëri Kio ju ashpëruan gjymtyrët.

— E hamë pastaj, — tha Kio, dhe vazhdoi të përtypte me mundim copën e bukës, që kishte ngri-rë e ishte bërë gur.

Ata ishin ulur mbi borë dhe ai tjetri lëvizi këmbët. Mbase pati të ftohët, a ndoshta dhe nuk ishte mësuar të rrinte këmbëkryq dhe ju mpinë këmbët, por kur i lëvizi, Kio pa diçka që i tërhoqi vëmëndjen menjëherë. Ishte diçka e kuqe, bash atje ku disa çaste më parë kishin qenë këmbët. Diçka e kuqe në borën e bardhë. Kio fshiu sytë me dorën e madhe dhe përsëri, atje ku kishin qenë këmbët e atij tjetrit, pa diçka të kuqe në borë. Gjak! — mendoi Kio.

— Hiqe opingën! — urdhëroi Kio atë tjetrin. Ai deshi të sigurohej për atë njollë të kuqe në borën e bardhë. Gjak?

— Ç'e do? — pyeti tjetri.

— Hiqe!

Ai e hoqi dhe Kio pa që shollët e opingës ishin ngrënë në taban, kurse nën gishtat nuk kishte më shollë. Kio shikonte gjakun në borë, kurse në opingë ai nuk dallohej mirë. Gjaku dhe opinga kishin gati një ngjyrë.

— Qënke gomar fare, o njeri, — tha Kio. — Pse nuk thua që ti je zbathur?

— Do të jenë grisur tashti, — tha tjetri, — kur u nisëm, ato akoma mbaheshin.

Ai mund t'i përgjigjej Kios më rëndë: t'i thoshte, për shembull, «Ç'ke që bërtet kot? Se mos gjej dot opinga të tjera këtu! Ç'rëndësi ka të të them ty për këmbët e zbathura, kur ti nuk ke se ku gjen tashti opinga. Apo jo?»

— Pse gënjen? Ti i ke patur të çjerra me kohë. Çudi si nuk i vura re në fillim të udhës. Je nisur si për dasëm, levend, fare.

— Ahere nuk pikonin gjak, — tha tjetri i qetë. Se në fakt dhe sikur të tregonte për opingat e grisura, qysh para se të nisej, prapëseprapë opinga të tepërta intendentit s'kishte, gjëja më e zakonshme do ishte t'ja merrte një shoku tjetër. Por në këtë dimër shokët kudo e kishin keq me të ftohtin.

— Hiqe dhe tjetrën! — tha Kio me inat.

— Çfarë?

— Hiqi të dyja opingat, thashë!

— Ç'i do? — tha tjetri.

— Hiqi! — urdhëroi përsëri Kio.

Dhe ai i hoqi. Dhe Kio hoqi opingat e tij. I ma-
ti me ato të tjetrit dhe, si e pa që të tijat ishin më
të mëdha, u gëzua dhe i tha:

— Merri e mbathi këto! — duke i lëshuar në
duar atij tjetrit opingat e veta që ishin akoma të
forta dhe nuk kallnin ujë.

— Po ti? — pyeti ai tjetri.

Dhe ai tjetri kishte parë që opingat e veta ishin
më të vogla se të Kios. Ç'do të mbathte Kio, po t'i
merrte ai tjetri të tijat.

— Bëj dhe pa to, — tha Kio.

— Nuk i mbath, — tha tjetri

— Mbathi, more, të them!

— Nuk i mbath. Pse, ti ç'je që të ecësh zba-
thur? Nuk je njeri?

— Njeri jam, po jam mësuar të eci zbathur.
Mbathi! — urdhëroi Kio vrazhdët. — Mos bëj na-
ze si gratë e liga.

— Nuk i mbath, — tha tjetri me inat, ndoshta
se dhe krahasimi me gratë nuk i pëlqeu fare.

— Mbathi, xhan! — tha Kio, sikur tashti nuk
fliste më me atë tjetrin, shokun, por me vëllanë e
tij më të voglin, — mbathi, xhan, dëgjomë mua.
Unë kam bërë dhe bëj edhe pa to! — Dhe e pa atë
tjetrin në sy. Dhe ai tjetri nuk e uli kokën, por po
ashtu e pa Kion drejt në sy. Shikimet e tyre u tref-
tën bashkë dhe Kio u lehtësua. Kishte diçka shumë
fëminore në sytë e tjetrit, që e bëri Kion të zbutet
shumë e të besojë që ai tjetri nuk do ta zgjatte më
këtë histori opingash.

Ai mund ta urdhëronte. Ai ishte komandanti i
të dyve dhe shumë lehtë mund ta urdhëronte. Por
urdhëri nuk kish kuptim këtu: Ai tjetri ishte djalë
i mirë dhe me sedër të vërtetë. Kio u çudit: si ki-

shte ecur ai ashtu zbathur? Sa kishte ecur vallë? Sa orë? Vetja nuk e çudiste, që do të ecte zbathur. As nuk gënjente kur thoshte që ishte mësuar. Deri pesëmbëdhjetë vjeç ai kish ecur zbathur, me paçe, maleve. Vërtet. Por jo në borë. Bora të mavijos mîshin dhe të derdh gjakun...

— Mbathi, xhan! Dëgjomë mua, — tha përsëri Kio. — Jam mësuar unë pa opinga.

Dhe ai tjetri filloi t'i mbathte. Në sytë e tij diçka po tretej. Kios ju dukën si pika lot. Por mund të ishte dhe ndonjë flokëz bore që i kish rënë në sy dhe tashti shkrihej e varej drejt mustaqeve të tij të buta. Kio ktheu kokën në anën tjetër. Ai tjetri, i mbathi. Opingat i vinin të mëdha, por këmbën ja mbanin ngrohtë. Pastaj i hoqi prapë. Dukej se diçka ju kujtua. Zbathi opingat, hoqi dhe çorapet e tij të leshta, të çjerra e të ngrëna në thundër e tek gishtërinjtë.

— Ç'bën ashtu? — pyeti Kio, të cilit i dogji kjo zbathje e çorapeve.

— Merri! — tha tjetri, duke i mbajtur çorapet e grisura mbi pëllëmbën e dorës. Çorapet ruanin akoma ojnatin dhe bukurinë e dikurshme. Dukej që ato i kishin punuar duar të dhëmshura nënash...

Kio nuk i zgjati duart të merrte çorapet që dikur kishin qenë të bukura. Ai që kur i hoqi tjetri ato, e ndjeu që do të ndodhte kështu, prandaj dhe i dogji. Atij nuk i pëlqente ky këmbim, sepse ishte i bindur që ai tjetri kishte nevojë dhe për opingat, dhe për çorapet, kurse vetë bënte, po more, bënte edhe pa to.

— Merri! Unë me këto opingat e tua mund të shkoj dhe në Elbasan, kurse ti vetëm me një palë çorape nuk ecën dot.

Çorapet rrinin të varura në dorën e tij dhe kundërmonin erë djersë. Por Kios era e djersës nuk i bënte përshtypje, këmbëve të tij shpesh u vinte era shëllirë nga djersa...

— Nuk i marr! — tha Kio. — Kjo s'ka kuptim fare...

— Merri! — Dhe në sytë e tjetrit, Kio pa përsëri diçka të ndritshme, të çuditshme, që nuk dukej më si flokëz bore dhe që e bëri Kion të pulisë qepallat me nervovizëm dhe të lëpijë buzët. Kio ktheu kokën në anë tjetër. Se e ndjeu, që sytë ju ngrohën edhe atij nga ajo diçka e papërcaktuar, e tillë, që padyshim nuk ishte flokëz bore...

— Mirë, belbëzoi Kio dhe nuk i la më çorapet të rrinin varur në dorën e tjetrit. I mbathi. Ato i rrinin të vogla dhe të ngushta, por këmbën ja shtrëngonin mirë.

— Shkojmë! — tha tjetri.

— Ecim! — tha Kio.

Dhe u nisën. Kio pas dhe ai tjetri përpara.

* * *

Bora kish pushuar së rëni. Por në male shpesh ndodh kështu. Bora pushon dhe pastaj, fare papritur, fillon e bie përsëri. Bora kishte pushuar, por ngjitja në mal bëhej më e vështirë. Sa më shumë i afroreshin majës së Çikës, aq më e vështirë bëhej ngjitja. Ajri i ftohtë, i ngrirë u hynte në gojë, në hundë, në mushkëri dhe u merrte frymën. Kio përpiqej të ngopte mushkëritë me ajër vetëm me anë të hundës, gojën e mbante mbyllur. Kurse ai tjetri nuk ngopej dot. Ecte me gojë hapur dhe gulçonte. Kish zberthyer edhe bluzën dhe gjoksin

e njomë (akoma nuk i kish dalë qimja e zezë) ja rrihte era e ftohtë. Atij i dukej sikur edhe me porret e gjoksit merrte frymë.

Ata ecnin dhe heshtnin. Jo se s'kishin ç'të thoshin më, por se era i pengonte fjalët dhe i shpërndante zërat si donte ajo dhe ata nuk kishin më fuqi të thërrisnin, se vetëm kështu mund të dëgjohej shoku. Rruga i kish lodhur të dy. Por më shumë atë tjetrin, partizanin e ri, me mustaqe të buta, gati si të rreme.

Kio përsëri çante borën i pari. Kurse ai tjetri deri para pak kohe dallonte gjurmët e lëna në borë të këmbëve të Kios. Ato i dukeshin jo si gjurmë njerëzish, por si të diçkaje të panjohur, ndoshta si gjurmët e putrave të ariut. Por ai as ari nuk kishte parë, që ta dinte se si i kishin putrat.

Këmbët e Kios nuk rridhnin gjak akoma. Dhe herë pas here atë tjetrin e ngiste vetëm një mendim: kur do të fillonin këmbët e Kios të rridhnin gjak. Atë e vriste ndërgjegja, që kishte pranuar, (pa ç'ka se gati me detyrim) të merrte opingat e shokut dhe i dukej se kur të fillonin t'i rridhnin gjak këmbët Kios, do t'ja kthente përsëri opingat. Të paktën kur t'i rridhnin këmbët gjak Kios, s'kishte se si të kundërshtonte. Ahere do ishte njësoj për të dy. Kështu mendonte partizani tjetër. Por deri pak përpara këmbët e Kios linin mbi borë vetëm gjurmën e bardhë, pa karafilat e kuq. Kur filluan t'i pikonin gjak këmbët partizanit të ri, atij vetë i dukej sikur pas hidhte karafila të kuq. «Çfarë hidhte ajo vajza në përrallën e vëllezërve Grim në çdo hap të rrugës që të mos humbiste: gurë apo grurë? Po të hidhte grurë do t'i hanin zogjtë, duhet të ketë hedhur guralecë, kurse unë hedh karafila të kuq.

Asnjë nuk i ha dot këta karafila; vetëm se i tret bora shpejt».

Por Kio nuk hidhte karafila. Para pak kohe, kur akoma nuk ishte errur, ai nuk dalloj gjë në gjurmët e Kios, kurse tashti kish ardhur mbrëmja. Mbrëmja e dytë e udhëtimit të tyre të gjatë dhe nuk shquheshin më gjurmët në borë. Dhe as karafilat e kuq ... as pikat e gjakut.

— Sa të arrijmë te valët — tha Kio, duke i ndërprerë mendimet, partizanit tjetër. — Atje janë stanet e lëna të çobenëve.

Kaq tha Kio. Ai tjetri dëgjoi valet — stanet — çobenët. Ç'donte të thoshte Kio me këtë? — mendoi ai tjetri. Stanet janë të shkretë. Ç'na pret neve atje? Shokët tanë janë në buzë të detit, tek shpellat, ç'na duhen neve stanet e shkretë? — Ai u afrua më pranë Kios, që të mund të dëgjonte më shkoqur fjalët. Era nuk ishte aq e fuqishme, por prapë të pengonte dhe fjalët i shpërndante si zogjtë e trembur nga pushka.

— Sonte nuk udhëtojmë dot më natën. Yjet nuk duken. — tha Kio.

— As hëna nuk duket! — tha tjetri.

— As hëna s'duket, — përsëriti Kio. — Kjo do të thotë që do të bjerë prapë borë dhe do të ketë stuhi të fortë.

— Ka rrezik të humbasim rrugën? — pyeti tjetri fare thjeshtë, sikur kjo të ishte gjëja më normale në këtë udhëtim.

— Jo. Rrugën unë e njoh dhe natën. Por ka rrezik të na rrëmbejë stuhia ose të na çajné ujqrit.

— Ujqrit? — pyeti tjetri fort. Në mënyrën se si pyeti nuk ndihej frika, por habia. Ai s'kishte parë kurrë ujq.

— Ujqrit! — përsëriti Kio me zë të lartë, që ai tjetri ta dëgjonte mirë.

— Ujku mjergull do, — tha tjetri, duke përsëritur instinktivisht, si për vete, fjalën e urtë të dëgjuar kushedi sa herë dhe që në këtë rast ju duk se kishte shumë kuptim.

— Po. Mjergull dhe natë si kjo që po vjen. Egërsirat janë tërbuar nga uria. Dimri i sivjetshëm tërbon dhe gurin e drurin... — fjalët e tjera i mori era.

Ata kishin ngjitur pllajën në majën e malit. Vetë majën e Çikës e kishin lënë pas krahëve. Por deti nuk dukej, se ishte natë pa yje e pa hënë. Kurrizores së malit ishin valet. Në valet ishin stanet. Kurse në stanet, zakonisht, ishin çobenët. Por këtë dimër atje s'kish çobenë. Lufta i kish trembur çobenët. Më të mirët e tyre ishin me partizanët, të tjerët kishin zbritur fshatrave dhe prisnin kur të mbaronte lufta... kurse bagëtia ishin bërë preja e të gjithëve.

...Bora binte përsëri dhe atë rrugë që në mot të mirë Kio e bënte për dy orë, tashti i duheshin tetë orë; atë që e bënte për një ditë e një natë, tashti i duheshin katër ditë e katër net. Binte borë, por ai e dinte që dhe pak dhe do të shlodheshin në kasollet e shkreta të staneve. Yje s'kish, hënë s'kish, por ai e dinte që dhe pak dhe ai do të ngrohej në stanet e lëna të çobenëve, në zjarrin e bajgave të mushkave.

Çobenët i mblidhnin bajgat në behar e i thasin për dimër. Se këtej në këto maja malesh nuk ka jo pyje, por as shkurre. Pak më poshtë ka shkurre dhe pyje shumë, por atje ku janë valet

asgjë nuk ka që të bëjë hije, përveç shkëmbenjve. Po, këtë ai e dinte mirë... Dhe kujtoi netët e beharit në male, kur me të jatin, si lodheshin, duke prerë dërrasa për qereste faqeve të malit, ngjiteshin lart në majë, te valet, ku ishin çobenët dhe ku në një çanak me dhallë, të dukej se të falnin gjithë botën. Se vërtet në majë të maleve, në valet, dru e shkurre nuk ka, por rritet bari sa një lloj njeriu, e i majm ato të zeza dele, sa i bën të mos i ngresh dot... Sa shekuj kanë kaluar qysh ahëre?...

— Ou! — thirri ai tjetri në mënyrë të tmerrshme, me një zë të këputur në mes.

Kio i preu kujtimet e beharit dhe i zhyti shpejt diku thellë në subkoshiencën e tij dhe vetëm për një çast mendoi se ai tjetri shkau në borë, sepse dhe të donte të mendonte gjë tjetër nuk pati më kohë. Diçka e shpejtë, e rrëmbyeshme, e uritur dhe e egër ju sul dhe atij në shpinë, drejt qafës. Ai e ndjeu, e kuptoi, vetëtimthi, jashtë vetëdijës sikur dikush i takoi instinktin e vetëmbrojtjes, që kjo gjë e shpejtë dhe e uritur ishin ujqit. Kio uli kokën dhe shpinën dhe u rrëzua bashkë me ujkun. Ujku ishte i lehtë, ndoshta dhe ndaj ishte aq i shpejtë. Ishte i uritur dhe nuk peshonte fare. Gati gati ai ishte sa një kone fushe. Kur u shtri dhe u përpoq të nxirrte thikën, Kio e kuptoi se sa vështirë e kish ai tjetri, të luftonte me ujqit. Ata ishin sulur befaz nga pas.

— Qëllo! — urdhëroi Kio tjetrin tek përleshje me ujkun. Por pastaj e mori me mend që ky urdhër nuk kish kuptim. Ai tjetri nuk kish kobure, kurse me pushkë nuk qëllohej dot. Ishin ngjitur trup me trup ujqit dhe njerëzit. Aq më pak me

bomba. Çfarëdo bombe të hidhje, ajo do vriste edhe njerëzit vetë, jo vetëm ujqrit. Ai tjetri bërtiste nga dhimbja dhe, me grushte, përpiqej t'u shpëtonte kafshimeve të ulkonjës. Kio kishte punë me ujkun. Pa e vrarë ujkun, nuk kishte se qysh ta ndihmonte tjetrin.

— Zëre nga veshët, si qentë! — urdhëroi përsëri Kio.

Por ai tjetri nuk dëgjonte më urdhëra. Kurse vetë Kio e kish shtrënguar ujkun në qafë me duar dhe po e mbyste Ujku uluriu sa tmerroi këlyshët e tij dhe malet. Dhe pastaj gulçoi thellë-thellë dhe nuk u dëgjua më. Dëgjohej vetëm ulkonja që luftonte për jetë a vdekje me partizanin tjetër dhe rënkimet e partizanit. Pastaj Kio ndjeu që në duart i peshonte trupi pa jetë i ujkut. Hapi gishtërinjtë, ujku mbylli sytë e xhamtë, gati artificialë dhe ra në këmbët e tij. Këlyshët, tre këlyshë të vegjël, u shtrinë pranë barkut të babait të tyre. Ata nuk e kuptonin që ai s'ishte më babai i tyre.

Kio kërceu shpejt drejt shokut, nxori thikën nga milli dhe e goditi ulkonjën rëndë, si druvar, atje ku bashkohet qafa me kokën. Ajo nuk ulëriu fare. Nuk u dëgjua më. Dhe në male tashti dëgjoheshin vetëm rënkimet e partizanit tjetër, vajtimi i këlyshëve, bora që binte krejt indiferente për gjithë ato që ndodhën dhe të sharat e mallkimet e Kios.

Kio e ngriti shokun dhe pa që ulkonja e kish kafshuar e ndukur në shpatull thellë deri në kockë. «Ka qenë e uritur fort ulkonja!» Ajo kishte luftuar e tërbuar. Donte ushqim për vete dhe, sidomos, për këlyshët e saj të urët. Ndaj dhe plagët

në trupin e partizanit tjetër ishin më të mëdha e më të përgjakura se ato të Kios.

Kio hoqi bluzën e tij dhe ja veshi shokut. Ai dridhej nga të ftohtit apo nga kafshimet e ulkonjës? Kio nuk kuptonte dot gjë. Shoku ishte i verdhë si ajo copa e bukës së misrit që kishte në xhep. Pastaj ngriti pushkën e shokut dhe e vuri pranë të tijës. U ul e kapi shokun nën sqetull dhe me mundim e ngriti në krahët e tij. Dhe u nis me të ngarkuar. Tjetri rënkonte thellë dhe të pikonte në zemër dhimbja e tij. Këlyshët vajtonin dhe njeri prej tyre i shoqëroi ata të dy, Kion dhe atë tjetrin, një copë rrugë. — Do të jetë tërbuar, mendoi Kio për këlyshin.

— Duro, vëlla! — i tha Kio partizanit që mbante më kurriz.

Ai tjetri i foli, por nuk i mbajti rënkimet.

Kio ecte me shokun e plagosur në kurriz dhe tashti kishte vetëm një qëllim: të arrinte te kasollet e staneve, të ndizte me bajgat e mushkave zjarrin. Të ngrohte shokun dhe t'i lidhte me ç'të mundte plagët. Me çdo mënyrë duhej që shoku ta merrte veten shpejt. Atij nuk i shkonte fare ndërmënd që shoku i tij mund të vdiste rrugës, ndoshta dhe mbi kurriz. Kurrsesi nuk mund të ndodhte kjo. Vdekja për të kishte vetëm një vënd, atë të luftës me gjermanin.

Ai ecte me atë tjetrin në krahë dhe pak nga pak filloi të ndjente dhimbjen e plagës së vet. Ujku nuk ishte ulkonjë, por prapë e kish kafshuar keq në llërën e dorës së majtë. Dhe tashti që mbante shokun dora e majtë i mpihej fare, sikur e kish të ngrirë në akull.

— Duro, xhan dhe ca! — tha prapë Kio. Dhe tashti ju duk se këto fjalë ja tha jo vetëm shokut të tij, por edhe vetes.

* * *

Kio rrinte pranë bajgave që po shuheshin. Kasollja ishte fare pa jetë. Katër muret e zez, të nxirë nga bloza dhe këmbët e atij tjetrit që zbardhnin si borë. Opingat në ato këmbë pa gjak e jetë mezi rrinin. Ato ishin shumë të mëdha për ato këmbë.

«Çfarë tha ai para se të vdiste? — mendoi Kio — «Bëj të fala...» Kujt t'i bëj të fala? Nënës? Shokëve? Motrës? Vëllait? Gruas?? Kujt t'i bëj të fala?

Kio i lëmonte flokët shokut. Shokut që tashti kishte vdekur. Shoku nuk përgjigjej. «Kujt t'i bëj të fala»?...

Kio me mundim të madh kish çarë borën, erën dhe natën pa yje e pa hënë dhe, më në fund, kish arritur në stanet e shkretë. Kio kish ndezur zjarrin me bajga që të ngrohej shoku, i cili dridhej herë pas here. Dhe pikërisht ahëre kur ai u frynte bajgave që të bëhej më i madh zjarri e të mos mbërdhinte shoku, ai tjetri kishte vdekur. Kishte humbur shumë gjak dhe fuqitë e kishin lënë. Rruga e lodhëshme. Uria. Gjaku i humbur gjatë rrugës dhe pastaj plagët e ulkonjës e kishin cfilitur. S'kish faj që kish vdekur — mendoi Kio. S'kish faj. Kushdo mund të vdiste kështu, veçse ishte shumë i ri. Tashti të vdekur, mustaqet e buta nuk e tregonin më të madh nga ç'kish qenë. Kushdo mund të vdiste veçse ishte fort i ri.

Ai e ndjeu që po gdhiehej. Jashtë nuk frynte më erë. Drita e ditës po e mbyste dritën e kongjijve të bajgave. Brënda në kasolle ishte ngrohtë. Kio kishte vapë, kurse ai tjetri kishte mbyllur sytë dhe flinte. Për atë tjetrin tashti s'kishte më as ftohtë as ngrohtë, as ditë as natë. Për të gjithëka ishte njëlloj dhe pa fund... Kurse Kios i duhej të ikte. E prisnin shokët. Ndërsa ai tjetri nuk ikte dot. Kush vallë e priste atë? Kujt t'i bëj të fala?

Ai mendoi një çast ta linte shokun në kasolle pranë kongjijve që po shuheshin: Atje bënte ngrohtë. Të paktën i vdekur le të kish ngrohtë mendoi Kio. Por u kujtua që, kështu pa varrosur, trupi prishej kollaj: Më mirë është ta varros në borë: kur të vijnë shokët do ta gjejnë si të gjallë dhe pastaj le ta varrosin me nderime, si trimat... Ai doli përjashta. Drita dhe bora akoma nuk t'i verbonin sytë. Ai nxori thikën dhe filloi të çante borën e ngrirë akull. Bora e akullit çahet me vësh-tirësi. Copat e akullta hidheshin si cefla gurësh dhe sa herë godiste, Kio mbyllte sytë instinkti-visht. Dhe ahëre kujtonte përsëri, si një lejtmotiv të vjetër, — kujt t'i bëj të fala? Sa herë e kish goditur me thikë borën e ngrirë? Sa herë e kish larë gjakun e ujqërve nga thika me borën e akullit? Sa herë? Dhe sa herë e kish pyetur veten kur godiste me thikë akullin — kujt t'i bëj të fala?

Ai hapi gropën. U lodh. Tashti duhej duhani. Por ai nuk e pinte duhanin. Vërtet kur kish qenë i vogël, babai ja jepte shpesh t'ja ndizte cigaren në zjarr por ai nuk e kish mësuar. Vetëm ja ndizte cigaren babait dhe kaq, asgjë më tepër. Kurse tashti i vajti mëndja që duhej duhani. Duhan nuk

kish. As ai tjetri që tashti do zinte vend këtu në këtë gropë, midis akullit dhe borës; nuk pinte duhan. Të paktën asnjëherë nuk e ndezi sa udhëtoi bashkë me Kion. Ndoshta ai dhe e pinte por s'kishte duhan.

Kio e mori shokun pranë shtratit të bardhë. E futi në akull dhe e mbuloi me borë. Ai ndenji pranë shokut të mbuluar me borë dhe sytë ju mbushën me lot. Bora filloi të binte përsëri. Kështu e kanë malet në dimër. Janë shumë të pabesë dhe moti i gënjeshtërt. Bora binte dhe pas pak varri me borë i shokut nuk do të dallohej më. Ai ndaj e varrosi mu këtu te dera e kasolles, që të mos e ngatërronte e të mos e harronte vendin. Bora binte me flokë të mëdha, të mëdha dhe të lehta si gjethe plepash dhe Kio u kujtua përsëri. — Pse doli vullnetar i pari, ky djalë, që nuk njihete as malet, as ujërit, as... çfarë as? Kë? Kujt t'i bëj të fala?

Dhe Kio i la lotët të rridhnin e të binin mbi borën e shokut dhe bora e shokut, atje ku binin lotët shkrihej si qiri i djegur. Pastaj u ngrit dhe iku. Iku dhe u nis drejt majave të tjera. Drejt shokëve... Poshtë, tutje, dukej, më në fund, deti... kurse pranë zbardhnin kurrizet e maleve si kuaj të lodhur dasmash..

* * *

Ai ecte tashti i vetmuar dhe kishte vetëm një kujdes, të mos binte në përpjekje me gjermanët. Po të vdiste dhe ai, pa u takuar me shokët, ahëre kush do t'u thoshte për të dielën e parë të shkurtit që do të niste lufta?

Tashti mendjen e kish të rënduar me mendime të çuditshme, kurse trupin akoma më të rëndë. Plagën e dorës së majtë e kish lidhur me mëngën e këmishës te qafa dhe e mbante varur. Në sup i rëndonte tashti, veç pushkës së tij dhe ajo tjetra, kurse në brez bombat e veta dhe bombat e atij, që kish dalë vullnetar i pari..

Me çdo kusht duhet t'u shpëtoj gjermanëve. Ai hapte sytë fort. Por nga bardhësia e borës, bebet e syve ishin zmadhuar shumë, si ato të të verbërve. Ai i trembej kësaj lodhjeje të syve, sepse kishte çaste që atij i merreshin mendtë dhe gjithçka përpara i ngatërrohej. Ashtu siç ngatërrohen pasqyrimet e njerëzve, pemëve, deleve, kujave në llërën e ujit kur hedhin gurë fëmija. Dhe ndaj herë-herë donte të ecte me sy mbyllur. Por ai zbriste drejt detit... drejt detit të bukur para të cilit nuk i mbyll dot sytë asnjë qenie e gjallë, jo më njeriu.

Përpara se të shkonte në breg, do kalonte fshatrat e bregut, fshatin e tij të lindjes dhe atje ishin gjermanët. Por ai dinte që gjermanët ditën (jo natën), ngandonjëherë, ngjiteshin dhe lart faqeve të malit. Ngjiteshin... Por jo kaq lart, sa sytë t'i mbante hapur nga frika e tyre. Jo, jo, përpara ishte deti pa anë e fund.

...Atij sytë i ishin lodhur shumë. Sikur të mundte të shkiste mbi borë symbyllur e të zbriste deri te bokërrimat, ku nuk kish më borë. Sikur...! Sytë i ishin buhavitur e mavijosur më keq se kokrrat e ullinjve që bien në tokë gjatë marsit. Ai kishte zbritur faqes së malit dhe tashti ngatërronte trungjet e rralla, mretet apo perraret e vetmuara me njerëzit. Pemët e vetmuara i duke-

shin si shokët, si pararoja partizane, sepse kaq lart në male vetëm shokët mund të ngjiteshin. Gjermanët zakonisht nuk ngjiteshin deri atje. Vetëm rrallë, fort rrallë... Pemët i dukeshin si shokë, dhe ai herë-herë kumbisej mbi trungjet e hollë të tyre dhe, ashtu i mbështetur në to si në gjunjët e shokëve, gati e zinte gjumi. Nën kurorën e tyre të vogël nuk binte borë. Por gjumi tashti ishte armik për të, si dhe shumë armiq të tjerë.

...Ai po afrohej buzës së Xgafës. Në Xgafë ishin burimet. Në behar, kur akoma s'kish filluar lufta, tek ngjiteshin maleve, këtu bëhej pushimi i vetëm për ata që ngjiteshin në Gurrë, tek valet. Këtu donte të pushonte pak dhe ai tashti. Fare pak... Në Xgafë nuk të zë era. Më një anë ngrihet faqja e malit thikë e pas saj buza e gremisur (kjo faqe pret erën e maleve) dhe në anën tjetër burimet, shtegu i rrugës malore, që e gudulisin erërat e detit.

Kio po u afrohej burimeve. Në burimet, uji në dimër është i ngrohtë. Kështu duket në krahasim me borën. Ai nuk kishte etje, por donte të ngrohete duart, duart engrira me ujin e burimeve. Rreth e përçark burimeve borë dhe akull. Nëpër kornizat e shpellave të vogla të buzës së Xgafës vareshin stalagtitet e akullta. Kurse uji i burimeve të Xgafës trette borën, atje ku kalonte. Kio mendonte për ujin e për shokun, që la në mes të borës në valet e malit. — Kujt t'i bëj të fala? Nënës? Motrës? Shokëve? Vëllait? Gruas? Kujt?...

— Alt! — u dëgjua në qetësinë e maleve.

Sa kish ecur kështu me sy të mbyllur? Sa kish ecur kështu deri sa në veshët e tij u përplas

e rëndë, e egër, e shurdhër kjo fjalë e huaj — alt?!

Kio hapi sytë dhe pa nja njëqind metra larg vetes hije të zeza... Kaq shumë të jenë shtuar pemët këtë dimër? Zakonisht, këtu në Xgafë janë vetëm disa trungje të shkurtër, përraresh. Thua përraret u shtuan kaq shumë?

— Alt!

Po, këta nuk ishin hije pemësh. Ai i hapi sytë mirë, më mirë. Ai sikur e përqëndroi më qartë shikimin dhe dalloi, që hijet nuk ishin as përrare, as mrete, as frashër, por njerëz të zinj. Të veshur e të mbathur gjithë në të zeza (pse i dukeshin të zinj kështu?) dhe me një të folur tjetër nga njerëzit e kësaj toke, të këtyre maleve. Jo këta nuk ishin shokët e tij, partizanët. Ata edhe nga kjo fjalë e vetme i dalloje që nuk ishin shokët.

— Alt!

Dhe Kio e kuptoi nga plumbat që i fluturuan mbi kokë se përpara tij, njëqind apo dyqind hapa, ishin gjermanët. Ishin ata, me të cilët ai sot nuk duhej të takohej. Sot dhe ujkun mund ta takonte dhe me ariun mund të ndeshej dhe dreqin me të birin mund ta qëllonte, por këta jo. Këta ishin njerëz të zinj (pse të zinj?), që çdo herë tjetër do të donte t'i dilnin në shteg dhe t'i vinte në shënjestër të pushkës, por sot, jo! Sot ai duhej të çonte lajmin se «të dielën e parë të shkurtit fillon sulmi». Po të vritej Kio, kush do ta çonte këtë lajm? Ai tjetri që kish mbetur në borën e akullt të valeve? Kush do ta çonte lajmin po të mbetej dhe ai këtu midis borës së bardhë dhe njerëzve të zinj? Kush? Marika?!

— Alt!

Plumbat e përcëlluan borën para këmbëve të tij.

Dhe Kio s'pati kohë të mendonte më shumë.

Ai filloi të vrapojë dhe gjermanët mbetën të hutuar. Kjo që bënte ai ishte krejt e papritur për ta. Dhe më shumë se çdo gjë ushtarin gjerman e hutonin të papriturat. Në të tilla raste ai e humbiste toruan dhe për një çast hutohej fare. Ata u habitën me të. Ku vraponte ai kështu? — Drejt tyre?! Ku shkonte ai? — Lereni! — tha njeri nga gjermanët, — se është i çmendur nga uria. Dhe ata e lanë të vraponte drejt tyre, sa mund të vraponte një njeri me këmbë të zbathura dhe me plagë në trup.

Zogu po u binte vetë në dorë.

Ai vraponte me dorën e majtë të lidhur dhe me të dy pushkët në krahë.

Ç'do të bënte kështu? Veçse Kio nuk u dha kohë gjermanëve të bluanin e t'u gjenin përgjigje pyetjeve të tyre, se në vrapim e sipër hoqi një-rën bombë nga mezi dhe e vërtiti drejt tyre. Gjermanët u shtrinë dhe ai u hodh pastaj në buzën e greminës, në humnerë. Në atë buzë ku ishin rrëzuar e shembur gra të ngarkuara me shkarpa e s'ishin gjendur më kurrë, as të vdekura.

Kur u ngrit toga e gjermanëve, si një togë zbulimi e tyre kishte qenë kjo, dy prej tyre mbetën akoma shtrirë. Ata nuk u çuditën tek panë, që nëpër faqet thikë të buzës po shembeshin orteqet e borës. Kio dhe orteqet e borës u bënë një e tërë e vetme dhe plumbi nuk e kapte më.

— Tamam i çmendur! — tha njëri nga gjermanët.

— As ujqrit nuk do ta gjejnë atje, — tha një tjetër.

— Nuk desh të binte rob, — sqaroi vetveten tjetri.

— Oh! — rënkoi njeri nga ata të dy që rrinin shtrirë akoma.

Ai rënkoi thellë dhe shokët e tij u kujtuan, që pak minuta më parë, pranë tyre kaloi një njeri, një partizan dhe jo një hije... Çdo gjë kish ndodhur aqë shpejt... sa u dukej si ëndërr...

Nga gryka e thellë e humnerës ngriheshin avuj. Avujt vinin nga thellësia ku ishte Kio, ku duhej të ishte trupi i Kios, dhe megjithatë gjermanët nuk e merrnin vesh se kush avullonte kështu: bora, ujët e burimit apo diçka tjetër. Atyre tashti u dukej se ai që kish kaluar disa minuta më parë fare pranë tyre, ishte diçka magjike, fantastike, që po merrte trajtën e avullit dhe ngrihej lart drejt qiellit, e madhe, e madhe... Kjo që i ngatërronte ata ishte mjergulla që nëpër humnerë ngjitej drejt maleve, majave të maleve.

Kio shkau e u rrëzua në fund të humnerës. Pesëqind, a ndoshta dhe më shumë metra thellë. Sikur të kish qenë verë dhe të mos kish borë, nga ai njeri, që quhej Kio, me të vërtetë do të kishin mbetur vetëm avuj.

«As nam, as nishan, s'do mbetej» — mendoi Kio për vete, kur e pa se gjendej i gjallë në fundin e botës. Por ishte dimër, kishte borë edhe thellë humnerave. Dhe ajo borë që e kish torturuar e munduar tri ditë e tri net, tashti i kish shërbyer si shtroje edhe e kish mbrojtur e shpëtuar nga shkëmbenjtë dhe shtresat e strallta të faqes së greminës.

Ai erdhi në vete shpejt, pas asaj shembjes së menjëhershme dhe e pa veten në fund të botës. Po, në fund të botës. Kështu i dukej Kios dhe nuk dinte se si do të dilte këtej dhe, në përgjithësi, a thua do të ishte dot këtej?

Tashti ishte fare i lehtë. Pushkët i kishin rënë e i kishin mbetur diku nëpër borë. Bombat kushedi ku ishin mbjellë në fund të humnerës. Dhe vetëm në xhepa kishte akoma thërrimet e fetave të bukës së misrit, plumbat (pesë plumbat pa pushkë) dhe letrën e zhubrosur me gërma të shtrembëra të alfabetit të shqipes dhe ato fjalët që kaq mirë i thosh me gojë, kurse me shkrim i dilnin më keq se këmbët e pulës — «VDEKJE FASHIZMIT — LIRI POPULLIT» këto gërma ishin të parat, që u kish mësuar ajo vajza partizane në shkollën e malit.

Ishte i lehtë, asnjëherë s'kish qenë kaq i lehtë, por vetëm diçka e metaltë, e mprehtë si daltë, i therte në të ndenjura. Të kem thyer nonjë kyç? Ai e pa që nuk ecte dot në këmbë. Provoi të ngrihej dhe ra. Provoi prapë dhe u shëmb në borë. Dhe filloi të ecte këmba-dorazi në fundin e humnerës, që ishte fillimi i shtratit të përroit të thellë të Ngjipes, përroit të dreqërve.

Deri në këtë pikë të përroit, ku ai formonte një diçka të ngjashme me kataraktin, njerëzit vinin ngadonjëherë në behar. Por vinin atë nga ana e rrjedhës së përroit (ujrat e tij zinin fill nga ujvara e burimit), kurse kështu siç kish ardhur Kio, s'kish qëlluar kurrë të zbriste ndonjë njeri i gjallë. Të vdekur kishin zbritur, por jo të gjallë. Atje kishin gjetur vdekjen dy gra të ngarkuara. Njera, thonë, se e kish shtyrë i shoqi që deshi të martohej me një tjetër, kurse ajo tjetra shkau e ra se humbi ekuili-

brin mbi buzë. Sidoqoftë për një gjë jemi të bindur: që fundi i kësaj humnere deri tashti kish qenë vendi i sigurtë i vdekjes. Ndoshta, i pari dhe i fundit njeri që mbeti i gjallë atje ishte Kio, korieri i brigadës.

...Kio s'kishte më fuqi. Ai ecte këmba-dorazi, si ato foshnjat e vogla, që nuk kanë mbushur vitin, dhe nuk dihej se kur do të dilte në atë pjesë ku përroi e ka shtratin të shtruar e të mbushur me zall. Atje ku përroi lëshonte zall e rërë nuk kishte më rrezik të shembej. Përbri zalleve të përroit, fillonin pastaj shtëpitë e para të fshatit.

Dhe ai ecte sheshazi, gati barkaz. Dhe gurët e bora e bërë akull i coptonin gjunjët e i dërmonin pëllëmbët e duarve. Ai ecte dhe bisedonte me vete. «Kujt t'i bëj të fala? Të gjithëve. Mirë, të gjithëve do t'u bëj të fala...»

Ai eci gjatë kështu, duke biseduar me vete e duke coptuar gjunjët e dërmuar duart dhe filluan t'i merreshin mendtë: «Për të qeshur, eci këmba-doras si fëmijët dhe më merren mendtë» — mendonte Kio.

Bënte ftohtë, por atij djersët vinin e i mblidheshin në vetulla dhe nuk i fshinte. Pastaj vetullat fryheshin me djersë dhe si nuk mbanin dot më djersë, kjo i pikonte para syve në borën e ftohtë, si pika të ngrohta loti. Dhe djersa dhe lotët janë të kripura — mendonte Kio, — ndoshta se të dy palët rrjedhin nga vuajtjet, hallet, dhimbjet. Rrëke djersë shkinin dhe në beben e syve dhe ahëre përziheshin lotët (sytë qanin nga acari i madh) me djersën dhe duart epeshin e s'e mbanin dot më. Pëllëmbët i rridhnin gjak. Dhe atij i dukej sikur vuloste bo-

rën me bojë të kuqe, ashtu si damkoste dikur trun-
gjet e pemëve që do t'i hante sharra e sopata.

Gjaku i tij mbetej pak në borë, pastaj tretej dhe bora që binte e mbulonte çdo shenjë të tij. Ai ecte gjithmonë. I lodhur. I këputur. Ai donte të flinte. Por, po të flinte, e mbulonte bora. . . E mbulonte vdekja. . . Kurse shokët duhej të dinin, që të dielën e parë fillonte sulmi. . . Sikur të mos ishin shokët. . . ai do të flinte për gjithë jetën, këtu, në mes të borës. . . Asnjëherë s'kish gjetur një çarçaf të bardhë kaq të madh. . .

Ai e pa që po e linin fuqitë. E ndjeu këtë. I dukej vetja e vogël, e vogël fare dhe pa fuqi, si fëmijët. Zaten, kot nuk po ecte si fëmijët. Dhe kur e pa, që s'i mbetej më asgjë, që ta mbante mbi duar, nxori kartën e zhubrosur nga xhepi. Në të mbeten njollat e gjakut. Dhe ahëre filloi të shkruante me gishtin e vogël (kështu i ati vinte imzanë në kartërat e botës) që pikonte gjak: «Shoko, të djelën parë shkurtit. . . fillon. . .» Gërmat dilnin të shtrembëra dhe të trasha. Ah, ta kisha dhe gishtin si të fëmijës, të hollë cipal — mendoj Kio. Dhe nuk arriti të shkruante se çfarë do të fillonte të dielën e parë të shkurtit, se ju errën sytë dhe ra mbi letër. Ai e mbuloi letrën me trupin e tij dhe e zuri gjumi. Bora binte dhe ai flinte mbi letër e mbi borë. Pas pak bora që binte butë-butë, filloi ta mbulonte dhe atë, korrerin.

. . . Gratë shkonin për dru në mal dhe e gjetën atë në mes të borës. Ato u trembën dhe kujtuan se kish ngrirë. Por atij vazhdonte t'i rridhte gjaku pika pika nga duart dhe çorapet e leshta me ojna të bardha e të verdha i qenë bërë të kuqe flakë dhe kullonin gjak.

Dhe njera nga ato gratë tha:

— Është i gjallë, o motrani!

— Ç'thua, o korbë, — tha tjetra. — Po ky është bërë si meit.

— Është gjallë, rrënjëdali, shihni si i pikon gjaku të ziut.

— S'do të këtë shumë kohë kështu, i shkreti djalë!

Këtë atyre ua kishte mësuar jeta. Por derisa rrjedh gjak, do të thotë, që s'ka ngrirë njeriu, do të thotë që s'ka vdekur. Kur mpikset gjaku dhe nuk lëvrin më në deje, ahëre dhe jeta ka marrë fund — i shuhet fitili jetës.

Gratë, ato ishin pesë, patën frikë ta merrnin në fshat. Se atje ishin «ata, qenërit gjermanë, dhe ata, të pabesët e Xhaferrit», dhe ndaj e siguruan në një nga ato shpellat karakteristike që mund t'i gjesh në çdo përrua të vendit.

Letra me alfabetin e shqipes, gërmat e zeza «VDEKJE FASHIZMIT — LIRI POPULLIT» — dhe shkronjat e kuqe «Shoko, të dielën parë shkurtit... fillon...» mbeti në mes të borës...

Gratë, si motra e nëna të dhëmshura që qenë, ndezën zjarrin në shpellë dhe, si e panë që ai ishte vërtet i gjallë, i dhanë të hante bukë nga e tyrja. Ai nuk fliste dot. E kish humbur zërin dhe nofullat nuk i lëvizte fare. Dukej sikur nofullat i kish mbërthyer për gjithë jetën. Ato nuk kishin me vete as çeture e as gavetë, që t'i ngrohnin ndonjë çikë, a t'i bënë një grusht përvëlak. Ndaj muarën borën e vunë pranë zjarrit të shkrinte. Dhe ashtu atë borën e shkrirë, që shkiste nëpër tabanin e gurtë të shpellës, ja lëshonin me grushta, pika pika në buzët dhe

dhëmbët e mbërthyer. Me siguri kështu bënëin dhe gratë parahistorike, kur njerëzit jetonin akoma nëpër shpella, kur kishin të sëmurë burrat, djemtë, apo vëllezërit e tyre.

— Do ngrohur mirë, i mavrisuri, — tha e para. Dhe e bënë zjarrin akoma më të madh.

— Ka hequr të zitë e ullirit! — tha e dyta.

Dhe filluan t'i lidhnin plagët me futat dhe këmishët e tyre.

— E zeza nënë, kur ta shohë! — tha e treta.

Dhe e mbuluan me rrobat e tyre të trupit. Me rrobat që hoqën nga mishi i tyre.

— Sos është më njeri ky! Kockë e lëkurë është, — tha e katërta.

Dhe mallëkuan vehten, që s'kishin një çërr vaj ulliri me vete, që s'kishin një çeture apo gavetë.

— Kush e di ç'hall ka patur që është katandisur kështu? — pyeti e pesta.

Dhe vajtuan hallet e tyre dhe hallet e tij.

— Lufta me të ligun. Ky është halli i të gjithëve sot, — tha e para.

Dhe u bënë gati të gjenin çdo gjë, që i duhej atij, që tashti nuk e njihnin dot. Megjithëse ishte djalë i fshatit të tyre. Ato mund të ishin motrat e tij dhe të mos e njihnin partizanin Kio. Aq ishte tretur e telekosur ai.

Pastaj gratë ikën dhe mbeti vetëm njëra nga ato, ajo e para, ajo më e forta, ajo më e vuajtura dhe më trimja, që kish dy djem partizanë.

— Pi, o jetë, pi! — i thosh ajo për borën e tretur në zjarr, që i rrëshqiste midis gishtërinjve tërë kallo e rrudha.

Shoqet shkuan të lajmëronin burrat e tyre, burrat e fshatit. Se duhej të shpëtonte partizani i maleve.

* * *

Partizani erdhi në vete natën vonë. Gratë kishin lënë në shpellë drutë, kucurat dhe shkarpat që kishin mbledhur për kalamanjtë e tyre. Dhe nëna e dy djemve partizanë kishte dru për të ndezur, jo një zjarr, por pesë zjarre bashkë.

Shpella u ngroh, sa bënte vapë dhe ahëre Kio erdhi në vete.

— Ku janë shokët? — pyeti ai.

— Do vijmë, o jetë, — tha gruaja e shpellës.

— Po nuk i pashë dot...

— Do t'i shoq, jeto, do i shoq, o zemër.

— U thuaj që të dielën e parë të shkurtit fillon sulmi.

Ai i tha këto fjalë duke i ndarë në rrokje, copë, copë, ashtu siç lexonte abetaren në shkollën partizanë. Ai i tha këto fjalë dhe mori frymë thellë. Dhe e zuri gjumi përsëri.

— U çlirua nga halli që kish! — tha gruaja me vete.

Dhe mbi kokën e atij që flinte dhe ajo filloi të dremiste e të kujtonte fjalët e tij, që të dielën e parë të shkurtit nis muharebeja e madhe, që e shoftë farën e hasmit për jetë të jetëve.

Të nesërmen erdhën shoqet e saj dhe shokët e atij e të djemve të saj. Ai ishte zgjuar. Kishte njohur shokët e tij të malit dhe deshi të ngrihej.

Por kur vuri pëllëmbët e duarve në tokën e ftohtë, të gurtë, ato i dogjën sikur i kish vënë mbi skarrën e nxehtë.

Ai i njohu shokët. Por ata nuk e njohën. Ai nuk njihej më. Atë kish rrezik të mos e njihte as e ëma.

Ai copa-copa, sikur lexonte një libër të ngatërruar, tha:

— Të dielën e parë të shkurtit fillon sulmi.

— Mirë, — tha komisari. — faleminderit, shok. Shlodhu tashti.

— Kush je ti? — pyeti komandanti, të cilit nga zëri Kio ju duk njeri i njohur.

— Kush jam unë? — Atë nuk po e njihte as shoku i tij, tok me të cilin kishin filluar këtë luftë të drejtë. Kush jam unë? — Atë nuk po e njihte njeri. Korierin Kio e kishin harruar të gjithë. Kush jam unë? — Dhe ahëre ai e kujtoi dhe kuptoi se ç'rrugë kish bërë. Sa ishte lodhur dhe drobitur. Përderisa asnjë nuk e njihte. Kush jam unë? — Ai pyeste veten, pa e kuptuar që fliste me vete. I dukej se këtë pyetje ua bënte ai tashti atyre, shokëve, kush jam unë?

Shokët prisnin, që ai të thoshte se kush ishte.

— Jam u, Kio, korjeri i brigadës, Kio — tha ai dhe sytë ju mbyllën dhe nuk shikoi më, as dalloi dot ku ishin shokët, gratë, burrat e fshatit. Shpella ju duk e madhe dhe pa fund. Pastaj kujtoi shokun, atë tjetrin që e la në botën e akullt të valëve dhe me mundim të madh shumë u tha shokëve:

— Ai tjetri, i normales, mbeti tek stanet... Ujqrit...

— Kush, Sandri? — pyeti papritur njera nga partizanet. Ishte vajzë e re, fort e re, të cilën me

që kishte shkollë, e kishin vënë në agjitpropin e batalionit.

Por Kio nuk u përgjigj. Ai nuk dëgjoji që ajo e pyeti për atë tjetrin. Se, ndoshta më në fund, këtu në shpellë, midis shokëve, ai do të dinte kujt t'i bënte të fala. . .

Partizania priste përgjigje me ankth.

Kio nuk tha asgjë, se dhe asgjë nuk dëgjoji.

Ai flinte.

Shokët rrinin zgjuar pranë tij. Pastaj e vunë në vig.

PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
Një natë e shkurtër	3
Të nesërmen e natës pa gjumë	14
Njerëz dhe gurë	24
Ajo	41
Ruajtësi i thesarit	48
Komisari i deleguari dhe ne	61
Misioni	80
Gratë e fshatit	93
Përtej detit	109
Një udhëtim i zakonshëm i gjeologëve	123
Mos ardhsh më, o Sheme Mara	133
Rrugës midis njerëzve të thjeshtë	147
I ka nafta këto	180
Kio	185